

NdueGASPRI

RIKTHIM ME
OFELINË

roman



Enti Botues "Gjergj Fishta",
2019

Redaktor:
XXXXXXXXXX

© 2019. Të gjitha të drejtat janë të autorit.

ISBN 978-999-XXX-XX



Enti Botues “Gjergj Fishta”, Lezhë
tel.&fax: +355 215 22342
e-mail: info@botimetfishta.com

PJESA E PARË

Pse kështu, o vendi im, o shteti im, o njerëzit e mi? O dashuria ime! Pse po silleni kështu me mua? Doni të më degdisni larg në male? Të tremem, të humbas edhe shpirtin atje ku fryjnë erëra të ftohta e bie shumë borë? Të kthehem në eremit? Të harroj edhe emrin që më ka vënë nëna? Jemi në vitin 1990 e...!

Jam i ri me interesa e qëllime, ndryshe nga ju. Pa mbaruar mirë shkollën, ende kockëbutë vihem në një provë vështirësie e force nga arroganca e atij që ju i thoni shtet. Më tregoni një vend të largët, një malësi të egër. Mes hungërimave të ujkut e të ndjehem diku afër egërsisë. Ju e dini se për fajin tuaj atje ka jetë të vështirë. Larg nënës time. Doni të më kërcënoni, të më thyeni, të më fyeni e të jem i përrulur para jush. Gaboheni. Nuk më njihni. Unë e dua atë vend, ndonëse nuk kam qënë kurrë atje, edhe më shumë se ju, por ndryshe, dua edhe veten. Pse jo?

E refuzova, e përbuza vendimin tuaj e në rastin më të parë vendosa të iki prej vendit tim, prej jush. Drejt një diku tjetër. Pa ju. Po prap do ta dua vendin tim. Më shumë se ju. Po iki. Në kërkim të një mundësie më të mirë. Të mbaroj shkollën e vaniteti i deliktit me vendin tim të harrohet. Të ndjehem i vlerësuar për punën që do të bëj. Jo të shpërndaj varfërinë, produktin tuaj fatkeq. Të gjej një dashuri të madhe. Të shpërfill urrejtjen e injorimin e pinjollëve tuaj.



Nuk janë më të mirë se unë. Të arrij ku dua unë, e jo ku doni ju. Egoizëm!? Pse jo. Nuk e shpërbëj veten për të tjerët. Kam kurajo, guxim e vullnet deri në mosbindje qytetare. Deri ...në qytetarinë morale. Kam tek vetja forcën e kundërshtimit të së keqes. Më besoni.

IKJA

Me trembëdhjetë qershor mbarova vitin e katërt të kursit teorik të degës frutikulturë në fakultetin e Agronomisë në ILB të Tiranës. Me pesëmbëdhjetë qershor gjithë kursi im u mblodh në sallën e leksioneve. Lajm i rëndësishëm. Në forum zunë vend dekani, disa shefa katedrash e dy përfaqësues nga qeveria.

- Përfundimi i vitit të katërt nuk do të thotë se mbyllët studimet shkollore, - nisi fjalën e tij dekani. Ju do të shpërndaheni në disa nga ekonomitë bujqësore të vendit sipas një programi të caktuar e pas një viti stazh do të riktheheni për të dhënë provimet e formimit për marrjen e diplomës shtetërore. Dekani vazhdoi edhe disa fjali të tjera e pastaj ia la fjalën përfaqësuesve të qeverisë nga Ministria e Arsimit dhe e Bujqësisë. I dëgjoja. Propogandë me fjalë të bukura. Ikja nga Tirana, nga kryeqyteti, na terrorizonte të gjithëve. Ishte fundi i një jete disi të bukur. Nuk jam hipokrit.

E fundit e mori fjalën një drejtorë kuadri që filloi të lexojë emrat e kandidatëve, rrethet e ekonomitë ku çdo njëri prej nesh ishte caktuar të kryente stazhin. Erdhi dhe radha e emrit tim: Rubin G. Rrethi Mat, ekonomia Macukull.

Nga vendi ku isha u drithërova, humba temperaturë e pa u kuptuar shtova ndjesinë negative. U trondita në qënien



time. M'u duk se një djersë e hidhur më spërkati lëkurën. Nuk e doja veten, shkollën e moshën time. Ndjehesha i humbur, i pavlerë, askushi e pothuajse njeri kot. I tretur! I braktisur! Pse? E po vetë përgjigjesha brenda asaj që njihet si formimi apo ndjesia ime e brendshme. E dija se ky emrim provizor sipas të gjithave praktikave të deritanishme pas një viti do të kthehet në një vendim të përhershëm e nuk i dihej edhe sa vite të tjera do vazhdoj të thyej këmbët në rrugët e pjerrta e me gurë të atij vendi që quhet Macukull. E çfarë do të bëja atje? Inventarin e kumbullave, dardhave, mollave e thanave të egra. E me çfarë pagese? Përvoja e vëllait tim, Maksit si mësues në malsinë e Krujës, më kishte treguar se paratë që merr nga kjo punë nuk mjaftojnë as për të mbajtur veten në ato humbëtira ku nuk ka rrugë, banesa e mjete minimale të jetesës.

Aq kohë sa zgjati ky lloj lajmërimi, humba dëgjimin, disa zhurma e drita blici vinin në memorien time. Duheshin për fotografi, për program, për të shtuar propogandën e një mashtrimi kolektiv. Ku do të isha pas kësaj dite? Në shtator Macukulli më priste mes kumbullave të egra? Pse jo në fshatin tim? Fundja isha djalë i atij fshati, e aty kisha lindur e rritur, kishte frutikulturë disi të zhvilluar. Diçka do të bëja e mësoja aty. Pse në Macukull?

Dola nga salla pa u përshëndetur me shokët e grupit e u largova nga Instituti. Në shpi i tregova nënës e cila menjëherë filloi të qajë. Më erdhi keq më shumë për lotët e trishtimin e saj. Qante nëna. I kishin degdisur larg fëmijët e saporritur. Kalitje! Hë!

- Pse vetëm fëmijët e mi emërohen apo treten larg në male? Çkanë bërë ata? - fliste mes lotësh ajo e sillej si e trembur nëpër shpi.

- Kur më larguan Maksin u mërzita, por për ty po derdh lot. Vetëm ju në majë të vështirësive? Po mbetem e vetmuar.

Çkam bërë? Kur e mori vesh im atë u mjaftua me fjalët: edhe atje njerëz jetojnë. Nuk do të rrih gjithë aty jetën. Kaq foli, dhe heshti. E kuptova se ishte mërëzitur shumë. U tronditen tej mase prindërit e mi.

Di se im atë kishte qënë deputet, kryetar kooperative diku tjetër e pas një mase në parti e kishin sjellë këtu përgjegjës sektori. Ngrihej herët në mëngjes, në drekë rrallë vinte në shpi e thoshin se është qeni i punës. Të tjerat i mora vesh më vonë, por heshta. Ai e tradhëtonte nënën time, por bëja shurdhin. Isha djalë i rritur. Diçka kisha nisur të kuptoj në këtë botë.

Mbrëmja në shpi nuk më lehtësoi, por më shtoi tronditjen e filluar në Institut. Si do të bëja me veten? Do të humbisja kryeulur në malet e Macukullit? Në hiç punë?

Të nesërmen i hipa motorrit e në një rrugë traktorësh, dola në bregdet. Nuk u ndala, por vazhdova udhëtimin deri në kepin e Rodonit te disa rrënoja kishe e kalaje. Aty ndalova. Nuk kishte njeri tjetër. I vetmuar. Ngrita çadrën. U zhvesha. Ndeza radion e dorës e u shtriva. Te stacionet e Rai-t dëgjoj zërin e Minës e Çelentanos, Nazarro, Kotunjos, Albanos, Batistit e shumë të tjerëve. E vetmja kënaqësi vinte nga ajri. Isha shtrirë në rërë e kështu i vetëm argëtohesha me muzikën e bukur. Këtu ndiehesha i sigurtë, i lirë si bir i natyrës. Uji e ajri ishin aleatët e mi, por vetëm këtu. Kaq. A mjaftonin këto për mua?

- Ti nuk don të shkosh në Macukull, pse? I urren fshatarët që jetojnë atje? Kundërshton të kontribuosh për vendin tënd? Kush të shkolloi?

Dëgjoja si ulërime në memorien time akuzat e kohës. Ishin thirrje të egra.

- Jo ore njeri apo çfarë je, unë nuk i urrej ata njerëz, as at vend, por nuk mund të formoj veten e lumturinë time atje. Kupton? Atyre u jap pak gjëra e për vete humbas



gjithçka. Bilanc negativ. I papranueshëm. Jepja përgjigjen time hipotetike.

- Jo nuk kuptoj, vjen oshëtima vrastare.

- Dërgo djalin tënd atje që të ndjesh e kuptosh këtë detyrim, por nuk e bën. Të dhimbsen.

Shumë e ndjejnë të keqen time, por askush nuk guxon të dalë krah meje. Pse? Frika që ecën e futet kudo, i tmerron. Trekëmbshi i ngritur që lëviz në rrugët e vendit deri majë malesh, nuk përvidhet, por shfaqet hapur. Si shejtani! Kërcënim.

Si të shpëtoj prej saj? Me heshtje duke mos folur, bile as dëgjuar...si? Pa shqisa?

Me vetminë, si kjo, duke mos dëgjuar se çfarë thonë të tjerët. T'u fshihemi shikimeve të tyre. Bëhet kjo? A mundet të pajtohem me vendimet e të tjerëve dhe kur këto nuk janë si të miat e më dëmtojnë në gjithçka që kam menduar. Pse kështu? A nuk kanë vlerë mendimet e formuara në trurin tim?

I turbulluar, pasdreke vonë shkoj në shpi. Im atë nuk ka ardhur. Shkoj në dhomë. Më mori gjumi. Diku afër mesnate zgjohem. Dal në kuzhinë. Mbi tavolinë qëndronin dy pjata të mbuluara ku ishte ushqimi im. Ha. Ndez televizorin bardh e zi e komandoj grupin jashtë tij. Zëri minimal më ofron reklama të plazheve matanë detit. Bukuri që ndrin. Njerëz të qeshur që punojnë, gëzojnë e pushojnë. Unë sot isha i vetëm në bregdetin tim që nuk ka kujdesin minimal. Pa gëzim. Shkretëtirë.

Andej dyqanet plot. Makina të bukura. Klube mbushur me njerëz. Secili në qejfin e vet.

Me 1 korrik shkoj në Durrës, takoj disa prej shokëve të gjimnazit, dëgjoja (duhet të dëgjoja ndonjëherë dreqi ta marrë) se do të hapen ambasadat! Si, si? Do të lihet e lirë hyrja në territorin e ambasadave për çdo njeri që do e ku

do. Do në ambasadën gjermane, italiane, franceze, angleze. greke e në çdo përfaqësi të huaj në Tiranë. Hyrje pa frikë. Kaq. Heshkje. Zjarri i ftohtë më ndezi. Nuk e besoj. Mos është kurth? Ndeza motorrin e ika në shpi. Isha disi më i qetë. Gjumë. Për çudi ëndrra më qetësoi e atë lloj gjumi e përjetova thellë. Kishin lindur apo zgjuar ëndrrat tek unë. Po si? Nuk e di. Nuk mund të bëj blasfemi.

Të nesërmen, pasi nëna ime iku në punë, mbloodha disa rroba, i futa në çantën sportive që e hodha krahëve. Dola nga shpia. Në Vorë hipa në autobuzin fizarmonikë që lëvizte me vështirësi. Zbrita në Tiranë. U solla vërdallë për pak kohë. I pavendosur. I hutuar. Në orën pesë pasdreke isha para dyerve të ambasadës italiane. Para tyre disa njerëz. U afrova më afër. Pashë çudinë. Brenda territorit të ambasadës kishte shumë njerëz. E kuptova, ishin qytetarë shqiptarë. E kishin kaluar portën që e mendoja unë. Pas pak dy të rinj si unë kaluan murin e u futën edhe ata brenda. Askush nuk foli. As polici tek dera. Një grup tjetër dhjetë dymbëdhjetë vetësh afrohet pa fjalë e hyri prap nga dera. Prap polici nuk foli. Kur dielli po zbriste mbi kodrat e Kasharit, u afrova edhe unë. I turbulluar pashë njeriun polic.

- Do të kaloni? - pyeti ai e hapi derën.

Nuk fola, por i qetë në dukje kalova derën e u gjenda në oborrin e ambasadës italiane. Bëra disa hapa. Isha pa frymë, si qëniet tjetër. Po bëja një hap të panjohur. Habi. Çfarë po ndodh kështu?

- Eja djalë, mirëse erdhe! - më foli një burrë me mustaqe e më tregoi një derë. Hyra në një sallë të madhe. Kishte shumë njerëz brenda saj. Të gjithë ata kishin kapërcyer ylberin si unë. I përshëndeta me krye. I pashë. Burra, gra, të rinj e të reja. Të veshur keq. Të paqethur. Pinin shumë duhan. U ula edhe unë diku. U err nata. Një ekran i madh



jepte lajmet. Me një batanije nën bri e çantën nën krye kalova natën. Ishte një qetësi e gënjeshtërt. Ndjehej.

Të nesërmen prap oborri i ambasadës e hijet e pemëve na ftonin. Të mbyllur. Korrik i nxehtë. Ndjeja se po dëmtohej pastërtia e higjiena e ambientit. Duhet të duroja në qetësi. Diçka do të bëhet. Diku pashë dy vajza. I njoha. Me sa mbaj mend, janë nga Durrësi. Kanë luajtur para disa vitesh basketboll, si unë me ekipin e qytetit bregdetar. Që kur mbarova gjimnazin kanë kaluar katër vite, shumë ujëra kanë rrjedhur e nuk e di si i kujtova. Ditën e tretë dola disa herë në oborr e kontrolloja rrugën matanë portës. Kisha ndjesinë nga zhurma e një motorri se im atë ishte aty. E njihja mirë atë zhurmë. Në një moment e pashë. Kishte ndalë motorrin e i ulur në një bordur, kishte zënë kryet në duar. Nuk i fola. U ktheva pas e futem në sallë. Nuk doja të më shihte. Shumë të tjerë, po nga jashtë hidhnin sytë brenda ambienteve të ambasadës, thirrnin të afëmit e u kërkonin të dilnin prej këtu. Kakofoni.

Pas pak ditësh filloi lëvizja e autoriteteve ndërkombëtare. Dikush na dorëzoi formularët për plotësimin e gjeneraliteteve. I plotësova për vete. Ndihmova dhe disa të tjerë. Bëmë edhe fotografi. Po pse duheshin? Në pritje çfarë të ndodhte, ambienti u rëndua. Ka edhe të sëmurë. Kërkohej ndihma mjeksore për fëmijë e të moshuar. Jepen vazhdimisht lajme. Kuptova se OKB-ja kishte ndërhyrë të na jepeshin pasaportat e shteteve pritëse.

Më 12 korrik del i shkruar lajmërimi në disa kopje se sot do të nisemi për në Durrës me autobusa. Në port do të na hipin në targete e drejt Italisë. Duhet të përgatiteni. Për çfarë?

Vërtetë, para ambasadës u ndalën disa autobusa të shoqëruar nga forcat e policisë. Filloi hipja në to. Unë në autobusin e tetë. U nisëm. Në Vorë hodha sytë drejt fshatit

tim e u hutova. Nuk di se kur mund ta shoh prap. Aty kam lënë nënën, -mendova e u dobësova shumë. U drithërova. Arritëm në Durrës. Thanë se targetet kishin ardhur. Zbritëm e të kontrolluar, filluam të hipnim në to. Zura vend diku, afër një zyre ku hynin e delnin siguria e anijes. U ula e po shijoja erën adriatikase që më rrihte ftyrën. Nata kishte rënë e porti dukej i shkretë. Dikur nisemi. Isha i lodhur. Dëgjoja gjysmë dialogjesh me zë të ulët që herë vinin në akcent jugor, herë verior e më shumë të mesit të Shqipërisë. Kur ora e madhe e anijes tregonte mesnatë, u shtriva mbi batanije, vura nën krye çantën duke siguruar në gjii pasaportën italiane. Gëzimin e parë timin në këtë aventurë. Më zuri gjumi. Pas katër orësh u zgjova. Ndjeja ftohtë, siç dukej ishim në Otranto e erërat e freskëta detare e krijonin këtë gjendje. U ngrita në këmbë. Pashë që kudo kishte njerëz që të shtrirë, flinin. Dy roje sigurie qarkullonin me ndrim në kabinën e tyre. Bëra disa hapa të nxehesha disi.

- Është pak ftohtë? - më foli njëra nga rojet.

- Po, - iu përgjigja me italishten time të mangët.

Italiani që siç duket donte të kalonte edhe ai shërbimin e natës, vazhdoi të më pyeste. Ishte pak i informuar se çfarë ishim ne e ç'kërkonim në këtë udhëtim nate nëpër det, gjysëm misterioz, biblik. Si në legjenda.

Pas nëntë orë udhëtimi u duken brigjet italiane. Ishte porti i Brindizit që na priste. U gëzova. Prisja të vija këmbën aty e të ndjeja në veten time pjesë-pjesë efektin e lirisë. Sipas një radhe të paracaktuar filloi dhe zbritja. Hipëm në autobusa ushtarakë shumë të mirë, që nuk krahasoheshin për nga cilësia me ata shkatërraqë që na sollën nga Tirana në Durrës. Për ku kështu?



NË KAMP

Zbritëm në një shesh para disa kapanoneve që administroheshin nga ushtria italiane. Filloi sistemimi ynë. Mora vesh që ishim rreth tetëqind refugjatë që donim fjetje e ushqim, higjienë e rregull të një jete të përbashkët. Prisja radhën. Më në fund lexohet edhe emri im. Ishte një fjetinë e madhe, me infermjeri, banjo e kuzhinë. Rregulli e donte të ishim të duruar. Të gjithë do të kalonim në kontroll shëndetësor. Kampi Restinko i reparitit ushtarak San Marko ishte ngarkuar të na sistemonte, të na krijonte kushtet e të trajtoheshim si qytetarë të ardhshëm të botës së lirë. Zura vendfjetje. U ula në krevat. Në dollapin tim sistemova rrobat. Më vonë bëra banjo, ndërrova rrobat që kisha veshur e shkova në menci. Në një sportel mora ushqimin e u ula në një tavolinë. Ishte i shijshëm, i gatuar mirë, i bollshëm e mjaft cilësor. Gjithçka pastër. U gëzova. Bëra dhe kontrollin shëndetsor e analizat e duhura. Në portën e bujtinës ushtari kontrollonte rregullin e qetësinë. Mbase si fillim duhet të na imponohet rregulli ushtarak që të mësohemi me një jetë tjetër komunitare. E quaja të pranueshme.

Fjeta dy orë. U ngrita. Rregullova krevatin e dola në shesh. Po shetisja, të shihja e njihja vendin përreth. Pas kapanonit tonë kishte një fushë lojërash me dorë, një pishinë, një fushë futbollë diku më larg. U gëzova. Mbase

kemi radhë të luajmë e të shkrifërojmë muskujt. Duhet menduar për të gjitha. Nuk i dihet sa kohë do të rrinim këtu. U ktheva në sheshin para bujtinës time i vetëm në perëndim të diellit. Rreth repartit kudo të shihte syri gjelbërim, lule e pemë. Kishte dhe shumë roje. Sigurisht me armë e mjaft të ngurtë. Nuk lejonin hyrjen e daljen e askujt nga reparti pa leje. E do puna, -thashë me vete. - Vërtetë me dokumenta jam qytetar i republikës italiane, që është një ndër vendet më të kulturuar, por jo më i disiplinuar në botë. E ne vijmë nga një vend që është shumë larg standarteve të kulturës e disiplinës të vendit mik e pritës. Justifikohet për mua kjo sjellje shtetërore. Ajo është përgjegjëse për popullin e vet. Ligji e rregulli i patolerueshëm është mekanizmi i këtij stabiliteti. Unë e ndjej veten mirë, bile me fat që një vend si Italia është fqinji ynë e në mos drejtpërsëdrejti ka ndikuar tërthorazi në gjithë jetën e vendit tim. Por a ka qenë fqinj këto pesëdhjetë vite të diktaturës? Po, por ishim të mbyllur. E ky ndikim ka qenë mjaft i vogël. Kush vret veten nuk ta merr kush gjakun. Është humbës. Humbës i madh si ne.

- Mjaft Rubin, leri filozofimet shterpe. Je qytetar i botës me pasaportë italiane. Fillo të mendosh ndryshe. Shkundu! - i thashë vetes.

Të nesërmen pas mëngjesit dola e prap po shetisja. Gjithnjë vetëm. Me sa duket jam i vetmi student në gjithë kampin. Bile disa që e morën vesh çfarë isha, bënë çudinë. Po kjo nuk më bënte përshtypje. Ata që mendonin kështu për mua nuk e dinin se po të mos isha këtu, nëna ime do të kishte filluar që mes lotëve të më përgatitë çantën e udhëtimit për në Macukull. Qesha. Disi u mbështolla nga alegoria e fatit. Ai të ndrron drejtësinë e jetës kur se mendon. Nuk thonë kot: Me fatin nuk bëhet kontratë.



Vazhdova të ecja. Disa emigrantë pinin duhan. Para bujtinës së nënave me fëmijë ishin dy vajzat që i njihja nga Durrësi, dy sportistet. I pashë e ndalova. Nga ku ishin ata bënë përpara e erdhën në drejtimin tim. U dhashë dorën: Rubini. Vajzat me një farë politese e detyrimi u paraqiten: Brikena e Zana. Kur thanë emrat, diçka po më vinte si film në kujtesën time të vluar:

- Ti Zana me sa mbaj mend ke qenë kapitene e të reja në basketboll.

- Dhe ti një basketbollist që shpesh luaje edhe me ekipin e parë.

- Po ti? - pyeta Brikenën.

- Edhe unë kam luajtur basketboll, por jo si Zana.

- Dhe vazhdove të luaje?

- Po. Loja më mbajti në qytet se mund të më caktonin me punë në ndonjë fermë, të prashis luledielli apo vjel ullinj.

- Ku punoje?

- Në ndërmarrjen e gjelbërimit të qytetit, ujisja e plehëroja lulet.

Heshta. Kuptova se diçka të rëndë me shtetin do të kishte vajza e familja e saj.

- Po ti? - theu heshtjen Zana.

- Mua më doli e drejta e studimit në Institutin e Lartë Bujqësor e mbarova kursin teorik për frutikulturë. Stazhin apo praktikën prodhuese u caktova ta bëj në Macukull.

- Ku bie ky fshat? - pyeti Zana.

- Në Mat. Zona më e vështirë në këtë rreth malor, shumë larg qytetit.

Si pa kuptuar, kishim përshkuar disa metra rrugë në një pistë të shtruar bukur me pluhur tulle e çakëll. Në të djathtë fusha e lojname me dorë na ngacmonte. Përpara pishina e mbushur me ujë. Ishte e premtë e dielli filloi të digjte.

U kthjem drejt bujtinave. Shumë nga bashkatdhetarët luanin letra e domino. Kohë e humbur kot, mendova me vete. A mund të thyhet kjo vrasje kohe? A mund ta kthej edhe këtë kohë për veten në një aktivitet më të mirë? Fundja pse kam ardhur këtu? Ç'kërkoj? Të shoh reklamat? Jo. Ata mund t'i shihja edhe lart nga Macukulli. Çfarë atëherë?

Të nesërmen dola e bëra vrap në pistën e gjatë. Kisha kohë pa u shkriftuar muskujsh. U djersita e pas një ore u afrova te pishina. Një not vajtje ardhje në gjatësinë e pishinës e dola. U fshiva e u drejtova te bujtina. Kena e Zana më përshendetën me dorë. I përshendeta edhe unë. Ua bëra shenj me dorë se pas mëngjesit takoheshim aty. Në mencë më priste një ushqim i mirë.

Kur dola te vendi ku ishin vajzat, një top basketbolli oshëtiu në fushë. Një grup të rinjsh 15-17 vjeçarë filluan stërvitjen nën drejtimin e një burri të bëshëm që me sa duket është trajneri i tyre. Pas nxemjes filloi puna me top sipas programit.

- Siç e bënim edhe ne, - foli Kena.

Të tre zumë vend në ato pak shkallë anash fushës e ndoqëm stërvitjen. Gëzoheshim. E ndjenim veten si mes tyre. Solidaritet sportiv moshatarësh.

Më në fund stërvitja mbaroi. Djemtë u hodhën në pishinë. Topat mbetën në fushë.

- Bëjmë ndonjë gjuajte, - fola e pashë vajzat në sy.

- Unë jo, - foli Kena ndërsa Zana erdhi me mua në fushë ku trajneri po kontrollonte diçka në shënimet e tij.

- Mundet të bëjmë disa gjuajtje, - i kërkova unë.

Kur dha dakordësinë me krye trajneri, mora topin e bëra gjuajtjen e parë. Pas meje Zana e kështu vazhduam me gjuajtjet dhe disa triblime. Zana ishte basketbolliste e mirë, me klas. Unë kisha mbetur në vend. Gjithsesi kisha ruajtur shumë gjera si sportist e tregoja formë të mirë.



- Emigrantë? - pyeti trajneri.

- Po, - u përgjigja.

- Sportistë?

- Po. Basketbolliste me një ekip të kategorisë së parë në Shqipëri, - vazhdova të komunikoj me italishten time.

- Shumë mirë! Nëse doni që të stërviteni, unë do t'ju lë çelësin e palestrës e mund të luani në çdo kohë. Këto ambiente sportive i kam në përdorim, stërvis një ekip të moshave në basketboll.

- Ju jeni trajner profesionist?

- Unë kam qënë basketbollist, para tre vitesh lashë sportin e luajtur e vazhdoj të merrem me përgatitjen e të rinjëve.

Ndërkaq trajneri e djemtë e ekipit u nisën drejt palestrës ku ishte parkuar një mikrobuz.

- Ejani me mua, - foli ai e së bashku u futëm në palestër, një godinë lojërash shumë e mirë për kohë tjetër. Topa, banjo, dhoma zhveshje e vegla sportive të shumta kishte aty. U gëzova. Nuk e dinim sa kohë do të rrinim aty, por mundësinë për stërvitje po na e krijonte një njeri që njohëm rastësisht. Fat!

- Unë po largohem. Djemtë po më presin, - tha dhe hoqi nga rrethi i çelsave njërin prej tyre e ma dha. - Pa merak, sa herë doni të stërviteni, shfrytëzoni këto mundësi, - foli e iku me mikrobuzin që e drejtonte vetë.

Mbetëm të habitur. Në një kohë krejt të shkurtër e pak komunikim, krijuam këtë besim e marrëdhënie. Si kështu?

- Një hapsirë e mundësi e bukur për të kaluar kohën në mënyrë aktive, - u shpreh Zana.

- Dhe duhet ta shfrytëzojmë sa të jetë e mundur.

- Që sot pasdreke. Mos kemi punë tjetër, - fola e dolëm nga ambienti sportiv. Në një stol nën një hije ndaluam. U ulëm. Dielli i meskorrikut digjte.

- Në Institut nuk munde të vazhdoje të luaje, - pyeti Zana.

- Jo. Ekipi ynë ra në kategori të dytë e te Dinamo, Partizani e Tirana nuk më pranuan. Vazhdova të stërvitem vetë gati çdo ditë, por kuptohet me ekipin e për ndeshje ka tjetër intensitet e cilësi.

- Gjithsesi formën sportive e ke ruajtur mirë, - u shpreh Zana.

- Ti luaje me ekipin e të rriturave të Durrësit? - pyeta.

- Po. Të dyja.

- Zana ishte kapidene e udhëhiqte ekipin, - doli nga heshtja Kena.

- Si t'u mbush mendja të lije atdheun, - pyeti Zana.

- Me të mbaruar kursin teorik, mora emrimin që stazhin do ta kryeja në Macukull, pastaj të mbroja diplomën, të bëja zborin ushtarak e kuptohet, të rikthehesha prap në Macukull, por tashti me një vendim përfundimtar. Atje majë malesh, pa rrugë automobilistike e kuptohet pa kushte minimale jetese. Lëre ma rrogën, aq e vogël sa nuk të del të mbash as veten. Shkohet atje në punë? Çfarë do të mësoj e të përfitoj? Dije jo. Të ardhura jo. Për çfarë të shkoj atje? Të marr një çertifikatë vuajtjeje? Unë nuk jam nga ata njerëz që e dua kaq pak veten. Nuk jam i tepërt. I harruar assesil!

- Dhe gjete rastin e çave ferrën?

- Pse jo? Ashtu si thua ti është. Erdha këtu me idenë e mbarimit të shkollës së lartë e si njeri i diplomuar të shoh mundësitë e punësimit kudo, mjafton që të jetë e favorshme për mua. Ku të jetë më mirë e të fitoj mjete jetese të mira. Do Zoti e realizoj ëndrrën time. Po përpiqem që të mos i ndahem asaj.



- Të shkoftë mbarë e suksese! - uruan vajzat.
 - Edhe ju ju uroj gjithë të mirat!
 - Nëse më lejohet, a mund të di se a vazhdove të shoqëroheshe me atë violinisten? Ishte vajzë e bukur dhe e mbaj mend kur vinte tek kompleksi sportiv e të priste deri sa mbaroje stërvitjen.

- Unë e desha shumë atë vajzë. Ishim nga i njëjti fshat e të atin e saj e kam pasur mësues. Kur mbarova gjimnazin, mua më doli e drejta e studimit për në Institutin Bujqësor, ndërsa asaj pas një viti në Institutin e Arteve. Vazhduam të takoheshim, por çdo ditë më ftohtë derisa u ndamë apo më saktë, ajo më la. Dëshirë e saj, -mendova me gjakftohtësi. Me sa di, ajo përfundon shkollën këtë vit.

Me kaq përfundova sqarimin për ndarjen me ish të dashurën time Korina, por në fakt ajo ndarje nuk ishte kaq e qetë, e butë si e paraqita unë. Unë vazhdoj të jem i fyer e i ndotur nga ajo ndarje që nuk më shqitet kollaj. Vazhdon të mbetet tek unë si idhtësi që më helmoi për shumë kohë. Heshta e ende jam i vrarë në ëndrrat e djalit të dashuruar, të tradhëtuar e fyer keqas.

Vajzat heshtnin e diçka i mundonte.

- Edhe Zana u nda nga i fejuari, - u shpreh Kena.
 - A mund të të pyes se si ndodhi?
 - Ne ishim prej kohe të fejuar. E donim shumë njëri-tjetrin deri sa caktuam datën e martesës. Pas asaj date mes nesh hyri sherri, grindja e, pas tre muajsh, u ndamë. Mendo që nga ajo ditë maji e për një vit rresht kam menduar edhe keq për veten time, deri në vetvrasje. Isha vajzë e ndarë dhe e mbushur me shumë fjalë, theshatheme, pandehma si mos më keq nga njerëzit e mi deri te të njohurit e shumë të qytetit. Unë akuzohesha për gjithçka. Durrësi, vërtetë është qyteti më përëndimor për nga kontaktet që ka me

botën, por ende ka shumë ngarkesa të botës së vjetër të mbushur me paragjykime.

Kur tha fjalët e fundit, pashë në sytë e saj kondensim lotësh e për të tretur muhabetin i ftova vajzat drejt bujtinës. U ndamë. Mjaft për sonte. Duke risjellë mes nesh ngjarje e ndodhi që ende na trishtonin, mbyllëm këtë fund dite.

Të nesërmen u takuam prap, u stërvitëm e pas pishinës Kena vazhdoi:

- Unë mbarova gjimnazin me nota shumë të mira, por nuk më dhanë të drejtën e studimit. Familja ime kishte biografi jo të mirë. Gjyshi im ka qënë oficer i ushtrisë së mbretit Zog. Kishte mbaruar akademinë ushtarake në Itali e pas pushtimit fashist mori pjesë në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. Por vetëm kaq. Pas lufte erdhi duke rënë në grada deri sa e zhveshën fare. Shpëtoi për pak nga burgu. Im atë punon gjeometër në ndërtim. Nga dajat situata është më e keqe. Dy prej tyre bënë edhe burg politik, u rrënuan fare. Rrjedha jonë familjare shkoi për drej e unë e dija fatin tim. Qenia si basketbolliste më mbajti me punë në qytet.

- E në rastin e parë fatlum kaluat derën e ambasadës italiane?

- Po kështu ndodhi. Dikush njoftoi prindërit e mi e im atë, që mezi ecën nga reumatizma, e miratoi propozimin tim që të largohem nga Shqipëria.

- Po me Zanën si u lidhët në këtë aventurë?

- Si vajza qanim shpesh hallet tona e u gjet rasti kur të dyja u ndodhëm brenda shqetësimit të përbashkët, unë tërhoqa Zanën e kështu pranua të njëjtin shteg shpëtimi.

- Bravo vajza! Ju shkoftë mbarë! - fola duke i parë në sy. Shkëlqenin nga guximi i realizuar.

Të mërkurën pasdreke në stërvitjen e ekipit për çudi trajneri na ftoi të bëheshim pjesë e ekipit të tij. Luajtëm në



ngarkesë të plotë. Kur ajo mbaroi, unë e dy vajzat bëmë një bisedë interesante në lëvizje me të:

- Ju vajza luani mirë. Nëse dëshironi, unë mund t'ju ndihmoj që të lidheni me drejtues të ekipeve që janë në nivelin tuaj në Brindizi, mbase edhe në Bari.

- Pse jo. - foli Zana. Është puna që sot dimë të bëjmë më mirë.

Në vazhdim ai tregoi:

- Kam luajtur basketboll me ekipin e Barit dhe me kombëtaren italiane për shumë vite. Kur u tërhoqa nga sporti i luajtur, kam punuar me ekipet e të rinjëve dhe inspektor rajonal në komunën e Barit, ku vazhdoj edhe sot.

Djemtë dolën nga pishina e po fshiheshin, ne u zhveshëm e u zhytëm në ujë. Pashë që trajneri kishte ende një trup djaloshi, të mbajtur e kujdesur mirë. Bëmë një vajtje ardhje në pishinë, dolëm, u fshimë e, kur po ecnim, ai na u paraqit i plotë: Jam Mario Santini e për sa folëm jam gati të interesohem. E kam porosi edhe detyrë zyrtare. Me kaq u ndamë.

Të nesërmen me vajzat e rikthyem në qendër të vëmendjes propozimin e Santinit si mundësi për t'u ingranuar në përdishmërinë italiane, sikur dhe në sport.

- Nuk mund të rrimë shumë në kamp, - thoshin ata. Edhe unë kështu mendoj.

Pas një jave Santini erdhi me një mendim konkret: U propozoi vajzave të provohen me një ekip basketbolli të rajonit në Brindizi.

- Duhet shpejtuar, në shtator fillon kampionati e formacioni plotësohet. Federimet tashti fillojnë e miratohen. Kjo kërkon që këto ditë të bëni stërvitje e të rikapni formën e duhur sportive. Nëse do të pranoheni aty ku unë mendoj, jeta juaj merr tjetër drejtim. Kuptohet në standarte të reja. Ndaj me kurajo filloni punën, - udhëzoi ai.

Filluam të stërvitemi dy herë në ditë, vajzat dhe unë. Vetëm edhe me ekipin e të rinjëve. Kohë kishim mjaft e kushtet ishin të mira. Shumë më të mira se në klubin sportiv në Durrës.

Në fund të korrikut Mario Santini siguroi autorizimin e autoriteteve që të dilnim nga kampi e me makinën e tij, një 'JEEP' të zi, u nisëm drejt Brindizit. Në klubin sportiv na pritën mirë. Presidenti, trajneri e këshilltarët u njohën me vajzat e u ra dakord të fillonin menjëherë nga stërvitja. Unë me Santinin e presidentin e ekipit zumë vend në shkallët e sallës. Vajzat dolën në nxemje. Santini komunikonte vazhdimisht me trajnerin. Unë përktheja. Zana në qendër të mbrojtjes e Kena në të djathtë të sulmit. Ashtu siç kishin luajtur në Durrës. Filloi loja. Arbitronin dy ndihmës trajnerët. Zana menjëherë bën dallimin në zotërimin e topit, në mbulimin rreptë të kundërshtarit e në organizimin e kundërsulmit. Ajo nuk di të lodhet e menjëherë tërhoqi vëmendjen e interesin e presidentit e stafit drejtues të klubit. Kena nga ku ishte, luante më thjeshtë, më e tërhequr, por ishte e saktë me gjuajtjet në tabelë. Vajzat nuk u ndërruan gjatë gjithë lojës dhe e përballuan me sukses ngarkesën. Koleget e tyre italiane u duk se i admironin e ishin të kënaqura me lojën e tyre. Vërtetë ata ishin instruktuar të furnizonin me topa mikeshat, por dhe ata i shfrytëzuan mirë. Kur loja po shkonte drejt fundit, u ngritëm e dolëm prap në zyrën e presidentit.

- Për një javë vajzat të qëndrojnë këtu. Të bëjnë stërvitje me ekipin e gjatë kësaj kohe t'u nënshtrohen analizave mjeksore. Pas një javë flasim prap.

Me qaq u ndamë me drejtuesit e shkuam te dhoma ku po rrinin vajzat në një hotel të vogël, pronë e klubit.

- Mirë jeni vajza?



- Shumë mirë. Dhomë e mirë, me banjo, telefon e në kat të parë bar-restoranti.

- Po stërviçja si ju shkoi?

- Unë mendoj se mirë, - u shpreh Zana.

- Gjatë javës që vjen krahas stërviçjes do të bëni analizat shëndetsore sipas kërkesave sportive e shpresohet që të kërkohet federimi juaj. Nëse ndodh kjo, atëherë sipas standarteve që aplikohen këtu, për ju fillon një jetë tjetër. Do të keni vlerësim e pagesë shumë të mirë. Kaq kuptova nga biseda konfidenciale mes presidentit me Marion, - iu komunikova vajzave.

- Të faleminderit Rubin!

- Marion duhet të falenderoni, ai është promotori i gjithë kësaj lëvizjeje që mendoj se do të mbyllet javën që vjen.

Me 7 shtator ishte ndeshja e parë e ekipit të Brindizit ku do të luanin edhe vajzat. Këtë e mësova nga Mario që më ftoi të shkonim e ta shihnim. Kishte marrë leje në komandë. U nisëm.

Zumë vend në shkallët e sallës mes spektatorëve të shumtë. Filloi loja. Të dy vajzat shqiptare në formacion. U gëzova. Në minutat e para loja ishte e barabartë. Në pjesën e dytë Zana u bë qendra e lojës. Mbronte, niste topa, zhvillonte luftë të fortë në tabelë e rezultati vazhdonte të thellohej në favor të tyre. Në pjesën e tretë ekipi kundërshtar pothuajse u dorëzua e në pjesën e katërt ekipi i vajzave të Brindizit ishte superior në të gjitha drejtimet ndaj kundërshtarit. Edhe Kena me qetësinë e saktësinë e saj u dallua. U ndjeva i lumtur e shumë i kënaqur me rezultatin e skuadrës së shoqeve të mia.

- Mirë Mario?

- Shumë mirë! Vajzat u dalluan. U mund ekipi kampion.

- E prania në formacion e vajzave shqiptare e ka ngritë nivelin e lojës së skuadrës?

- Pa diskutim. Veçanërisht me lojën në tabelë e në organizimin e sulmit, Zana ishte lojtarja më e mirë në fushë e dukshëm udhëhoqi ekipin drejt fitores.

Pas ndeshjes përgëzuam vajzat për fitoren e u nisëm me Marion drejt kampit.

- Mirë se vajzat u rregulluan, po mua nuk më ka ardhur asnjë lajm, - ngacmova Marion.

- Unë, Nino Ferreti, e shumë drejtues kemi marrë porosi të qarta në këtë drejtim. Ty kush të ka rregjistruar?

- Një specialist i Kolegjit Profesional, por ende nuk kam marrë përgjigje.

- Nesër rreth drekës do të shkojmë bashkë atje. Ti duhet të dalësh medeomos nga kampi. I ke treguar se çfarë kërkon?

- Po dhe ndoshta kjo është pengesa apo vështirësia e sistemimit tim.

Të nesërmen ishim te Kolegji Profesional. Një ndërtesë trekatëshe e madhe me shumë ambiente e kabinete pune rreth një oborri të madh që mbyllej nga një portë me roje.

- Drejtorin kërkojmë, - sqaroi Mario.

- Këtu është, po ju kush jeni?

- Jam Mario Santini e vij nga kampi Restinko.

Roja kërkoj sekretaren e drejtorit, i bëri kërkesën e në pritje na ftoi të ulemi në një ambient ngjitur ku kishte disa karrige e një tavolinë.

- Këtu, në këtë kolegji përgatiten e çertifikohen specialistë në shumë profesione, bëhet shpërndarja e të rejave drejt njësisive të prodhimit, kryesisht fermave bujqësore, e në kohë të caktuar bëjnë praktikat prodhuese studentët e Universitetit Mesdhetar të Barit. Ka edhe një fermë mjaft moderne të prodhimit bujqësor, - sqaroi Mario.

- Shteti e financon?



- Me sa di shteti jep disa fonde speciale, por ferma vetë siguron shumë të ardhura e me to nxit e stimulon studentët për rezultate të mira në formimin e tyre.

- Qënka ekonomi e madhe?

- E madhe dhe me ndikim në jetën shoqërore e ekonomike të rajonit.

Ndërkaq zilja e telefoni na bëri të ndërprisnim bisedën e...

- Ju pret drejtori në zyrë, - foli nëpunësi i shërbimit.

Në shkallët e katit të parë na priti një grua me një bllok në dorë e na udhëhoqi në katin e dytë, para një zyre ku edhe trokiti. Hymë. Një burrë rreth të pesëdhjetave u ngrit nga karrigia rrotulluese, na dha dorën e na ftoi të uleshim në një ndenjese, duke dhënë fillimisht emrin e tij:

- Nino Ferreti: Drejtor i Kolegjit Profesional.

Pas paraqitjes time si emigrant shqiptar dhe të kërkesës që kisha bërë, ai mori një bllok e me kujdes hapi një fletë të veçantë të tij:

- Emri mbiemri Rubin G.

- Datëlindja 27. I.1968

- Arsimi mesëm Gjimnaz, apo arsimi i përgjithshëm

- Arsimi i lartë: 4 vite të kursit teorik në I.L.B të
Tiranës e vazhdova:

- Që të mbyllet cikli i studimeve sipas programit shtetëror, duhet edhe një vit stazh në punë prodhuese e praktikë profesionale në një ekonomi bujqësore e pastaj të kalohet në provimin formues shtetëror e të pajisem me diplomë.

Nino shikoi në sy Marion e foli:

- Njëlloj si tek ne, -e pyeti:

- Gjuhë të huaj:

- Anglisht e italisht.

Këtu drejtori Nino qeshi pak e vazhdoi komunikimin me mua, jo për të kërkuar ndonjë gjë të re, por për të kontrolluar sa e di gjuhën e vendit të tij.

- Dhe kërkonte të plotësoni ciklin e studimeve të larta në universitetin italian.

- Po dhe të pajisem me diplomë.

- Kërkesa juaj është rast i veçantë, por nuk është pa zgjidhje. Unë jam pjesë e trupës akademike të UM të Barit dhe e di se me ILB të Tiranës kemi lidhje të mira. Që të bëhesh pjesë e kontigjentit të studentëve tanë, duhet të bësh një kërkesë UM të Barit për t'u pranuar aty, duke u shpërngulur nga ILB i Tiranës. Unë do të bisedoj me juristin e rektoratit për sqarime më të hollësishme që të jemi korrekt me ty, veten e ligjin. Bile që tani.

Ndërkaq ai ngrit receptorin e formoi një numër në diskun e tij e qëndroi në pritje.

- Alo! Nino Ferreti jam.

- Urdhëroni drejtor, - u dëgjua zëri i bashkëfolësit.

Drejtor Nino i sqaroi me hollësi rastin tim e kërkesën që unë kam. Nga matanë telefonit erdhën shumë fjalë e më në fund Nino e përfundoi bashkëbisedimin.

- Juristi na sqaron se që të bëhesh pjesë e kontigjentit studentor në UM të Barit duhet të transferohesh nga ILB i Tiranës me vendim të dekanatit këtu sipas një kërkesë që do të bësh ti si kandidat. Pastaj vendimi i dekanatit miratohet në rektorat e atëherë në mënyrë institucionale i kërkohet ILB të Tiranës që zyrtarisht të nisë në drejtimin tonë të gjitha detyrimet që keni shlyer atje e që për ne janë të barazvlefshme. Bëhen rekordimet e, nëse keni ndonjë mungesë, do të njoftoheni t'i shlyeni. Pas kësaj do jesh pjesë e kontigjentit tonë të studentëve e do t'i nënshtrohesh vitit të fundit, stazhit e provimit të formimit për marrjen e diplomës. Qartë?



- Po, - fola unë

- Atëherë të fillojmë. Do të bëjmë menjëherë kërkesën drejtuar dekanatit e fakultetit të Agronomisë të UMB, - foli e më zgjati një formular të gatshëm që nën kujdesin e tij e plotësova me kujdes dhe e firmosa.

- Që sot do ta nis për në Bari. Shpresoj se nuk do të ketë shumë vonesë, - foli e u ngrit në këmbë.

Unë u çudita me gadishmërinë e organeve shtetërore, por edhe u gëzova. Kjo gadishmëri më jepte siguri dhe pas kalimeve burokratike po ndjehesha ndryshe.

- Unë mendoj që duhet të dalësh që sot nga kampi, - foli Nino.

- Ku të shkoj? - pyeta.

- Këtu, në kolegji, të bëhesh pjesë e specialistëve të fermës, derisa të gjendet një vend tjetër që të përmbushë interesat tuaja.

- Dhe do të paguhet këtu, - ndërhyri Mario Santini.

- Po, si punonjësit e tjerë të fermës, - sqaroi drejtori.

Pasi u sistemova me fjetje e më dhanë një pagë paradhënie, fillova menjëherë punën me specialistët e fermës në vjelje rrushi. U pajisa me veshjet e punës e veglat nga kryepuntori e me një grup prej dhjetë vetësh u gjenda në vreshtë. Mësova si të vishem për punë e të përdor gërsërët, si vilet e vendoset në arkë rrushi për treg, por dhe për verë. Kërkesa të thjeshta këto, por ndikonin në cilësinë, shëndetin e rendimentin e punës së specialistit.

Në fakt shumë hollësi të procesit i dija, por në praktikën e punës nga vija, nuk kontrolloheshin e vlerësoheshin, ndaj, se m'i përsërisnin si fjalë e praktikë, nuk më vinte keq.

Rrushi për verë nga vreshta dërgohej në kantinën e kolegjit. Aty kalonte në proces përpunimi nga shtypja, dekantimi, fermentimi e ruajtja në vozat e drurit që gjendeshin në një tunel ngjitur me kantinën.

- Po ky tunel? - pyeta një ditë teknologun.
- Është ndërtuar nga ushtria në luftën e dytë botërore. Musolini mendonte të krijonte perandorinë e kohës së Qezarit e kudo ngrinte vepra ushtarake, si ky tunel. Pas lufte u shtetëzuan të gjitha dhe sipas nevojës u vunë në punë. Me ndërtimin e kolegjit e të kantinës, tuneli iu dha shkollës e vit pas viti u pajis me të gjithë aksesorët e nevojshëm e sot, përveçse si objekt mësimor, është burim i rëndësishëm i të ardhurave për kolegjin. Këtu prodhohet, stazhionohet e ruhet verë e cilësisë së lartë.

- A mund të hyj ndonjëherë brenda?

- Posi, - foli e nga xhepi nxori një tufë çelsash, hapi derën e madhe, pastaj një të vogël e u gjendem në një vend magjik për mua. Si në prralla. Në mes një rruginë e anash fuçia druri të renditura bukur, me të dhëna të shkruara në etiketa e kontrollorë të lagështirës së ajrit, temperaturës e tregues të tjerë.

- Si është arritur të pajiset kaq mirë ky tunel?

- Të gjitha këto që sheh ti, janë blerë me paratë e fituara nga puna e studentëve edhe punonjësve në fermë. Italianët janë njerëz duarartë. Fuçiat janë prodhuar te reparti i drurit vit pas viti, instalimet elektrike e hidraulike, dyert e suportet metalikë janë ndërtuar e instaluar nga reparti i mekanikës sipas ideve të inxhinierëve tanë. Por gjithë kjo punë nuk do të ishte realizuar, nëse nuk do të ishte kërkesa e vazhdueshme e drejtorit Nino. Ai e kërkonte një vepër të tillë nga nxënësit e specialistët dhe ia arriti. Sot i shërben mësimi, shkollës e prodhimit. Këtu çdo vit marrin mësimë nxënësit, studentët e fermerët, - përfundoi ai.

Fjalët, mësimet e udhëheqja në punën praktike në fermë për tre-katër muaj më transformoi. Vërtetë kisha bërë mjaft punë bujqësore edhe nga vija, por me një regjim cilësie të



neglizhuar, të toleruar e pa një disiplinë kaq të rreptë. Këtu ndryshonte çdo gjë. Dhe unë po ndryshoja.

- Pse kështu? - Pyesja veten e po te vetja gjeja përgjigjen, - bëhet punë e cilësisë së lartë që të kemi produkt pune të mirë e shumë të mirë. Shihja fuçiat e drurit për mbajtje ver. Nuk kishin asnjë dallim për nga cilësia nga ata të stabilimenteve të drurit. Cilësia e verës që prodhohet në këtë fermë, dallohet nga të tjerat. Është model që duhet ndjekur. Pse nuk ndodhte kjo në kantinën tonë në ILB-në e Tiranës? Këtu gjithçka funksionon në mënyrë perfekte. Pse atje jo?

Këtë gjë mësova këtë kohë në koleji.

- Rubin, shih reklamat televizive se ku mund të gresh punë me kohë të plotë e pagesë më të mirë. Këtu vërtetë ke një farë page, por mos u pengo, - më foli një ditë Nino e më sqaroi se vendimin për pranim dekanati e ka marrë e pritët nga muaj dhjetor ta marrë dhe rektorati.

Vërtetë kështu ndodhi. Nino më njoftoi se rektorati i UMB më kishte pranuar si jashtë radhe për vetë statusin e veçantë që kisha e në vitin e ardhshëm akademik mund të isha pjesë e kontigjentit studentor të tij.

- Pse mund të jem? - pyeta,

- Po që të jesh me të drejta të plota duhet që të vijësh nga ILB i Tiranës të gjitha detyrimet e programit që ke shlyer, të kryqëzohen me ata të programit tonë, të konvertohen e në rast se do të ketë mungesa, duhet t'i plotësosh pa filluar viti akademik pasardhës.

- Si duhet të veprojmë unë në këtë rast? - pyeta.

- Asgjë. Veprimet do t'i bëjnë UMB me ILB-në e Tiranës në rrugë shkresore. Do të kërkohet që ILB t'i përgjigjet zyrtarisht kërkesës tonë, pastaj do të ndiqet procedura që të thashë. Shpresoj se këto ditë mund të niset shkresa drejt ILB të Tiranës.

- Faleminderit drejtor!
 - Po për të gjetur punë tjetër çfarë ke bërë?
 - Nga katalogjet e kërkesat televizive unë kam përzgjedhur disa ferma, por më e përshtatshme për mua është 'Kastel Blu'. Ajo vazhdon të kërkojë punëtorë me pagesë më të mirë se të tjerat si dhe të krijon mundësinë e vazhimit të shkollës e studimeve.

Nino qeshi e pyeti: - Si t'u mbush mendja?

- Është një fermë e madhe, ka një histori njëmijëvjeçare, zhvillon vetëm ullirin e ka lidhje të shumta me UM të Barit. Aty mund ta gjej veten mirë për një kohë të gjatë.

- Edhe unë i të njëjtit mendim jam.

- Do më ndihmosh?

- Po. Shpresoj të takoj këto ditë kontin, pronarin e fermës, e mes të tjerave t'i them apo paraqes edhe kërkesën tënde.

- Ju faleminderit! - fola u ndamë.

Në prag të Krishtlindjeve kolegji organizoi një festë për bujtësit vendas e emigrantë. Drejtori Nino mori pjesë me festuesit e në një rast më ftoi në tavolinën e tij.

- Rubin, gjerat po ecin mirë. Letra në drejtim të ILB të Tiranë është nisur.

- Po me 'Kastel Blu' si po ecin bisedimet?

- Me 5 janar do të jemi bashkë atje. Konti e miratoi kërkesën tënde. Kur i tregova pse e doni punën në fermën e tij, ai qeshi e u shpreh: - Qënka djalë interesant. Të vijë. E pres.



NË ‘KASTEL BLU’

Pas një udhëtimi drejt Barit u shmangëm diku djathtas e në një rrugë dykalimshe filluam të ngjitemi në një zonë disi të pjerrët. Kodra të buta, të sistemuara e të kultivuara me mjeshtri na shoqëronin në të dy anët. U gëzova. Po përjetoja bukurinë e një pune që do ta dëshiroja kudo. Aq më tepër në vendin tim.

- Shihe luginën djathtas. Si të duket? - pyeti Nino e ngadalësoi lëvizjen e makinës.

Pashë me vëmendje gjithë këtë masiv jeshil-blu e u ngazëlleva. Dielli i paradites rreflektonte mbi gjethnajën e pafund të ullirit e dukej sikur luante mbi valët e detit. Imazh bimor tronditës. Megjithëse kohë mesdimri, dukej verë gjethesh. Shijova kënaqësinë e punës që këtu kishte bërë njeriu. U ndjeva mirë.

- Këtu fillon ferma ku do të punosh ti. Vazhdon poshtë në atë rrafshirën ku duken ata serra e vazhdon në harkun e atyre kodrave e majtas nesh përfundon te qyteza ku po shkojmë. Punë njëmijë vjeçare që nuk e ka humbur asnjëherë shkëlqimin e kujdesin njerëzor, - sqaroi Nino.

Ndërkaq u gjendem para një pllaje ku ngrihej ajo, qyteza. Rrethuar nga një mur i lartë e nën një portë të madhe, futemi brenda saj, në një shesh të madh, shumë të madh e të strukturuar këndshëm.

Mbeta pa frymë. Pashë një qytezë të mbajtur aq mirë sa të harroje që aty ka njerëz e jetojnë përditshmërinë. Gjithçka e pastër, e përkujdesur.

- Një mrekulli! - foli.

- Kjo është dhe arsyeja që i zoti i vendit, konti di Napoli, ushtron kontroll e tregon kujdes të vazhdueshëm mbi çdo gjë në këtë vend.

Ndaloj makinën para një ndërtese trekatëshe me avlli e derë guri me strehë. Zbritëm.

- Këtu jeton familja e kontit prej afro një mijë vjetësh, - foli e tërhoqi një litar të hollë prej mëndafshi. U dëgjua një zile.

Pas pak nga një folëse elektrike doli zëri: - Urdhëroni! Sekretaria e kontit.

- Nino Ferreti jam, sipas porosisë së kontit.

Dera u hap dhe një maxhordom na udhëhoqi e na çoi te sekretaria e kontit.

Pas fjalëve të pritjes e politesës së zyrës sekretaria sqaroi:

- Konti ju kërkon ndjesë që nuk ndodhet këtu, por të gjitha detyrat e porositë ia ka deleguar administratorit të 'Kastel -Blu', - foli e ngriti receptorin e telefonit ku dhe formoi një numër:

- Po. Erdhi Nino.

Na përcolli deri te dera e u ndamë.

Në zyrën e administratorit gjetëm të shkruara të gjitha porositë e kontit.

- Do të marrësh menjëherë shpinë. Sot e nesër rregullo çfarë të duhet e pasnesër bëhu gati për punë, - foli ai. Nino dëgjonte.

- Dakord Rubin? - foli prap ai, por kësaj radhe duke më parë në sy e vazhdoi: -Do të vijë kujdestari i qytezës e do të jetë me ty për çdo nevojë.

- Mirë kështu? - pyeti e shikoi në sy Ninon e prap mua.



Ndërkaq hyri në zyrë një burrë i veshur disi sportiv e priti pa folë.

- Roberto, sot e nesër të rregulloni siç duhet shpinë e lirë për Rubinin. Është një hapsirë tetëdhjetë metër katrore, një dhomë e kuzhinë, e mjaftueshme për një djalë. Nesër takoje edhe me Umberton e fermës, pasnesër do të fillojë punën. Qartë?

- Po, - foli ai që quhej Roberto e qëndroi në këmbë, në pritje.

- Zoti Nino, ne me kaq mbaruam fjalët. Rubin mirë se erdhe, merru me Roberton. Qeshi. Qeshëm edhe ne, e u ngritëm në këmbë. Dolëm.

Në shesh Nino mori nga makina e tij një zarf e ma zgjati:

- Merre Rubin. Brenda ke llogarinë e mbyllur të punës tënde në kolegji. Sot për ty fillon një jetë tjetër. Të uroj suksesel!

U ndava me Ninon. E falenderova me gjithë zemër për kujdesin që kishte treguar për mua.

- Nuk kemi mbaruar bashkë, apo më mirë, sapo kemi filluar. Kolegji e 'Kastel-Blu' kanë raporte pune të përhershme, - sqaroi ai.

- E kisha fjalën për sa ke bërë deri sot për mua.

- Shumë mirë! Gjithë të mirat e të uroj punë të mbarë!

- Të faleminderit drejtor Nino!

U ndamë nën shikimin e habitur të Robertos.

Banesa ku do të flija ishte në katin e dytë, kishte një dhomë gjumi e një kuzhinë, një banjo të madhe e dhomë tharjeje. Ishte e pastër, e lyer mirë, por pa disa pajisje të nevojshme si gaz gatimi, telefon, televizor, duheshin lëshuar uji e dritat. Dhoma e gjumit kishte dollap e krevat me një dyshek, por duhen dhe gjëra të tjera. Në kuzhinë kishte vetëm një tavolinë me katër karrige. Pa frigorifer. Duheshin

plotësuar mungesat. I donte një jetë e rregullt që mendoja të bëja. Roberto mbante shënim. Me çelës në xhep, dolëm jashtë të takonim specialistët e këtyre punëve. Robertoja nuk më ndahej. Hymë nëpër markete. Porositëm: Çarçafë, batanie, këllëfë jasteku, divan, frigorifer, pajisje kuzhine, rrobalarëse e... bëmë llogarinë.

- I ke paratë? - pyeti Roberto.

- Po, - iu përgjigja.

- Nëse mbetesh hollë, e shtyjme pagesën e rrobalarëses për më vonë.

I miri Nino më kishte futur në zarf një llogari të mjaftueshme për të filluar jetën si i pavarur.

Paguam e dolëm. Lamë porosi për orën e vendin ku do të dërgoheshin materialet. Isha lodhur e kisha uri.

Si fillim dreka në lokalin e qytezës. Porositëm makarona.

- Verë? - foli Roberto.

- Jo nuk pi akool e as duhan. Jam marrë me sport e nuk i kam fituar këto vese.

Pasdreke u morëm me shpinë. Pajisëm dhomën e gjumit, kuzhinën, banjën, rregulluam gazin, ujin, korentin, vendosëm telefonin, televizorin, ngrohësin elektrik e u ulëm të pushonim.

Hapa çantën e madhe që më kishte lënë në ikje drejtor Nino ku gjeta dy shishe verë, disa pako biskota, djathë, sallameri e disa kuti qumështi, makarona, rroba e ilaçe larëse. -Çudi, kujdes nëne, -mendova e qesha.

- Pse qesh? - pyeti Roberto.

- Sa i mirë ky drejtor Nino. Është kujdesur shumë për mua.

Vura mbi tavolinë një shishe verë, dy gota e një pako biskota. Të tjerat i sistemova në dollap e frigorifer.

- Hape shishen e verës Roberto, - foli.



- E shikon, nuk ke hapëse, - foli dhe nga grupi i çelësave veçoi një si tyrielë të vogël që funksionoi e mbushi fundin e dy gotave.

- Mirë se erdhe Rubin, - më përshendeti.

- Mirë se të gjeta, - iu përgjigja unë, trokitëm gotat e ktheva një hurm vere.

- Edhe nesër bashkë do të jemi. Do të shetisim qytezën në gjithë çfarë ka brenda rrethimit. Banorët e qytezës duken indiferentë, por në vetvete janë të interesuar të njohin çdo banor të ri që bëhet pjesë e tyre. Do i njohësh e do të ndjehesh mirë mes tyre, - foli Roberto e u ngrit.

- Natën e mirë Rubin!

- Natën e mirë Roberto! Të faleminderit për ndihmën.

Kur mbeta vetëm, kontrollova kanalet e televizionit. Diku ndoqa disa minuta lajme e pastaj një film nga mesjeta europiane. Pashë që nuk rezistojta më. Isha lodhur e trupi im kërkonte gjumë. Fjeta e nuk u zgjova asnjëherë natën. Gjumë i mirë, pa andrralla. Si kështu?

Të nesërmen në mëngjes me Roberton fillova të njoh gjithë qytezën nga porta e madhe, murin rrethues e shpitë e qytetarëve anash tij. Porta ishte e veçantë për nga ndërtimi e objektet që e plotësonin, figura luftëtarësh, stema e figura shpendësh e kafshësh të egra të fusnin në një botë tjetër me stilin barok të ndërtimit.

- Tani ajo nuk mbyllet më, por dikur rrinte gjithnjë e mbyllur, hapej nga dy komanda, poshtë e sipër mbi mur nga rojet e armatosura, - sqaroi Roberto.

Muri rrethues në gjithë gjatësinë e tij ishte ndërtuar nga gur të mëdhenj gëlqerorë, të gdhendur e që reflektonin siguri e mjeshtri të lartë. Kudo anash murit nga pjesa brenda kishte ndërtesa për banim si dhe për shërbime artizanale, tregtare, zyra, magazina, pra të gjitha shërbimet publike banorët i gjenin këtu. Në orën 12-të ishim te dera e kishës. E ndërtuar

në të majtë të qytezës, afër shpisë së kontit. Një ndërtesë hijerëndë, e lartë, me një këmbanore të veçantë. Ngjitur ka edhe qelën, një pallat dykatësh me rrugë e lulishte të strukturuar hijshëm. U futem brenda kishës. Po ngrihej mesha e prifti po bënte punën e tij. Roberto bëri kryq. Unë me përtesë pas tij. U ulëm në një stol. Roberto thoshte uratët, ndiqte priftin. Unë jo. Mërmërisja. Në fillim nuk më bëri përshtypje padijenja ime, por në fund të meshës u bëra me turp. Dallohesha për keq. Unë e vendi nga vija ishim të tillë: të dalluar për keq. Si delja e zezë në tufën e bardhë.

Hodha sytë në tavanin e saj e anash në mur. Piktore të famshëm kishin derdhur talentin aty në piktura, trupore shenjtorësh e njerëzish të perëndisë.

- Ti Rubin katolik je? - pyeti si me drojtje Roberto kur dolëm prej kishës.

- Po, por unë kam lindur në vitin 1968, kohë kur në vendin tim kishte një vit që ishin mbyllur kishat e im atë ishte komunist. Edukimi fetar ishte ndërprerë e për katolikët filloi një urrejtje shtetërore që vazhdon dhe sot. Jo vetëm meshtarët, por edhe nëpunësit katolikë shiheshin me sy të keq.

- Pse kështu?

- Tek ne katolikët cilësohen nga formimi si latinë liberalë e rrinë si ngushtë në pjesën tjetër të popullsisë. Nga kultura që mbartnin ishin të paarritshëm, nga ndikimi në publik ishin ëngjëllorë, nga dashuria për atdheun ishin të pamposhtur. Myslimanët e ortodoksët kanë një aleancë të fshehur në kurriz të katolikëve, e që vazhdon, - thoshte shpesh im atë.

- Janë dënuar tek ju myslimanët e ortodoksët?

- Shumë pak. Sa me thënë. Kam mësuar se pothuajse të gjithë meshtarët katolikë u vranë ose u dënuan për fajin e vetëm se donin vendin, Zotin e Papën.



- Si e gjykojnë shqiptarët konvertimin e tyre në fenë myslimane? - pyeti Roberto.

- Me sa kam kuptuar unë, kthimi në fenë muslimane ishte gabimi më fatal në histori i shqiptarëve e që do e vuajmë për një kohë të gjatë.

- Pse?

- Me këtë konvertim shqiptarët humbën disa nga vetitë më të vyera që kishin, punën, besën, burrërinë, trimërinë, atdhedashurinë e mbi të gjitha u prish gjaku arbër.

- Si u prish gjaku arbër?

- Në gratë u përhap edukata e haremit, u bënë objekt bukurie e riprodhimi natyror të breznive. Vetëm kaq. Ajo, gruaja, humbi vendin e nderuar të mëmëzonjës që kishte në familje.

Pas meshe vazhduam njohjen e qytezës.

- Kjo mrekullia para në stilin barok është shpia e kontit, - sqaroi Roberto.

- Po kjo kulla e lartë sipër saj për çfarë shërben?

- Për të parë jashtë mureve, në pyll e fermë. Konti e ka shumë për zemër fermën e gjithë jetën pasardhësit e tij kanë punuar për ta zhvilluar atë.

- Kjo tjetra është ndërtesa administrative e kontesë, këtu punoj edhe unë.

- Edhe këtë e di. Dje aty u takova me administratorin e me ty. Harrove?

- Kjo është infermiera e kjo me oborr të madh është shkolla elementare, kjo tjetra me zbukurime e dritare të mëdha është muzeu e biblioteka. Këtu është historia e 'Kastel Blu'. Nëse të intereson, këtu mund të mësosh gjithë misterin që ka shoqëruar prej njëmijë vitesh ndërtimin e qytezës. Të shtunave e të dielave rri hapur nga ora tetë e mëngjesit deri në orën tetëmbëdhjetë.

- Këtu më tej vazhdojnë shpiat e specialistëve të fermës, punëtorëve e njerëzve të përkohshëm që vijnë në fermë në kohë të ndryshme.

- Si mund të jenë këta njerëz të përkohshëm?

- Studentët e Universitetit Mesdhetar që vijnë për të realizuar këtu praktikat e prodhimit, të fermerëve që vijnë për konferenca, të turistëve agrarë e të njerëzve shëtitës që shpesh kalojnë në këto anë në qejfin e tyre.

- Më bëjnë përshtypje ndërtesat e vjetra të qytetës ashtu si dhe muri rrethues.

- Vërtetë ata janë të vjetra në kohë, por kolonat, veprat skulpturore, ballkonet e zbukuruara e kulmoret, të gjitha në stilin barok, e bëjnë kaq të bukur e hijerëndë këtë vend që të imponon respekt. Këtë e thonë të gjithë ata që vijnë për të parën herë këtu. Kështu thotë edhe konti i ri. Por sot njerëzit duan të shpejtën, të përditshmen ndaj edhe gabojnë. Bile duan disi edhe gabimin. Si mësim.

- Gjithsesi, kjo më duket një qytetë shumë e veçantë e shumë interesante, - fola.

- Këtu një njeri i ditur e i vëmendshëm gjen pak Napolin te kulla e kontit, Romën te kisha e Toskanën te ndërtesat e tjera. Dorë arkitektësh. Kaq di. Për më tepër kuriozitetin do ta shuani nëse do të lexoni materialet që ndodhen të arkivuara në bibliotekë.

- Sa hektarë është e gjithë sipërfaqja e sheshit brenda murit rrethues?

- Njëqind e tridhjetë e shtatë hektarë, - ishte përgjigjja e tij.

- Nuk më mbush syrin për kaq.

- Ashtu të duket, se përveç ndërtesave ka dhe rrugë, rrugina, lulishte, pemë të mëdha e të vogla, dy përmendore, shatërvanin e madh afër kishës, dhjetëra stola e ndenjës druri e guri si dhe dy parkingje makinash.



- Po këto portat e tjera për çfarë shërbejnë?

- Ajo nga verilindja të çon në pyllin e kontesë. Aty shpesh familja e kontit, por edhe bujtësit dalin e shetisin. Pylli është një ambient natyror i mrekullueshëm. Përveç ajrit të freskët, aty gjen shpend të ndryshëm e kafshë që të shoqërojnë.

- Kafshë?

- Po. Lepuj, dhelpra, breshka, ketra e shpend gjithfarësh që ruhen nga shteti e konti.

- Po kjo porta nga lindje-perëndimi?

- Kalon një rrugë që, sapo del prej qytezës, ndahet në dy degë, njëra shmanget majtas e shkon tek gurorja ndërsa ajo djathtas të çon tek liqeni që furnizon me ujë qytezën dhe gjithë fermën në çdo kohë të vitit.

- Këto janë tregoret, ku në çdo kohë mund të blini çfarë të doni.

Kur blemë ushqimet, me çantat plot u nisa drejt shpisë.

- Të faleminderit Roberto për këto dy ditël - fola.

- Ende nuk kemi mbaruar, pasdreke diku nga ora shtatëmbëdhjetë në magazinë vjen kryepunëtori, Umberto. Do të takohemi me të, të marrësh rrobat e punës e të lini orën e vendin e takimit për nesër. Të nesërmen, i veshur me rroba pune, u ngjita në fugonin ku ishin edhe punëtorët e tjerë dhe Umberto. Ai m'u afrua e më tha:

- Këta janë shokët e tu të punës e ti je më i riu mes nesh. Mirë se erdhe!

Pas dhje të-dymbëdhjetë minutash zbritëm në një lëndinë. Ullinjte ishin mbjellë në brezare. Mbase pesëdhjetë vjeçarë. Morëm shkallët, gërshërët, sharrat nga një magazinë e filluam nga puna. Unë me Umberton apo ai me mua. Ai kryepunëtori, unë punëtori i ri. I ri në

moshë e si detyrë. Seicili nga punëtorët morën nga pesë rrënjë. Edhe unë e Umberto.

- Fillojmë, - foli, mori gërshërët e më pyeti: Ke krasitur ndonjëherë ullinj.

- Jo. Ullinjtë që kemi pasur në kopësht, ishin të shtetit, i krasitnin të tjerët. Kam bërë vetëm praktikën mësimore me kursin teorik e diçka di.

- Si do ta krasitësh këtë rrënjë? - pyeti.

- I tregova ato gjëra që mendoja të bëja. Ai më dëgjoi me vëmendje e foli thjeshtë: bëje.

Më shikonte e bënte vërejtjet e tija: Mbaje mirë gërshërën. Prite siç duhet degën. Pse e lë këtë filiz e të tjera e të tjera pyetje.

Unë sqaroja si dija e vazhdoja punën duke thirrur në ndihmë teorinë e mësuar në libra e aq praktikë, pothuajse laboratorike që kisha bërë në Institut.

Umberto vlerësonte, pranonte punën time e shtonte të tjera. I diskutonim deri sa binim dakord. Punoja. Mbaroi pema e parë.

- Tashti fillo pemën tjetër. Unë pemën time, - tha e mori shkallën e tij. Vazhduam të krasitnim. Ai me bisht të syrit më kontrollonte. Në fund, kur kisha mbaruar, më thirri te pema që kishte krasitur ai. -Shihe, ke ndonjë vërejtje? E pashë e vura re se diçka nuk ishte kryer mirë. Ia thashë. Ai qeshi e tha: - Bëje siç duhet. Hip në shkallë e riparroje. Preva degën tepër e zbrita, Umberto foli:

- Shohim tani pemën që krasite ti.

- Mirë, po kjo dega këtu, dhe kjo, e kjo. Gjëra të vogla, por rregulloji.

Pas ditës së parë, vazhdova pothuajse i pavarur të punoj. Umberto më hidhte nganjëherë sytë, por unë me vëmendje ndiqja pikësynimin tim. Të mësoj që të punoj mirë. Duhet të formoj veten. Egon time.



Në fund të javës, kur po ktheheshim në qytezë, Umberto më përgëzoi: - Asnjë student nuk ka mësuar kaq shpejt të krasitë. Tani nuk ta kam frikën. Gabime të vogla mund të bëjmë edhe ne që i kemi duartë gjithë kallo me këtë punë. Bile ndonjë gabim edhe na duhet, jo se jemi njerëz të gabimeve, por se mësojmë prej tyre.

Pas krasitjes vazhduam me shërbimet e tjera. I ndiqja me dëshirë. I zbatoja me vullnet. Doja që me punë të mësoja, bile shumë e shpejt. Ndryshe do të dështoja në synimin tim.

Të shtunën mora nga shpia në telefon drejtorin e kolegjit Nino Ferretin. Ishte në zyrë. Më njohu menjëherë nga zëri.

- Alo! Zoti Nino?

- Të përshendes! Të mora të të njoftoj se kam një javë që jam punonjës i 'Kastel Blu' e po merrem me krasitjen e ullinjëve. Gjeta një përvojë të mirë në mendjen e duart e specialistëve të fermës. Dua ta bëj pjesë të egos time.

- Shumë mirë! Përpiqu të marrësh më të mirën e punës së tyre e vazhdoi: Me shpi u sistemeve?

- Po.

- Si po e kalon kohën e lirë sot?

- Sport e do të shkoj në bibliotekë.

- Shumë mirë! Shih e lexo fillimisht historikun e qytezës dhe në një kohë të dytë edhe zhvillimin e fermës. Janë një histori interesante zhvillimi e çdo njeri ka çfarë të mësojë aty. Aq më shumë ti. Unë i kam lexuar që herët me vëmendje. Kanë qënë e janë një shkollë e veçantë për punën time.

- Të falemnderit! Të mora edhe për të të thënë që ky është numri im i telefonit.

- Mirë Rubi. Për çdo nevojë e problem më telefono. Nuk i harroj kërkesat e interesat tuaja. Mirupafshim! - foli e uli receptorin.

Me këtë përshëndetje të ngrohtë dola nga shpia në bibliotekë. Hapa derën e saj, përshendeta nëpunësen e u ula në një karrige që kishte para saj një tavolinë të madhe, të rëndë.

- Urdhëroni, çfarë mund t'ju shërbej? - foli ajo.

- Unë kam ardhur të punoj e të jetoj këtu. Dëshiroj të di historikun e qytezës, të fermës e protagonistët e saj. Këtë, nëse keni mundësinë, e dua si histori të shkruar e projektuar të asaj kohe fillese deri më sot.

- Nga akcenti nuk më dukeni Italian? - pyeti ajo.

- Përbën ndonjë problem kjo për kërkesën time?

- Jo. Familja e kontit e ka lënë të lirë leximin e njohjen e çdo historie të personazheve të kontesë, e kaluara nuk përbën më të fshehta denigruese.

- Pse po më thoni këtë, apo parathënie?

Nuk foli, por i drejtohet një dollapi të vjetër dërrase e nxori prej aty një si libër me disa dorëshkrime në formate të ndryshme. Dorëshkrimi i parë: "Historia e familjes di Napoli e ndërtimi i qytezës" e vazhdonte me: "Krijimi i fermës, pyllit e liqenit".

- Kur të mbarosh së lexuari do të kuptosh çfarë të thashë në fillim, - foli e u largua e qetë.

Fillova të lexoj me vëmendje e dëshirë të madhe, pa ndërprerje rreth katër orë, pushova pak e fillova të mendoj. Në tavolinë me mua kishte dhe të tjerë që lexonin në interes të tyre. Dola në ballkonin e madh barok për pak pushim apo për t'u menduar për çfarë lexova:

Në fundin e mijëvjeçarit të parë mbreti tridhjetëvjeçar i Napolit pati një djalë jashtë martesë me një kushërirë të tij, pra një fëmijë bastardh. Si të tillë e fshehu në kujdestarinë e një menteshë çekreze. Djali u rrit shpejt dhe i ngjante shumë atij. Çdo ditë i shtohet dashuria për këtë fëmijë. Ekzistonte rreziku të zbulohet e për të larguar çdo dyshim,



bëri një plan të hollësishëm. Të ndërtonte larg prej këtu një qytezë disi ndryshe nga qytetet italiane e aty të sillte bastardhin e tij Pietro di Napoli e ta siguronte. Për këtë qëllim, u bleu një pllajë të harruar që nga shembja e perandorisë romake autoriteteve të Barit, thirri arkitektin më të mirë të Romës, Bruno Orfeu, që ishte dhe ky napolitan e me të shetiti pronën e blerë. I tregonte interesat e tij:

- Këtu duhet të bëhet qyteza e ardhëshme. Do të rrethohet nga një mur i lartë pesë metra, i gjërë tre metra. Në hyrje të rrugës perandorake do të ndërtohet porta e qytezës që do të jetë shumë e bukur, por edhe e fortë. Muri do të rrethojë gjithë pllajën e do të ketë edhe dy porta të tjera, njëra vazhdim i rrugës së vjetër e tjetra nga pylli i zi. Portat duhet të kenë masa sigurie të larta se këtu banditët e Adriatikut janë kërcënim i përhershëm. Pas projektit të murit do të bësh atë të kullës së kontit, tre katëshe me vrojtore, me ballkone e kulme, si në Napoli. Në vazhdim kisha, e veprat e tjera bujtëse e tregtare. Në mes një shesh i bukur e mjaft i veçantë me pemë, rrugica e një shatërvan të madh.

- Po uji?

- Ujin e kemi sipër, tek liqeni.

Pas një farë kohe projekti mbaroi e iu paraqit për miratim mbretit Ferdinand. Në të dalë të dimrit, mbreti thirri ndërtuesin e famshëm toskanas Brido Monte e me të shkoi në pllajën e largët ku bëri njohjen me projektin e ri në prani të arkitektit Orfeu. Aty arkitekti, ndërtuesi e vetë mbreti bënë një marrëveshje zotërijsh për ndërtimin e shpejtë të qytezës së re.

Një kompani ushtarësh mbretërorë ngritën çadrat e morën detyrat ruajtëse për ndërtuesit e shumtë e kantieret e punës në gurore e pllajë.

U vendosën piketa të shumta e filloi gjurmimi i kanaleve ku do të hidheshim themelet e murit të ardhshëm mbrojtës. Karroca e qerre të panumërta sillnin nga gurorja e vjetër gurë e i shpërndanin anash kanalit të hapur. Në shesh thyheshin gurët gëlqerorë me çekiç e me një lloj makine. U bë një grumbull i madh granili. Tymi i gëlqereve që digjeshin atje në mal vinte deri në pllajë. Tre grupe gurëgdhendësish punonin sipas projekteve për çdo portë për të përgatitur veshjen e tyre.

Në fillim të pranverës filloi puna ndërtuese në tre sektorë, apo në portat e ardhshme me nga dy grupe punuese në anat e tyre. Kuptohet se forca të shumta u vendosen në dy anat e portës kryesore. U mbush kanali me gurë e filloi ndërtimi i tyre. Arkitekti Orfe e ndërtuesi Monte u rrinin mbi krye punëve, kontrollonin vendosjen e çdo guri, vepre artistike a monumentale në të. Kur filloi ndërtimi i harkut, puna komplikohet më shumë, por specialistët piemontezë dinin çfarë bënin. Vendosja e gurëve të përgatitur me parë ishte e llogaritur saktë në projekte megjithë vështirësitë që krijonte siguria e saj. Porta hyrëse doli më e bukur e më imponuese nga sa ishte menduar. Ndërtohet edhe rruga sipër saj me kullat e rojeve e rulat që tërhiqnin derën metalike sipër. Majtas e djathtas saj ndërtimi i murit ecte me shpejtësi me gjithë kërkesat e larta teknike të arkitektit. Kurora e tij mbyllej me gurë të përgatitur më parë e mes tyre formohej një rrugë që shtrohej me pllaka guri të sjella nga gurorja. Puna vazhdonte edhe në dy portat e tjera. Në vjeshtë në të tri portat u vendosen rojet ushtarake e natën ata mbylleshin. Gjatë dimrit puna ngadalësohet, por në pranverë do të rifillojë përsëri me vrull e disiplinë të madhe.

Pas një viti mbreti Ferdinand vjen nga Napoli e kontrollon me vëmendje punimet e kryera e ata në vazhdim.



- Nuk dua mure, por vepra artistike. Më duket se duke filluar nga porta kryesore keni bërë shumë lëshime si në veshjet e brëndshme, vendrojet e... korigjoheni. Paratë nuk ju mungojnë e specialistë keni në të gjithë Italinë. Sot një vit dua gjendje e cilësi tjetër, ndryshe do të dyshoj tek ju se ku shkoj mjeshtria e dora e artë e ndërtuesit italian. Mjerë ju atëherë!

Iku. La pas kërcënimit e kërkesën për një pune ndryshe, cilësisht shumë më të mirë që e vuri në dridhima arkitekt Orfeun.

- Kërkohen ndryshime të mëdha në punën që e kemi quajtur të kryer e asaj në vazhdim.

- Po si duhen bërë?

- Modelin e kemi në Romë, Firence, Venecie e kudo në qytetet taliane. Të përmirsojmë projektin tonë e me çdo kusht të bëjmë atë që kërkon e i pëlqen mbretit. Si tha ai? Këtu do të ngrihet një qytet i vogël, por me shkëlqim të madh. Kështu do ai. Ashtu do ta bëjmë.

- Shumë duhet të prishim nga ajo që kemi bërë e ta nisim nga e para.

- Të fillojmë që nesër.

Vërejtjet në portën kryesore u bënë mësim për të gjithë punën e në pranverën tjetër mbreti erdhi prap. Shikoi gjithë punën e bërë. Nuk pyeti se kur mund të mbaronte rrethimi, por dha porosi që krahas murit rrethues të fillonte ndërtimi i kullës së ardhshme të kontit. Rrethimi përfundoi në vitin e katërt e kulla vazhdonte të ndërtohej si diçka e veçantë për nga stili e kujdesi.

Me përfundimin e rrethimit, toga ushtarake e sigurisë qarkullonte në rrugën sipër tij, në shkallët që të çonin atje, në frëngji e vrojtore, me kontroll të përforcuar tek tri portat që u dhanë siguri ndërtuesve.

E fundit filloi ndërtimi i kishës së Shën Lukrecias. Ajo do të ishte një punë e veçantë për çfarë do të mbante brenda e do të përfaqsonte.

Në vitin e gjashtë mbreti u rikthye në pllajë e te porta e madhe e pritën me frikë Orfeu e Monti. Ai zbriti nga karroca para saj e me kureshtje të shtuar filloi nga jashtë kontrollin mbi punën e kryer. U kënaq, por nuk e shprehte. Kaloi portën e madhe. Hipi në shkallët anash murit e nga rruga sipër tij kontrolloi punët e kryera e ata që po ndërtoheshin në shesh. Pas tij sekretari shkruante çdo vërejtje e fjalë që në të rrallë shprehte ai. Qyteza ishte gati. Priste kontin e ri.

Kur Petro di Napoli ishte 21 vjeç, erdhi në qytezë me gjithë shpurën e tij të shërbimit. Ishte fillimi i verës e sheshi, rrugët, rruginat, shatërvani, pemët e lulishtet kishin përfunduar, gjelbërimi e lulëzimi ishin në kulmin e tyre që e mrekulluan kontin e ri. Vazhdonte puna me kishën. Ishte ndërtuar çatia, por puna pikturike në të vazhdonte në shumë vende, në disa kishte përfunduar dhe në disa ende nuk kishte nisur. E gjitha ishte nën kontrollin e një abati nga Vatikani e të disa murgjëve të rreptë benediktinë.

Me të zënë vend në ndërtesën e tij, konti filloi nga puna. Nga porta e verilindjes ku shtrihej pylli i zi një ditë vjeshte doli me një grup teknikësh e rojesh. Pylli ishte i zi se ishte i dendur, plot me ferra e gjithfarë lloj bimësh e pemësh të egra. Po konti e donte ndryshe e dha porositë: Të hiqen ferrat, bimët e drurët e tepërta që të formohet një pyll i lartë, me dritë e i pastër. Të duket edhe qielli. Në gjithë sipërfaqen të ndërtohen rrugë të shtruara me pllaka guri e granil si dhe në vendet më të bukura të vendosen stola druri për ndenje e kolibe apo kasolle për të pushuar. Në dy burimet natyrore dha porosi që të ndërtohen lëfyte për të pirë ujë njerëzit shetitës, pse jo edhe shpendët e kafshët që do të jetonin aty.



- Qartë? - pyeti shoqëruesin e ata që i vinin mbrapa.

Kur puna në qytezë e në pyllin e zi po shkonte drejt fundit, kontit iu ndez dëshira e krijimit të një ferme bujqësore. Në kodrat e buta dhe luginën mes tyre në të djathtë të qytezës kishte disa lëndina që shërbenin vetëm si kullota. Ai vendosi që këto prona të mos i linte kështu fole të egërsirave, por t'i mbillte pemë frutore e perime. Njerëzia që jetonin e shtoheshin në qytezë, donin punë e ushqim. Me kalimin e viteve lëndinat u zmadhuan, pyje e ferra pritëshin e sipërfaqja e kultivuar rritej. U mbollën ullinj e dardha, kumbulla e qershi, pjeshka e fiq, mana e shumë lloje pemësh e perime që u bënë kujdesi i vazhdueshëm i familjes së kontit.

Në shekullin e 14-të kohë kur gadishulli Apenin po kërcënohej nga perandoria turke, mbreti i Napolit miqësohet me princin shqiptar Gjergj Kastrioti, një ushtarak e diplomat i zoti. Në ndeshjet e para të ushtrisë shqiptare të kryesuar prej tij me ushtrinë turke ajo korri fitore të bujshme që tërhoqi vëmendjen e mbretërive të Europës e u lidhën me të.

Lidhjen më të qëndrueshme princi shqiptar e bëri me mbretin e Napolit. Po kur e pse erdhën këto marrëdhënie?

Për të gjallëruar e forcuar marrëdhëniet me Mbretërinë e Napolit, Skënderbeu e gjykoj të nevojshme t'i jepte ndihmë ushtarake mbretit Ferdinand në luftën që kishte shpërthyer midis tij dhe kundërshtarëve të vet politikë, që ishin baronët e Italisë së Jugut.

Në shtator të vitit 1460 Skënderbeu dërgoi në Itali grupin e parë të luftëtarëve të drejtuar nga i nipi, Koiko Stres Balsha. Zbarkimi i trupave shqiptare në Itali shkaktoi tronditje të thellë në radhët e kundërshtarëve të mbretit Ferdinand. Në fund të gushtit të vitit 1461, në krye të 2-3 mijë luftëtarëve, Skënderbeu u nis vetë për në Itali dhe

zarkoi në Barletë, ku gjendej i rrethuar mbreti Ferdinand, bashkë me një pjesë të ushtrisë së vet. Luftëtarët shqiptarë, me Skënderbeun në krye, me të zbritur në tokën italiane, filluan sulmet energjike e shumë të shpejta, duke shkaktuar panik në radhët e forcave kundërshtarë. Luftëtarët shqiptarë i dhanë një ndihmë të vyer ushtarake mbretit Ferdinand për të shpartalluar kundërshtarët e vet dhe ndikoi në gjallërimin e marrëdhënieve të Skënderbeut me Mbretërinë e Napolit dhe aleatët e saj.

E në të gjitha raportet me Napolin e Romën ushtria e prijësit shqiptar kishte si vend strehimi në ardhje e dalje nga Italia qytezën e pllajës. Në udhëtimin e tij drejt Romës e Napolit konti takohet në qytezë me prijësin shqiptar e shetitën pyllin e fermën e krijuar prej familjes së tij.

- Poshtë kështjellës time në Krujë ka kodra të buta e të gjelbërta. Kam menduar që të zëvendësoj pemët e egra me bimën e ullirit.

- Dakord, po si do ta bësh këtë mrekulli princ?

- Në rrespekt të dashurisë e jetës çdo çift i ri para se të martohet duhet të mbjellë dy fidana ulliri, veprim që po zgjerohet me sukses dhe në qendrat e tjera që ka shteti i Arbrit. Këtë propozim ua bëra princave të lidhjes. Ata që e kultivonin këtë bimë e miratuan. E, para se të vija këtu, inspektova kalanë e Lezhës e isha dëshmitarë që dy të rinj, në respekt të këtij vendimi, po mbillnin dy fidana ulliri në qafëkala para se të fillonin jetën e re në martesë.

- Ide shumë e mirë e shpresoj që të gjithë të rinjtë edhe tek ne do ta pranojnë një kurorezim të tillë. Lumturi e madhe të fillosh një jetë të re me dy mbjellje fidanash ulliri.

Pas këtyre shkrimeve që më çuan në thellësi të historisë së vendit tim vazhdova të lexoj ditë pas dite dorëshkrimet e hartat e zgjerimit të mbjelljeve nga një kopësht në një fermë, nga mbjellje me shumë lloje pemësh në një



plantacion me ullirin kulturë të vetme. Tashmë nuk ka vetëm një ambient të dëshirueshëm, por një dashuri me hapsira të pafundme gjelbërt-blu. Kjo çoi edhe në atë që profesor Altimari nga Kozenca, pas shumë historishë që kishte dëgjuar e pamjeve që i kishin rrokur sytë, ta quante në vitin 1923 me dashuri e respekt gjithë qytezën e fermën bashkë në një emët të përmbledhur: 'KASTEL BLU'. Dhe konti e pëlqeu shumë këtë emër, e miratoi e ashtu vazhdon të quhet zyrtarisht dhe sot. Shtesë e qytezës.

Për të parë më mirë shtrirjen topografike të fermës kontrollova dhe hartat, nga ata Kastaldi deri te ata topografike kadastrale. Sipërfaqja e fermës ka ardhur duke e zgjeruar vazhdimisht. Kjo si nevojë, por edhe si detyrim që rreth qytezës të krijohet një bukuri natyrore, pasion i vazhdueshëm i pasardhësve di Napoli.

Në mënyrë të veçantë kjo dashuri familjare drejtohet tek bima e ullirit e mori përmasa të mëdha në dy shekujt e fundit. Zgjerohet me dy kodra në mbarim të luftës së dytë botërore ku hoqi makjet e mbolli ullinj për vaj. Në fund të pllajës, në fushëtirë kishte qënë një sipërfaqe kenetë. Qeveria e Musolinit tentoi ta thante në interes të saj, por i mbeti aksioni në gjysëm se kapitulloi. Në vitin 1950 konti kërkoi lejen e qeverisë që ta çonte në fund projektin e nisur nga Musolini. Mori në punë inxhinierë hidraulikë, topografë e teknikë si dhe disa eskavatorë e pas një viti, në pranverën e vitit 1952, uji i ndenjtur rrodhi e u largua. Në vjeshtën e ardhëshme ujërat e shplanë kënetën e rrodhën pa krijuar probleme në kanalet kulluese të hapura gjatë verës me projekte të studiuara mirë.

Pas një viti aty filloi ndërtimi i fabrikës së vajit dhe i konservimit si dhe projekti për një fidanishte moderne. Konti donte që me këto investime të disafishonte vlerën e prodhimit të 'Kastel- Blu' të shiste vaj e pak kokrra, të

prodhonte fidana ulliri shumë cilësorë për veten e të tjerët kudo në Mesdhe. Ai mendonte si shkencëtar.

Nisur nga kjo dashuri për këtë bimë e produktin e kësaj, ai investoi që liqeni krahas ujit për qytezën të sigurate edhe ujin për fermën në periudhën më të thatë të vitit. Inxhinierë hidro e meteorologë studiuan e projektuan ngritjen e digës natyrore të liqenit duke e pajisur me shkarkues sigurie e shpërndarës të komanduar të ujit në të gjithë fermën deri tek çdo rrënjë ulliri. Po kështu ndërtoi rrugë lëvizëse mjeteshe dhe përmirson vazhdimisht mekanizimin e kryerjes së punimeve në fermë. Bile është hedhur ideja e po planifikon blerjen e një avioni që ta përdorë kryesisht për fermën. Baza mekanike që ka ngritur, po pasurohet çdo ditë me traktorë e makineri të reja e moderne.

Të gjitha këto i lexova në bibliotekë për disa të shtuna rresht, në këtë arkiv të saj që nuk është më sekret e bordi ndihmës i kontit dërgon në formë fashikujsh të gjitha vendimet që merren për fermën e qytezën. Për këtë qëllim konti planifikon çdo vit një fond për bibliotekën, pjesë e fitimeve që sigurohet nga shitja e produkteve të fermës.

U gëzova për çfarë mësova. Aty kuptova që konti ka një shpirt të mbushur me dashuri sublime për fermën, për ullirin e njerëzit që i shërbejnë asaj. Ndofta këtu duhet gjendur edhe çelësi i këtij sukcesi. E respektoj dhe e shoh të motivuar këtë raport të familjes di Napoli që po më nxit e më krijon ndjesi të veçanta për këtë pllajë ku dielli e natyra i japin jetë një mbretërie mahnitëse të gjelbër-blu prej gjethesh ulliri. Ëndërr, e punë madhe! E më vjen keq se në vendin tim, me kushte të njëjlojta nuk ka një fermë ulliri. Këto bimë të shenjta janë pothuajse të shpërndara në ultësirën bregdetare, por pa rregull, si murgjit, të heshtura



e të trajtuara pa kujdes. Kur mund të bëhet një fermë ulliri në Shqipëri?

Nisur nga këto mësimet e dëshira po përgatitem të punoj gjatë këtu. Ndryshe nga brezi im. Jo të shfrytëzoj punën e paraardhësve, por të bëhem pjesë e suksesit në vazhdim. Zot i punës. Ky është qëllimi, të bëhem i aftë të punoj me duar e mëndje. Raporti mes tyre shpresoj që të jetë në favor të punës mendore. Me duar rregulloj disa pemë, por me mëndje shumë e më shumë. Zgjidh! I them vetes e të ndjehesh mirë mes tyre.

* * *

- Alo Rubin. Ka një problem që lidhet me ILB të Tiranës. Kërkesës tonë ende nuk po i përgjigjet. Nëse ajo nuk vjen deri në fund të korrikut, rrezikohet vazhdimi prej teje në vitin akademik vijues, - sqaroi drejtor Nino një ditë mesqershori.

- Edhe mund të ndodhë kështu. E keqja të vjen ndonjëherë nga nuk e pret, bile andej ku ke shpresa më shumë, - fola i zemëruar.

- Gjithsesi ne po presim. Kemi venë në lëvizje dhe punonjësit e ambasadës tonë në Tiranë.

- Të falemnderit, por atje në vendin tim, është një rrëmujë që nuk e merr vesh i pari të dytin. Ndryshimi i sistemit ka ndryshuar shumë gjëra, edhe rregullat e interesat.

Pas kësaj bisede ra prap telefoni : - Alo Rubi? - u dëgjua një zë disi i çjerrë vajze.

- Po Rubini jam.

- Jam Zana. Kemi menduar që të dielën me Kenën e Marion të të bëjmë një vizitë e të kalojmë drekën me ty.

- Mirë se të vini! Këtu ju pres.



- Mirë ju gjetshim! - foli Zana e uli receptorin.

Të dielën në mëngjes dola e bëra një orë vrap në pyllin e kontit. E ndjeja veten mirë në ajrin e freskët e shumë të pastër, me zgjimin e ditës e rrezet e diellit që depërtonin pjesëshëm mbi barin e njomë. Aty vrapoj unë e shkrifëroj muskujt, por edhe të tjerë në të gjitha moshat. Të gjithë në heshtje sikur falenderojmë familjen di Napoli që na ka krijuar një mundësi të tillë. Pas mëngjesit dola në shesh i freskët e gjithë gëzim. Para kishës kishte njerëz që prisnin të fillonte mesha. Ishte edhe Roberto me gruan e vajzën. U takova me të.

- Ku humbe? - ishte fjala e parë e tij sapo më pa.

- Në punë gjithë ditën.

- Ke ndonjë problem nga shpia?

- Jo.

- Nëse do, numrin tim të telefonit e ke. Mos më kurse.

- Të falenderit për çfarë më ke afruar, je treguar mik i mirë! - foli e u ndamë.

Ndërkaq makina e Marios u fut në parking. E njoha menjëherë 'JEEP'- in e zi. Zbritën Kena, Zana e i fundit Mario. U takuam.

- Shumë mirë qënke! Dielli të paska parë si tepër, - foli e para Zana.

- Edhe duart i paske më të vrazhda se zakonisht, si kështu? - pyeti Kena.

Mario më hodhi krahët në sup e si për të kundërshtuar vajzat foli:

- Paske fituar hije mashkulli të fortë.

- Vërtetë punoj shumë, por vetëm në pamje kam pak ndryshime. Jam mirë e i kënaqur me çfarë bëj e mësoj çdo ditë, dielli e klima nuk më mundin, i kam miq. Më japin rreze që më zbardhin disi flokët e më nxijnë lëkurën, por nuk më lodhin.



- Gjithsesi fermë është, - më kundërvihet Kena.
- Po, por jo si ata fermat që i kishe frikë ti në Shqipëri.
- Si kanë qënë ato? - pyeti më shumë për kuriozitet

Mario.

- Ishte një vend ku rrugët ishin gjithë baltë në dimër e pluhur në verë, ku në shpia uji e dritat iknin shpesh, ku shërbimet jetësore ishin të mangëta e që përdorej si vend dënimi të njerëzve nga pushteti.

- Si duhet ta kuptojmë këtë thënie?

- Shumë familjeve në marrëdhënie jo miqësore me pushtetin nuk u sigurohej kualifikim e punë për fëmijët e tyre. Ata dërgoheshin në fermë të hapnin kanale, të pastronin stallat nga plehu, të rritnin derra, lopë e pula. Puna përdorej si dënim e kërcënim.

- Puna ishte vrarë.

- Si vrarë? - pyeti Mario.

- Puno sa të duash nuk fiton gjë, bile është poshtëruese, pa motive.

- Një fat të tillë do të kishe pasur dhe ti Kena?

- Po. E kam të qartë.

- E kupton se ferma këtu është tjetër gjë.

- Si tjetër gjë? - pyeti Kena.

- Këtu paguhem shumë mirë. Kam shpi të mirë, shërbime jetese po kështu të mira. Shiheni ambientin që më rrethon. Qytezë klasi.

- Sa paguhesh? - pyeti Zana.

Kur tregova vlerën e pagesës mujore, vajzat heshtën e më shikuan të çuditura.

- Dua të shohim shpinë ku rri, - foli Zana. Nga aty nxjerrim shumë mësim e të vërtetat e jetës që ti bën këtu.

- Dakord! - fola e u nisa rruginës drejt hyrjes time në katin e dytë. Hapa derën e hymë brenda.

Mbylla nga pas derën e ftova Marion të ulej në karrigen në krye të tavolinës e vajzat anash tij.

Vajzat hapën sytë duke parë çfarë kisha në dhomë, Zana hapi dhomën e gjumit e pastaj të banjos.

- Shumë mirë qënke rregulluar. Krevat të madh?

- Po e gjeta këtu. E plotësova e aty kaloj natën.

- Vetëm?

- Vetëm, por nuk shoh ëndrra. Ditën lodhem e gjumi është aleat i natës. Nuk më lë shumë vend për aventura e sa për ëndrrat...i shoh ditën në fermë.

- Sipas Nino Ferretit ILB i Tiranës nuk i është përgjigjur shkresës të UMB e sezoni po mbyllet. Mbyllet edhe mundësia e dhënies së ndonjë provimi shtesë e regjistrimi në vitin akademik në vazhdim. Si kështu? - pyeti Mario i shqetësuar.

- Me sa kuptoj unë, burokratët e Tiranës janë ndodhur para një kërkesë të çuditshme. Unë, apo emri im, një 'jashtëqitje e kombit' që bëra sfidën me largimin nga Shqipëria u kërkon të paarritshmen, të legalizohet largimi im e të vazhdoj UM të Barit. Vërtetë edhe më parë kanë ardhë këtu studentë, por nga shteti si graduantë të vlerësuar prej tij, jo kështu si unë. Unë kam ikur, kam lënë bosh vendin në Macukull. Isha planifikuar t'u shërbeja kumbullave e thanave të egra atje. E drejtuesit e shtetit dhe të institutit ende më anatemojnë si djalë i dalë duarsh. Janë ende të acaruar me veprimin tim e nuk e kapërdijnë kollaj.

- Tekefundit shteti shqiptar e institucionet e tij duhet të trajtojnë si shtetas Italian e si të tillë duhet t'i përgjigjen shkresës tonë. Juristi i rrektorit në UM të Barit ka biseduar këto ditë me shefin e kulturës italiane në ambasadën tonë në Tiranë e shpreson që të bëhet ai garant i kësaj kërkesë. Ai kërkoi që me faks t'ia dërgonin nga Bari kopjen e



shkresës. Situata duhet të ngacmohet e të nxitet deri në zgjidhje. Shpresojmë.

- Gjithsesi ju falemnderit për interesimin. Si ju edhe Nino na jeni gjendur në këto ditë.

- Ne jemi nëpunës shteti e detyrat që na jepen duhet t'i çojmë deri në zgjidhje, ndryshe zëvendësohesh e vjen ai që i kryen, - tha Mario.

- Pse kenë marrë detyra konkrete për ne?

- Po. Emrat e kërkesat tuaja kanë qarkulluar në institucionet tona e janë bërë detyra për ne.

Rashë në mendime. Sipas kujtesës time nga sa kisha dëgjuar në vendin tim ndodh e kundërta. Administrata tallet me publikun e interesat e tij. Fat i keq i shqiptarëve endej keqas atje.

- Qënke rregulluar mirë Rubin, po me punën në fermë do të vazhdosh? E duron këtë punë?

- Po. E dua.

- Mbase dhe shkolla e familja të kanë edukuar me këtë frymë.

- Dëgjo Mario. Unë kam pasur lidhje të mira me gjyshin tim deri sa vdiq. E shihja si punonte. E ndihmoja. E dëgjoja. Mes të tjerave më ka treguar se:

- Me kapitullimin e ushtrisë italiane në vitin 1943 shumë ushtarë të demoralizuar të mbretërisë mbetën rrugëve si lypsarë apo më keq si jetimë e një pjesë e tyre fatkeqësisht ekzekutohet nga ushtria gjermane. Për t'i shpëtuar këto shpirta njerëzorë të moshave të reja, komanda e ushtrisë partizane, me aq pushtet sa kishte, vendosi t'i shpërndante në familjet shqiptare. Tek ne kanë ardhur dy djem të rinj. Ishin të veshur me rreckat e ushtrisë së shpartalluar. Karikaturë. U veshën me rrobat që u dhamë që të mos njiheshin nga patrullat gjermane që herëpashere vizitonin fshatin. Ishin shumë punëtorë. Të papërtuar. Bënin çdo

lloj pune nga çarja e druve, kositja e barit e punimi i tokës. Për sa qëndruan te ne kanë lënë kujtimin e njerëzve punëtorë. U bënë shembull. Na mësuan dhe ne si të punonim.

I pari, ai prej Barit u muar me 13 rrenjë ullinj shumë të vjetër që kishim në rrethinat tona. Jepnin pak prodhim. Në konsultim me gjyshin, i krasiti ndryshe, duke ripërtërirë gjithë pjesën mbitoksore të bimës. Vazhdoi me punimin e tyre rreth trungjeve, plehërimin, ujitjen e u arrit që në vitin e tretë këto bimë të kenë një kurorë shumë më të gjelbërt e prodhimi prej tyre të trefishohet.

I dyti nga Toskana u muar me hardhitë e perimet e bëri si shoku i tij me ullirin. Mbetën në kujtesën tonë. Gjyshi i solli deri tek unë si modele të njeriut të punës.

- Është e vërtetë. Ky brez pas lufte ia ndryshoi faqen Italisë. Lufta pati të vetat, por para saj italianët emigronin në Çeki, Gjermani, Austri e më larg në Sh.B.A. Argjentinë, Brazil e kudo ku kishte punë e fitohej. Pas lufte qeveria e de Gasprit krijoi një platformë drejtimi që i vuri gjithë italianët në punë e pati suksese. Familjet italiane e gjetën veten brenda vendit e ndërtuan mirë jetën e tyre, - foli Mario.

Ndërsa unë e Mario bisedonin vajzat kontrolluan shpinë me gjithë çfarë kishte brenda e duke qeshur erdhën në tavolinë me një pako biskota, gotat e ibrikun e çajit. Ishin në kënaqësitë e tyre të shpisë si vajza.

- Shpinë e mban mirë, - foli Kena.

- Jeta e konviktorit më ka mësuar shumë, por në shpi kemi qënë dy djem e nëna shpesh na linte detyra për të kryer që na mësuan apo na edukuan t'i bëjmë mirë.

- Po jeta komunitare si është e organizuar këtu, - pyeti Mario.

- Me sa kuptoj unë e gjitha sillet rreth kujdesit të familjes së kontit. Deri vonë këtu sundonte disiplina e familjes, pas



Luftës së Dytë ka dhe mekanizma shtetërore kontrolli e drejtimi të komunitetit të ‘Kastel-Blu’, por dora e kujdesi i familjes mbetet e ndjehet kudo. Ai është Zoti këtu. Dhe sipas meje e bën mirë.

- Je takuar ndonjëherë me kontin?

- Jo. Por e di mendimin e tij për mua. Ia ka thënë Nino Ferretit kur më mori në punë:

- T’i krijohet çdo mundësi shkollimi që kërkon, - mësova se është shprehur për mua ai.

- Shkojmë të shohim pyllin? - u shpreh Mario.

Rrugës së freskët të pyllit unë e Zana mbetëm mbrapa, Mario e Kena ecën para. Në një moment i drejtohem Zanës:

- Si po e kaloni në Brindizi? Veshjet e fiziku flet se te ju gjithçka shkon mirë.

- Jo mirë, por shumë mirë.

- Po Kena me Marion vazhdojnë të flasim.

- Po. Vetëm kaq. Ajo heziton, nuk e di pse. Mua pak më hapet.

- Po ty të ngacmojnë djemtë?

- Më ngacmojnë, por i kaloj me mirësjellje, fazën aventuroze e kam kaluar. Dua një lidhje të qëndrueshme, kur ta gjej nuk do ta shpërdoroj. Më duhet një lidhje e qëndrueshme, e gjatë.

Ndaluam tek një burim e u freskuam disi. Kur u ulëm në stolin ngjitur, Mario m’u drejtua:

- Të shtunën vajzat kanë ndeshjen e fundit të kampionatit. A vjen me mua ta shohim bashkë atë ndeshje? Dua të konsumoj dhe një bisedë me ty.

- Eja e më merr, jam i lirë, - fola.

Të shtunën me Marion në Brindizi pamë ndeshjen e basketbollit të vajzave. Zana si gjithmonë ishte në qendër të tabelës e organizonte sulmin e skuadrës së saj. Kena në sulm, e qetë, rezultative.

Skuadra e tyre fitoi e zunë një vend të mirë në klasikimin përfundimtar. Më bëri përshtypje reagimi i tifozëve të shumtë për vajzat. Ata duartrokisnin e inkurajonin lojën e Zanës, por edhe koshat e bukur e elegantë të Kenës.

Pas ndeshjes ndenjëm edhe pak, përcollëm vajzat në dhomën e tyre e u nisëm drejt veriut, drejt shpisë. Diku, në një lokal ndaluam. Zumë vend e porositem drekën.

- Dua të bisedoj diçka personale me ty Rubi, - u shpreh Mario kur drekës po i vinte fundi.

- Urdhëro, por nuk mund ta di a jam njeriu i përshtatshëm nga mosha e përvoja e pakët që kam.

- Rubin vërtetë ti je djalë i ri, disa vite më i vogël se unë, por kjo nuk më ndalon të pyes për një problem që për mua është i rëndësishëm. Ka të bëjë me Brikenën. Ka disa kohë që rri shumë me të, i kam shprehur dashurinë e dëshirën time e ajo hesht. As më largon e as më afron duke lënë mes nesh një perde të hollë ndarëse. Si e mendon ti, nga vjen kjo gjendje, kjo prerje apo qëndrim as po as jo i saj? - pyeti.

- Mua më vjen mirë që mes jush ka lindur dashuria, si ndjenjë, si vlerë e medeomos do ta gjeni rrugën për tek njeri-tjetri. Unë pak gjëra di, aq sa më ka treguar për veten e saj Kena kur ishim në kamp.

- Çfarë di ti?

- Kena, - fillova unë, - është bijë nga një familje konservatore e njohur në qytetin e Durrësit. Gjyshi i saj është shkolluar në akademinë ushtarake të Bolonjës. Punoi për modernizimin e ushtrisë së mbretit Zog. Në kohën e luftës u përfshi në njësitë partizane. Pas lufte punoi edhe dy vjet, por në vitin 1947 e në vazhdim është trajtuar si zogist e kundërshtar i regjimit. Fëmijët u privuan nga marrja e arsimit të lartë e bënë punë të rëndomta. Kena ka mbaruar vetëm shkollën e mesme. Kaq si njohje.



- Po kjo nuk të çon tek heshtja. Mosha e qenia e saj si sportiste sikur e kundërshtojnë.

- Dëgjo Mario! Ne vijmë nga një vend ku dashuria për atdheun e familjen kanë qenë biseda të vazhdueshme e me një kod të patolerueshëm. Ikja nga Shqipëria për ne ka qenë një akt kundërshtues i këtij kodi, ndërsa lidhja me një të huaj është një farë shmangie apo largim nga linja tradicionale familjare. Tek ne thonë që për shumë arsye gruan ta marrësh nga fshati yt. Çdo të thotë kjo? Se vendimet e rëndësishme në jetë, siç është dhe krijimi i familjes duhen gjykuar mirë e martesë është një akt madhor që do dakortësinë morale të prindërve, kjo si për vajzën ashtu dhe për djalin. Familja tek ne vazhdon të shihet si një institucion i qëndrueshëm, solid, autoritet. Për arsye të mbylljes politike martesat me të huaj ende janë të pakta. Me fe të ndryshme më pak.

- Po ne sot jetojmë në kohëra të tjera e nuk e kuptojmë këtë qëndrim të Kenës.

- Edhe qëndrimi i saj është produkt i atij mjedisi e i asaj familjeje, e s'mund të jetë ndryshe.

- Çdo të thotë kjo?

- Në kushtet e saj familjare që të tregova ku edhe martesë ishte e kondicionuar, rreziku i një martesë të dështuar, të pamenduar mirë, përbën një shqetësim të madh deri në tronditje, ndaj duhet menduar mirë.

- Kjo është arsyeja që hesht Kena?

- Po. Ajo do më shumë siguri prej teje. Tek ti kërkon mbështetjen e garancinë e një jetese që lidhet me familjen, ekonominë, fëmijët e vazhdimësinë. Kështu është edukuar ajo.

- Pse nuk m'i kërkon ajo?

- Nuk e di e nuk mund të ndërhyj.

- Pse?

- Kjo se nuk dua të përzihem në jetën e tjetrit.

- Po kur ta kërkoj unë si mendim? - këmbënguli ai.
 - Kush është Mauro Santini? - pyeta atëherë dhe e pashë drejt në sy.

Bashkëbiseduesi im më shikoi me vëmendje e në sytë e tij pashë një kureshtje të shtuar, larg asaj që isha mësuar deri tani. E kuptova se donte të hapej apo më mirë të shfaqej ashtu siç ishte:

- Unë jam Mauro Vinsent Santini. Datëlindja 1954. Arsimi lartë për fiskulturë. Kam qenë i martuar e kam një djalë 5 vjeç. Jetoj me nënën.

- Tjetër?

- Kam shpinë time e një fermë të vogël, 11 ha ku mbjell perime, pemë frutore e mbaj disa shpend, pula e pëllumba. Punoj instruktor i edukimit në prefekturë, kam qenë basketbollist me ekipin e Barit e atë kombëtar, para 3 vitesh kam lënë sportin e luajtur e stërvis një ekip të rinjsh.

- Kaq? - pyeta.

- Po, - u përgjigj ai.

- Je ndarë me gruan apo...

- Jo ajo ka humbur jetën në një aksident automobilistik.

- Çfarë të kanë punuar prindërit?

- Im atë ka qenë oficer, ndërsa nëna mësuese. Babai më ka vdekur ndërsa nëna është në pension. Kujdeset për djalin pas largimit nga kjo jetë e gruas sime të ndjerë.

- Atëherë të gjitha këto këto thuaja Kenës, por jo vetëm.

- Çfarë tjetër?

- Kërko prej saj të njohë dhe nënën tënde. Edhe djalin. Edhe shpinë ku jeton.

- Sikur ngarkohet apo zgjerohet shumë ?

- Jo. Duke ditur historinë tënde e njohur mjedisin që e pret, mirëkuptimi merr formë, krijon besim. Fjalët e ëmbla të dashurisë nuk mjaftojnë. Nuk e ngjizin dëshirën. Kena



kërkon diçka tjetër. E ndjen veten në një dilemë të ëmbël, por pret e nuk shprehet.

- E kam të qartë. Më ndihmove.

- Një sqarim dua: E don Kenën, vajzën shqiptare për grua?

- Unë kam një përvojë jetësore. Kam jetuar 5 vjet me një grua të mirë që më iku. Më la një djalë edhe një boshllëk të madh. Sot kam nevojë të madhe për një grua.

- Si e ke menduar këtë grua që po projekton? Qoftë kjo edhe Kena.

- Ndryshe nga e para.

- Si?

- Një grua që do të kujdesohet për shpinë, djalin edhe nënën.

- Kujdestare të mbyllur brenda shpisë?

- Jo jo, nuk më kuptove, një grua që të ketë vëmendjen tek djali e nëna. Kuptohet, së bashku me mua. Kjo nuk do ta ndalojë atë që të ndjekë edhe jetën sportive e shoqërore.

- Po prindërit e saj në Shqipëri?

- Si prindërit?

- T'i ftosh në Itali, t'u bësh garancinë e të vijnë të shohin e të njihen me vendin e njerëzit ku do të jetojë vajza e tyre. Shqiptarët i duan miqtë, të vjetër e të rinj.

- Po kushedi si do ta presin?

- Me sa di unë, i jati, djali i komandantit, është një zotëri burrë. Punon mekanik dhe thonë se i ka duart e arta. Megjithëse me arsim të mesëm, ka fituar një kulturë të lakmuar e nderohet në shoqërinë e tij.

- Qartë. E kuptova gjithë atë që më më sugjerove ti. Je bashkëbisedues e mik i mirë. Të falemnderit!

U ngritëm e i hipëm 'JEEP'- it drejt 'Kastel-Blu'.

* * *

Në muajin korrik isha me pak njerëz në fermë e mora disa detyra të veçanta nga Umberto. Rrija kryesisht me Sandron, inxhinierin hidraulik, kontrolloj shpërndarjen e ujit në të gjithë fermën, duke filluar me fidanishten deri tek tarracat me sheshe apo vetullore. Kudo shkon uji me pika, e në pak vende dhe me rrjedhje të lirë. Sido të vinte vera bimët kishin ujë. Gëzohesha. Kujtoj ullenjtë e vendit tim, rrallë kush kujtohet për t'i ujitur. Ata vuajnë kudo edhe për ujë.

- Do vish me mua te liqeni? - më pyeti një ditë fundkorriku Sandro.

- Po, - i them. Po çdo të bëjmë atje?

- Ke qenë ndonjëherë?

- Jo.

- Atje do të shohim nivelin e ujit në basen, do të kontrollojmë presionin hidraulik të shkarkimit si dhe të shohim sa ujë shkon në fermë. Uji i pastër do të na ftojë në freskinë e bukurinë e tij. Aty ka disa vila e një lokal të mirë ku mund të kalojmë edhe drekën.

Dolëm nga porta lindje-jug e pas pak arritëm te liqeni. Parkuam diku makinën e u morëm me pajisjet kontrolluese të ujit në basen e atij që del prej aty. Një digë betoni pesë-gjashtë metra e lartë ishte edhe vendi ku komandohej e gjithë kjo masë uji.

- Këtu merr ujë qyteza dhe ferma, - foli inxhinieri.

- Po uji që vjen në qytezë, ku filtrohet?

- Nga erdhëm, diku majtas sapo lamë portën, ka një impiant e tre depo ku rezervohet e dekantohet uji për t'u përdorur në shpiat e qytezës. Bile dhe lulishtja e shatërvani marrin ujë të filtruar.

- Ka peshk këtu?



- Ka, por nuk lejojnë të gjuajnë për qëllime biznesi, vetëm si sport.

Me Sandron shkuaam tek vilat ku ishte një bar-restorant i vogël. Zumë vend afër një dritareje ku shihej dhe pasqyra e ujit të liqenit. Porositëm. Ishte më fresk se në qytezë. Kjo ndjehej në lëkurë.

- Sa është lartësia mbi nivelin e detit e liqenit? - pyeta.

- Gjashtëqind metra, - m'u përgjigj Sandro.

Bëra llogari me mend e nxora: - temperatura këtu është disa gradë më e ulët se atje poshtë.

- Kjo si referencë e diferencave të lartësisë?

- Sigurisht.

Kur po hanim në sallë u fut një burrë e një grua e zunë vend tek dritarja tjetër.

- Është konti me të shoqen, - foli Sandri.

- Ky qënka konti? - fola e vazhdova me çudinë time.

- Pse habitesh?

- Një njeri kaq i thjeshtë e është pinjoll i familjes që ka bërë mrekullinë 'Kastel Blu'.

- Si e mendoje ti?

- Tek ne drejtues të një rangu të tillë, ndonëse të përkohshëm e shumë më pak merita mbajnë veten shumë lart, të rëndë, i gjen gjithmonë të shoqëruar nga miq e servilë, të mbrojtur e në një distancë të theksuar me njerëzit nën vete.

Ndërkaq edhe ata porositën.

Ne pasi hëngrëm, pritnim të paguanim. Konti me të shoqen u ngritën e po dilnin, kur ai ktheu kryet e shikoi drejt nesh. U ndal, i kërkoi falje së shoqes e drejtohet tek tavolina jonë. Ne u ngritëm në këmbë.

- Si je inxhinier? - pyeti e vazhdoi: - po ky djali?

- Mirë jemi zoti kont. Ky djali është Rubini, shqiptari që punon në fermë.

Konti më dha dorën e u ul në karrigen bosh të tavolinës. Më shikoi në sy.

- Si je? Si e ndjen veten këtu? A je i kënaqur? - më pyeti me qetësi.

- Ndjehem mirë, bile shumë mirë!- fola i emocionuar.

- Më erdhi keq për sa të ngjau me dokumentat e shkollës. Mos u mërzit. Vitin tjetër me çdo kusht do të vazhdosh shkollimin. Burokratët janë të rrezikshëm e kur janë të veshur me politikë, kanë vullnet të dedikuar, shterp.

- Unë kam emigruar në Itali kundër dëshirës së tyre. Jam djalë fshati e me një farë edukimi bujqësor, por të pa përfunduar. Shpresoj ta mbyll në UM të Barit e të diplomohem.

- Kur më paraqiti kërkesën tuaj Ferreti, u habita. Pse do të thoni ju?

Unë qesha e ula kryet.

- Sot, - vazhdoi ai, -të rinjtë nuk e preferojnë punën në bujqësi. Pasioni juaj për punën në fermë është disi i veçantë, ndaj e respektova kërkesën tënde. Do të të mbështes fort.

- Ju faleminderit! Po pas përfundimit të shkollës unë dëshiroj që këtu ta gjej veten.

- Edhe unë do t'ju afrojmë mundësitë më të pranueshme për ty.

- Ju faleminderit kont!

Konti u ngrit, na dha dorën e u largua.

- E shikon, dole i fituar Rubin, - foli Sandro.

- Po. Po. Takimi me një bashkëbisedues të tillë është kënaqësi, ngjarje, por dhe një moment reflektimi e natyrisht përfitimi.

- Edhe unë e kam ndjerë dorën e mirë të kontit. I do specialistët e rinj. I ushqen e i nxit në ëndrrat e tyre.

- Ke patur rast ti?



- Posi, bile shumë interesant e të veçantë. Më kërkoi një projekt të ri për pastrimin e ujit të pijëshëm që vinte nga liqeni.

- Çfarë kërkonte nga ky projekt?

- Të vendosej në mes të depove e qytezës e të bënte një filtrim shumë cilësorë të ujit për banorët e saj.

- E bëre?

- Po.

- Si vazhdoi historia e tij?

- Një ditë më thirri në zyrë e më kërkoi sqarime për projektin. Aty ishin dhe tre persona të tjerë që nuk i njihja.

- Projekti është shumë i mirë. E miratoi. Do të shpall tenderin e ndërtimit javën tjetër, - foli thjeshtë e i kënaqur.

- Po edhe kështu uji është i mirë, - fola unë.

- I mirë, por jo shumë i mirë. Është teknologji e para 50 viteve. Njerëzit duhet të pijnë ujë shumë të pastër.

Projekti mbaroi e pas vënies në punë e kryerjes së analizave më thirri prap e më kërkoi:

- Si mund të ujitet pylli gjatë verës që mos të thahet bari e drurët pyjore?

- Ka shumë mënyra i them.

- Projekto mënyrën e grumbullimit të ujit e tri mënyrat e shpërndarjes së tij. Atëhere eja e të diskutojmë bashkë e të zgjedhim më të mirën, - foli e nga tavolina më zgjati një zarf.

- Merre, - më tha e u ngrit edhe ai. Më dha dorën.

Dola nga zyra e në shesh hapa zarfin. Ishte një çek në emrin tim.

- Shpërblim për projektin e ujit?

- Po. Konti e vlerëson punën. Kjo e ka bërë të suksesshëm.

- Dalim, - fola.

Rrugës pashë poshtë gjithë fermën. Një sipërfaqe e mbuluar blu-gjelbër që ujitet prej këtu. Impiant bimor i pavarur nga natyra. Mrekullisht mirë, mendova.

* * *

Ditët në vazhdim vazhdova të punoj me traktorët bujqësorë, të lëviz në rrugët e fermës e të kontrolloj indikatorët e ujitjes. Pa u lodhur.

- Me sa shoh unë, manovrimin e traktorëve e makinerive bujqësore e ke mësuar, - më tha një ditë Pedro. Në zyrë kam disa tabela me shenjat rrugore që duhet t'i mësosh për të plotësuar dijenitë për provimin e marrjes së patentës.

- Në Shqipëri kam marrë një patentë motoçiklete, - foli e shenjat atje i kam dhënë provim.

- Kjo do të thotë se diçka dini.

- Gjithsesi duhen përsëritur e kontrolluar njohuritë.

- Po kishe motoçikletë ti? - pyeti Pedro.

- Im atë si përgjegjës sektori kishte një motor 'Java' të vjetër që më shumë nuk punonte. I dhanë një të ri. I vjetri mbeti në magazinë. E blemë dhe e riparua. Fillova të ushtrohem për ta mësuar. Më vonë mora edhe patentën.

Në zyrën e Pedros e vërtetova një gjë të tillë. U bëra shenjave rrugore një freskim të plotë për dy-tre ditë. Me 3 gusht isha tek autoshkolla për provimin zyrtar i shoqëruar nga Pedro.

Mora patentën që ishte një lajm i mirë. Më trazonte lajmi i keq nga Shqipëria që më dha konti.

- Pse? - pyesja veten. - Çfarë u bëra unë një djalë 23 vjeç me interesa e dëshira për një jete të re, ndryshe nga sa ishte mësuar rinia e ndrydhur shqiptare.

- E ndrydhur? - Pse mendoni kështu, -iu drejtova vetes.



- Po si nuk është e ndrydhur ajo rini që me ligj nuk i lejohet të plotësojë ëndrrat e saj?

- Pra duhet të shkoja në Macukull? Të inventarizoja kumbullat e dardhat e egra i veshur me këpucë të rënda e një treçerekshe shajaku të zi? E pas kësaj të urdhëroja disa njerëz që t'i prisnin ferrrat për rreth kurorës e në verë të merreshin disa kosha me prodhim prej tyre. E bukur punë!

- Ku e di ti? Pse bën lojën e fjalëve të njeriut të strapacuar?

- E di se im vëlla ka qënë mësues biologjie në një zonë tjetër malore. Mësonte fëmijët.

- Alo Rubi! Jam Nino Ferreti.

- Po drejtor Nino. Të dëgjoj me vëmendje.

- Nga juristi i rektorit të UM të Barit mësova se nuk ka ardhur shkresa nga UB i Tiranës e kështu mundësia e vazhdimit të vitit akademik mund të shtyhet për vitin tjetër. Më vjen keq, por nuk mendoj se inati shtetëror ndaj teje mund të arrinte deri këtu. Ti je djalë i ri. Pse kështu?

- Ju faleminderit drejtor! Ju bëtë gjithçka mundët për mua. Edhe sikur të mos më jepet kurrë kjo e drejtë, unë ju jam mirënjohës e do të vazhdoj të punoj në fermë. Për mua jeta këtu është shumë herë më e mirë se atje nga kam ardhur. Nuk i braktis ëndrrat e mia. Kam besim se do të ketë një kohë kur ata të realizohen. E do të jetë një ditë e bukur. Për këtë po përpiqem.

- Mos u mërzit. Ka ndërhyrje të fortë nga ambasadori ynë në qeverinë shqiptare e sipas juristit do të gjendet rruga e zgjidhjes se ti je shtetas italian, por do të vonohet.

- Drejtor, unë po pres këtu në fermë e nuk kam ndërmend ta braktis punën asnjë ditë. Këtë ia premtova edhe kontit një ditë te liqeni që më transmetoi lajmin e keq. Edhe kështu po fitoj gjithçka të nevojëshme që do të më duhet për punën time.

- Dëgjoni Rubin?
- Po drejtor. Flisni.
- Në këtë periudhë pushimi mendoj që të përgatitesh për të marrë çertifikatën e gjuhës italiane e angleze. Është në të mirën tënde. Edhe këtu ka paragjykime, ndaj kërko një vend sipas meritave në këtë shoqëri ku ke ardhur. Dije prej meje, askush nuk të jep asgjë. Duhet ta fitosh sikur edhe me dhimbje të madhe. Aq më tepër në kërkesat tuaja. Kur të jesh gati më njofto e shkojmë bashkë në Bari apo Romë, - përfundoi i miri Nino.

Sipas porosive të Ninos e Pedros, u regjistrua në autoshkollë. Më duhej medoemos patenta e makina si nevojë e mjet pune.

Isha i ngarkuar plotësisht. Punë në fermë, kohë biblioteke, autoshkollë, pylli e loje në palestër. Edhe Roberto do kohën e tij. Po vazhdoj. Si do t'ia dal?

Vazhdoj me Umberton në vjeljen e ullinjëve. Erdhën edhe studentët e UM të Barit. Po kryejnë praktikat e punën prodhuese. Dukësia si ndonjëri prej tyre. Isha moshatar me ta. U njoha edhe me profesor Luigjin që i shoqëronte. E respektonin shumë studentët, por edhe punonjësit e specialistët e fermës. Bile ata të fidanishtes e të fabrikës vazhdonin të kishin lidhje të afërta me të. Më vonë mora vesh se drejtonte disa punë shkencore e studimore aty. Ndjehej i kënaqur, këtu kishte nisur së pari punën e hap pas hapi edhe ishte rritur deri profesor në UM të Barit.

Studentët pothuajse të gjithë ishin bij fermerësh nga Italia e jugut. Me interesa e qëllime zhvillimi të punës së nisur me kohë prej familjeve të tyre. I dëgjoja që diskutonin me profesorin e tyre gjatë punës prodhuese e ngritnin probleme të ndryshme. Gëzohesha.

Disa prej tyre flinin në qytezë. Edhe profesori kishte dhomën e tij. Një ditë shkova në dhomat e tyre. I kisha



afër. Kishin kushte shumë të mira hotelerie. M'u kujtuan vendet ku trajtoheshim ne si studentë në Shqipëri. Plug, Otlak apo Grudë e re. Skandal. Flinim në dyshekë me kashtë e pa kushtet minimale të jetës. E ne heshtnim. Kuptohet nuk ishte vrrarë frika e çdo kërkesë shihej me sy të keq, si e drejtë borgjeze. Pse një gjumë apo jetë e mirë e drejtë borgjeze është? E nëse është kështu, nuk kemi të drejtë ta kërkojmë? Çudi! Ec e fol atëherë. Ndaj në rastin më të parë çava ferrën, ika nga ai ambient. E bëra mirë. Bile kryeva një akt guximi. Moshatarët e mi duhet të ma dinë për nder se po vendos një standard të ri për veten, por dhe për ata.

Pas vjeljes fillon krasitja. Kalendar i fermës më ndjek kudo. Umberto i saktë, i palodhur e gjithmonë në lartësinë e detyrës më udhëheq. Jo duke më marrë për dore, por i lirë në vetveprimin tim. Jam i kënaqur.

Në natën e Krishtlindjeve shkova në kishë me Roberton. Zumë vend në një stol. Erdhi edhe konti. E respektonin të gjithë. Edhe prifti. Zhvillohen sakramentet. Pas meshës Sandro, inxhinieri hidraulik, më njofton: - Tako kontin në kullën e tij. Të pret.

- Ka ardhur në adresën tënde njoftimi me shkresë që të parqitesh në UM të Barit për të plotësuar provimet e të vazhdosh sipas rregullit mësimet akademike. Posta ka ardhur në adresën time. Për nga rëndësia e interesi njoftova edhe Nino Ferretin. Lidhu me të pas Viti të Ri, - foli konti thjeshtë e me zë të ulur.

Ishim në katin e dytë të kullës, në një dhomë të madhe. E dija se ishte shumë e vjetër, por e mirëmbajtur deri në detajet më të vogla.

- Ke ndonjë problem? - pyeti.

- Përveç kënaqësisë e detyrimit që t'ju falenderoj, nuk kam asgjë tjetër, - foli e u ngrita. Dola. Në dalje pashë dy sytë e mirësisë që më ndiqnin. U ndjeva mirë.

Mora pjesën time të njoftimit e shkova në shpi. Gjumi më zuri vonë. Shteti i mirë është ai i mundësive për njerëzit. Po në Shqipëri?

Pas viti të ri mora në telefon Ninon dhe e njoftova për lajmin që më dha Konti.

- Në fund të shkurtit do të japësh provimin e gjuhës italiane e në prill anglishten. Këto dy provime jepen në Romë. Në qërshor ke një provim plotësues në UM të Barit. I kam bërë regjistrimet e fillu të punosh.

- Ju faleminderit drejtor!

- Së shpejti do të vij në 'Kastel blu' të të sjell programet e provimit, tekstet, por ti vazhdo me materialet e bibliotekës që ke aty. Fillo sipas radhës e pa ndërprerje. Dakord?

- Po plotësisht dakord, - foli. U përshendeta e u ndava me Ninon, drejtorin e mirë edhe shumë të kujdesshëm që po më gjendej afër vazhdimisht.

Fillova studimin me ngarkesë ditore. Nga biblioteka tërhoqa materiale për në shpi. Nuk lodhesha. Kohën për një punë të tillë e gjej. E mjaftueshme. Seç më shtynte në vullnetin e dëshirën time që së brendshmi më sundonin. E u nështrohesh. Të shtunave e të dielave duhet të paraqitesha në autoshkollë.

Më 18 shkurt me Ninon nisemi drej Romës. Do të jap provimin e gjuhës italiane.

- Nesër ora 9-të është provimi me shkrim, - foli.

- E di, - iu përgjigja qetë.

Me 20 shkurt në hollin e dekanatit doli lista e kandidatëve që kishin fituar. Isha edhe unë.

- Si të shkoi provimi? - pyeti Nino.



- Provim të lehtë nuk ka, por ishte shumë korrekt. Një sallë e madhe ku ishin rreth 100 kandidatë nga kombësi të ndryshme. Në qetësi mora fletët me pyetjet e detyrat e fillova punën. Pas dy orësh e dorëzoval.

- Nesër ke provimin me gojë. Ku apo për çfarë teme je përgatitë?

- Ku të duan komisionerët, por po të ishte në dorën time do të përqëndrohesh në lëmin e shkencës tonë, të biologjisë së zbatuar. Veçanërisht tek ulliri.

- Mirë do të ishte, por dhe aty ka një program që lëviz mbi tavolinë.

Ashtu ndodhi. Më ra një temë me diskutim për kulturën moderne italiane. U përqëndrova tek kënga e viteve 70-të. Solla në mëndje Çelentanon, di Barin, Modunjon, Minën, Albanon, Batistin, Morandin, Nazaron, Kotunjon, Nadën, Oxen, Ranierin e disa të tjerë, e shkrova çfarë dija. Dhe dija mjaft. Ishin dritarja e rinisë shqiptare. I kisha të dashur e i dua. Ua di për nder që më tërhoqën këtu. Si sirenat Odiseun.

- Për cilin këngëtar do të flasim? - pyeti komisioneri më i ri i panelit.

- Unë i dua të gjithë, di shumë këngë të tyre e nuk mund t'i veçoj, - u përgjigja.

- Po nga Modunja?

- Si emigrant më tërheq shumë kënga e tij 'Amara terrra mia'?

I gjithë paneli më shikoi me vëmendje e respekt. E kuptova. E kisha fituar betejën. Diskutimi zgjat 30 minuta. Dola.

Pasdreke me Ninon shetitëm në Romë, në qytetin e pavdekshëm. Fontana Trevi, Koloseu, rruga Apia e sheshi Shën Marku. U gëzoval me ta. Mrekullitë nga historia e kulturës botërore i përshendeta, më mrekulluan. U gjeta i dritëzuar nga kohrat që bënë vepra të mira në këtë vend.

Të nesërmen në sekretarinë e dekanatit mora dëshminë e gjuhës italiane. U nisëm drejt Barit. Na priste 'Kastel Blu'

Pranvera e atij viti pati shumë lajme të habitshme nga vendi im i ngratë. Qeveri të re që nuk jep asnjë shpresë, që nuk ka aspak ndjeshmëri publike, që nuk kontrollon territorin e vet, që tallet me pronat e qytetarëve të ngratë, që bashkëpunon me krimin e vjetër komunist e të riun arrogant që po lind e forcohet. Anije të zaptuara me forcë mbushen me emigrantë e shkarkohen në tokën italiane. Pamjet televizive nga stadiumi i vjetër i Barit dhe titujt e gazetave më ngjallin trishtim. Gjithçka flet për keq. Shqipëria prodhon vetëm emigrantë që cilësohen prej shtypit 'fantazma të frikshme'. Politikanët e rinj për nga mënyra si veprojnë e vendimet që marrin nuk dallohen nga paraardhësit e tyre komunistë. Fatkeqesia e vendit po vazhdon në një formë të re. Si kështu?

Të gjitha këto zhvillime i ndjek nga 'Kastel Blu', ku nuk mund të depërtojnë emigrantë nga vendi im së pari nga emri fermë që i terrorizon e së dyti nga pamundësia e saj. Bile këtu nuk ka emigrantë as nga vendet e tjera. Unë bëj përjashtim. Dhe i tillë, me pasaportë italiane po përpiqem ta shfrytëzoj, të shihem me sy tjetër, ndryshe nga ç'thonë gazetat e ekranet televizive. Mblidhem e hesht, lexoj e jap provime, punoj e shpesh i vetëm shëtis në sheshin e qytezës e në pyll, stërvitem e luaj në palestër me një grup që pëlqejnë lojërat me dorë. Pak miq e kontakte.

Në këto kushte u përgatita për të dhënë provimin e anglishtes, edhe këtë në Romë. Dola mirë. Më pas edhe provimin plotësues në UM të Barit. Nuk kisha dhënë në Tiranë provimin mbi 'Prodhimin e përsheptuar të fidanave të ullirit'. Tekstin e mora në kolegji ku Nino e kishte rezervuar e së bashku me materialet e shkruara që kishte biblioteka e qytezës më plotësuan gjithë njohuritë që



silleshin rreth kësaj teme apo kërkese të prodhimit të fidanave. Me këto njohuri teorike zbrita në fidanishte, në serë, në laborator. Bisedova me specialistët e ndoqa punët e tyre. Pashë rezultatet e lexova relacionet shkencore që i dëgonin UM të Barit. Jetoja me këtë ambient shkencor e zbatues. I krahasoj e arrij diku me mendjen time. Isha gati për provim.

Më 14 qershor isha në sallën e provimit. Paneli kishte në qendër të tij profesor Luigjin, që e kisha njohur në fermë me studentët dhe dy të tjerë, njëri më i ri e tjetri më i vjetër. Pas përshëndetjes, mora tezën e u ula diku. Lexova pyetjet e fillova qetësisht t'i zhvilloj. Kur i përfundova e isha gati, ngrita kryet e pashë profesor Luigjin.

- Ke ndonjë paqartësi? - pyeti ai.

- Jo. Jam gati, - u përgjigja.

- Urdhëro, filloni, - foli ai menjëherë.

Fillova me pyetjen e parë, të dytën e të tretën pa u ndërprerë. Profesorët dëgjonin e mbanin shënime. Më bënë disa pyetje. Më sollën në tavolinë disa materiale bimore e pajisje, më kërkuan të demonstroj disa aplikime. Praktika që i kisha zbatuar disa herë në serë e në laboratorin e fermës. Kaq ishte. Përshendeta e dola. Jashtë më priste Nino. Miku im më i mirë në Itali. Po cili sillej keq me mua? Asnjëri, përgjigjesha po vetë.

- Si i mësove gjuhët e huaja kaq shpejt? - më pyeti Nino në një moment gjatë udhëtimit.

- Anglishten fillova ta mësoj që në klasën e pestë, 12 vjeç. Im atë më kërkonte shumë në këtë drejtim, e siç e kuptova më vonë, tek unë ai donte t'i plotësonte ata boshllëqe që ai kishte pasur në formimin e tij.

- Italishten e kam mësuar në mënyrë klandestine, me radio, televizor si edhe me disa metodika që qarkullonin dorë më dorë që mua m'i kopjoi nëna në zyrën e saj.

- Mirë bërë që në këtë kohë pushimi disi të imponuar dhë këto provime. Provove veten e më vonë do të shërbejnë si dritare për të lexuar literaturën që do të nevojitet. Çfarë të ka mbetur tjetër deri sa të rifillosh vitin e fundit të shkollës?

- Kam për të marrë patentën për makinë me 4 e 5 shtator, - u përgjigja.

- Përveç se në autoskollë, me kë punon tjetër?

- Pas punës që bëj në fermë, shpesh me Pedron e parkut të traktorëve qarkulloj në gjithë rrugët e fermës ku unë drejtoj makinën e tij. Ai më mëson e më kontrollon me qetësi në të gjitha veprimet që bëj. Ndërsa në teori shpresoj se nuk kam asnjë problem.

- Po instruktorët e autoskollës?

- Ata më krahasojnë me të tjerët e shpesh më reduktojnë kohën e drejtimit të makinës.

- Ku do t'na ndalosh për drekë drejtor?

- Në kolegji, - u shpreh ai.

- Jo. Pas gjithë këtyre rrugëve që kemi bërë bashkë ia vlen të rrimë diku për qejf. Kënaqësi për mua.

- Pse nuk thua edhe pas suksesit tënd?

- Për provimin e fundit nuk kam marrë përgjigje, - foli.

Ai futi dorën në xhep e nxori një fletë ku ishte vertetimi i dhënies nga unë të provimit e nota. U gëzova për notën, për interesimin e Ninos e respektin e profesor Luigjit. Në zemrën time vazhdon të përforcohet ideja se më rrethojnë miq të mirë.

Kur iu afruam kolegjit, ndalua në një lokal mes pemëve anash një përroi. Nino parkoi makinën e më udhëhoqi brenda. Porositëm.

- Kjo verë është prodhim i kantinës tonë, - foli ai, megjithëse unë e njoha menjëherë nga etiketa.



Ishte një shishe ndryshe, gjysëm kilogramshe e mjaft e bukur.

- I kam parë këto shishe edhe tek tuneli i kolegjit, si ambalazh ndryshe, më tërheqëse.

- E do tregu, veçanërisht si ky ku jemi. Ka më pak alkool si verë, por shijohet mirë, - ndërhyri një burrë që ndiqte bisedën tonë me vëmendje.

- Është pronari i lokalit, - foli Nino duke i dhënë dorën me dashamirësi.

E kuptova forcën e shkollës dhe punët që bëheshin aty. U gëzova që isha bërë pjesë e një sistemi shkollor që prodhon ide, mësim e produkte të tilla.

Pas tri ditësh isha te autoshkolla. Kisha ditën teorike. Instruktorët më ndiqnin e, në një moment, më thanë: T'i vazhdo e mëso, por programin tonë e ke përvetësuar. Isha i përqëndruar në bisedë me instruktorët e nuk pashë kursantët e tjerë deri sa një zë shqip më solli në vete:

- Rubi paske ecë shumë para. Të lumtë!

Ishin Brikena e Zana që ndiqnin të njëjtën autoshkollë me mua. Donin edhe ata të mësonin e të merrnin patentën për makinë. U gëzova. Vajzat po bëjnë pjesë të punës e jetës së tyre edhe një element të ri, shpejtësinë. Si moshataret e tyre në vendet e zhvilluara. E mua m'kujtohen disa raste të rralla në vendin tim ku femrat ishin shofere taksie, fugoni dhe një me makinë të madhe transporti për të cilën ishte shkruar edhe një vepër artistike. Në fshat kishte edhe gra traktoriste. Ishte punë e rëndë e raskapitëse për ato.

- E ke parë dramën për shoferen e malit? - ngacmova Zanën.

- Unë e Kena po mësojmë të marrim patentën e makinës që të na lehtësojë jetën, si makina larëse e frigoriferi. Do të jenë pjesë e jona, do t'i blejmë vetë, me të ardhurat tona e brenda së cilës do të ndjehemi mirë, të nderuara, të sigurta.

Jo si shoferet gjithë pluhur, graso e vaj të ngarkuara gjithë lodhje fizike.

- Gëzohem! - Keni gjithë të drejtën e Zotit të jeni këtu si moshataret tuaja.

- Pas marrjes së patentës do të blesh makinën tënde Rubi?

- Pse jo. Të gjitha mundësitë i kam. Puna më vlerësohet, pse të mos i plotësoj kërkesat e jetës. Nuk është mjet luksi, por pune. Fundja, po sikur të jetë edhe luks, kush do ta përdorë, për kë është? Luksi i fituar me punë krim është?

- Jo, jo! Jam dakord me ty.

- Me çfarë erdhët këtu?

- Me makinën e Marios. Pse pyet?

- Jo kot. Një pyetje bëra, por që përgjigja jote nuk më habiti. Bile më sqaroi e u gëzova.

- Mario e Kena kanë ecë përpara në lidhjen e tyre. Kena ka qenë edhe në shpinë e tij e ka takuar nënën e Marios. Kanë njoftuar prindërit e saj në Durrës e besoj nga vjeshta do të shkojnë në altar.

- Po ti?

- Ende jo. Nuk e di se kur mund të hapet kutia ime e fatit. Si dhe ti Rubi.

- Ti e di se prishja me Korinën më ka shkaktuar një rëndesë që më vret ende në shpirt. Nuk dua të kem një të dytë. Do të matem mirë para ndonjë hapi tjetër. Shpinë më ka mësuar ta mbaj nëna, nxehtësinë e shtratit e krijoi edhe vetëm. Atëherë?

- E kujt i thua? Mua? - ndërhyri Zana.

- Unë kam shumë punë të tjera në radhë për të kryer derisa të arrij te shtrati, nuk dua të shpërqëndrohem. Ndjem mirë kështu.

Zana më shikonte e hutuar.

- Gati Zana, - foli instruktori e ndërpreme bisedën.



Zana iku e unë u gjeta i vetëm në pritje të ardhjes së makinave për praktikën e radhës.

Më 4 e 5 shtator dhashë provimet në autoshkollë e mora patentën. Po e plotësoj veten.

- Po tashti?

STUDENT

- Alo Rubin! Mirë je? Më datën 15 tetor duhet të jesh në Bari. Fillon viti i ri akademik. Do të shkojmë bashkë. Bëhu gati. Sipas profesor Luigjit në orën 9-të do të bëhet organizimi e paraqitja e programit nga katedra e pastaj do të shpërndaheni. Ti do të rikthehesh me mua në 'Kastel Blu'. Aty do të jetë qendra e gjithë stazhit për studentët këtë vit akademik. Qartë?

- Po, po në rregull, - fola duke i dhënë falënderimet e mia Ninos.

Ditën e caktuar isha në sallën e leksioneve, pjesë e të gjithë studentëve që po fillonim vitin e pestë e të fundit. Prap student e me një kënaqësi që më bën të ndjehem mirë, i plotësuar në ëndrrën time në vazhdimësi. Mendoj se kam arritur një sukses që duhet të jetë pikësynimi e qëllimeve të mia. Ndonëse në ambient tjetër, në vend tjetër e trupë profesorati tjetër, po ndjehem përsëri mirë, bile shumë më mirë. Nuk më hyjnë në vesh kundërshtimet e Tiranës e epitetet e tyre për mua. Jam në ngritje që fatkeqsisht në vendlindje nuk munda ta siguroj, bile ma mohonin.

Ditën e parë, veshur me rroba pune e pajisje mbrojtëse, mora vesh se grupi ku unë bëja pjesë përbëhet nga 23 djem e 4 vajza. Ata kishin njohje njëri me tjetrin, vetëm unë isha i panjohur mes tyre. Ishin disi të mbyllur e të ç'interesuar për çfarë kërkonin të mësonin, të përvetsonin si nevojë, si



qëllim. Kaq. Bisedat në grup pothuajse nuk ekzistonin. Secili në punën e interesat e veta.

Punën prodhuese e filluam me vjeljen e ullinjëve në brezare nën udhëzimet e kujdesin e profesorit e Umbertos. Na ndanë në grupe me nga tre studentë. Unë me Kolombën e Danten. Na caktuan si detyrë tre rrënjë, si ditë të parë. Filluam nga puna me pastrimet nën kurorë e shtrimin e rrjetës, pas kësaj ngritëm shkallët e me krehër filluam vjeljen e kokrrave të pjekura të ullinjëve, punë që unë e kisha bërë një sezon më parë me skuadrën e Umbertos. Ne e volëm shpejt rrënjën e parë e kaluam në të dytën. Praktika ime i tërhoqi vajzën e djalin. Më vlerësonin në heshtje me shikim.

- Ku ke mësuar të punosh kaq mirë e shpejt? - më pyeti Kolomba.

- Këtu. Kam dy vite që punoj në fermë. Ky është i treti, - fola.

- Pse nuk ke fermën tënde ti?

- Jo, - fola e qesha me vete e për të shuar kureshtjen e vajzës vazhdova: - Unë vij nga Shqipëria ku pronat bujqësore janë, apo kanë qenë shtetërore. Atje kam qenë student si ju. E braktisa e ika.

- Pse? - pyeti vajza.

- Këtu më pëlqen të jetoj. Të përfundoj studimet e të marr diplomën. Pse të habit ky fakt?

- iu drejtova vajzës.

- Jo, po pse pikërisht këtu?

- Italia më tërheq e më krijon atë hapsirë e mundësi që kërkoj unë për një jetë tjetër. Ndryshe nga vendi im.

- Ku bie Shqipëria? - vazhdoi në të sajën vajza.

- Nga Bari 170 km matanë, në bregun tjetër të Adriatikut. Fqinj të përjetshëm. Nuk e dije?

- Jo. As në gjeografi nuk e kam ndeshur. Mbase vend i vogël.

Kur e pyeta për Skenderbeun, për emigrantët shqiptarë e eksodet e hershëm e të sotëm të tyre, nga ajo mora ngritje krahësh, padijeni, habi.

- Si kështu? - pyeta. Këq iu kanë dhënë të mësojnë apo nuk i interesojnë vajzës mendova, e ... heshta.

Punonim 4 orë e pjesën tjetër të kohës ktheheshim në qytezë, në sallë për të plotësuar ditarin e punës. Çdo student sipas mënyrës së tij përshkruante në fletore gjithë praktikën e punës së kryer që do të vlerësohej më vonë nga profesori.

Përveç vjeljes së ullirit, në fermë punuam edhe në vjeljen e rrushit, dardhave e frutave të tjera në kolegjin profesional ku Nino e profesor Luigji na ndiqnin nga pas me disiplinë të rreptë. Unë e di këtë rregull ndaj nuk bëj asnjë lëshim.

Në muajin dhjetor profesori më hoqi nga grupi e më dha disa udhëzime për ndjekjen e disa detyrave të veçanta në fidanishte. Pse vallë? - pyesja veten, por nuk kisha guxim të pyesja. Nuk e di se çfarë projektonte ai në emrin tim, çfarë shihte e mendonte për mua, apo në çfarë prove po më vinte. Gjithsesi dhe jashtë çdo gjykimi do të bëj detyrat që më jep profesori. Kjo është edhe porosi e Ninos.

Në muajin shkurt u bashkova prap me grupin në praktikën e krasitjes. Prap me Kolombën e Danten. Tjetër punë e të tjera pajisje. Më shohin disi me habi se si i përdor ato.

- Unë nuk kam fermë, - u përgjigjem prap kureshtjes së tyre.

- E dimë. Çdo të thuash me këtë?

- Ju keni ferma, jeni të pasur e jetën e bëni si të doni. Po unë që nuk kam asnjëlloj pasurie çfarë duhet të di më tepër që të bëj jetën që dua? Jam trupzhveshur. I pasigurtë.

Kolomba e Dante qeshën. Unë vazhdova: - Mungesën e fermës duhet ta kompensoj me dije të thella e të vlerësuara. Me shumë profesionalizëm. Një farë mburoje kjo për mua.



- Lexova, por dhe dëgjova lajmet e fundit për vendin tënd e me dhimbje kuptova disa nga ato mendime që më shprehe ti. Bile, duke të njohur ty dënova disa qëndrime indiferente të qeverisë tonë, - ndërhyri Kolomba.

- Është një popull që me pasuritë që ka, nuk e meriton vuajtjen, - foli me dhimbje.

- Po pse nuk ke fermë ti? - pyeti Dante duke e kthyer bisedën.

- Tek ne ka ndodhur një kolektivizim total. Sipas meje çmenduri shtetërore që filloi me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore e fatkeqsisht vendi im e gjen veten në krahun lindor të ndarjes së botës. Gjithë tokat u bënë ferma shtetërore e njësi kooperativiste që drejtoheshin në mënyrë të përqëndruar nga shteti. Nga këto njësi sigurohej disi ushqimi i popullsisë e lënda e parë e industrisë së lehtë e ushqimore sipas një plani politik të programuar nga shteti.

- Po të ardhurat e këtyre ekonomive rurale si përdorëshin?

- Çmimet e produkteve bujqësore ishin shumë të ulta, fikse, afër kostos bile disa prej tyre edhe nën të e të ardhurat e shitjes përdorëshin nga shteti për industrializimin e vendit. Rast unik në botë për varfërimin e fshatit. Mekanizimi bazohej në një teknikë të vjetëruar e puna e gjallë komandonte kudo.

- Pse kështu?

Pashë profesorin e Umberton që afër nesh po ndiqnin me interes bisedën tonë. Gjithsesi, vazhdova diskutimin me moshatarët e mi italianë.

- Po puna tek ne paguhet pak, shumë pak. Ajo tek ne është vlarë. E kur puna vritet humb interesi e kuptohet, ajo urrehet.

- Pse?

- Se ajo të rraskapit, të turturon e sjell pak të ardhura, ndaj nuk respektohet.

- Po sot me sa kam dëgjuar gjërat atje po ndryshojnë për mirë, - ndërhyri Dante.

Edhe unë i kam dëgjuar, bile me shumë interes, por toka bujqësore u nda me një ligj katovist, jo sipas pronësisë. Kjo sipas meje i mbylli dyert zhvillimit rural. E kuptoni se çfarë sjell ky coptim i pronave bujqësore? E kthen fshatarin në argat që robtohet në një ekonomi të mbyllur e joproductive.

- Pse kështu? - vazhdoi Dante.

- Nuk e di mirë. Isha këtu me ju kur atje ndodhi përmbysja e madhe.

Sakaq profesor Luigji e Umberto u afruan tek ne, kontrolluan punën tonë dhe me pak vërejtje e miratuan atë që kishim bërë e duke më parë në sy foli:

- Bravo Rubin! Përveçse një krasitës i mirë, sot u shfaqe edhe si politolog i ekonomisë agrare.

- Në vendin tim politika ishte në plan të parë, ndaj vuanim për shumë gjëra. Hanim, vishnim e kudo që punohej konsumohej fatkeqsisht politikë. Kudo politikë, por shterpe.

Të nesërmen në një ditë të ftohtë e me erë veriore vazhduam krasitjen. Të veshur ashtu me rroba, doreza e vegla sipas nevojës ishim më të ngathët e të mpirë. Kolomba e Dante shpesh më pyesnin për ndonjë veprim.

- Pse zgjodhe fermën 'Kastel Blu', - pyeti Kolomba.

- Këtu ulliri ishte kulturë e vetme e trajtohet me cikël të mbyllur nga fidanishtja deri në prodhim. Unë vij nga një fshat që ndodhet mes Tiranës e detit Adriatik, me kodra të buta e klimë mesdhetare ku ulliri është bimë shumë e dashur, por e trajtuar keq, si e egër. Jo si këtu. Jam dashuruar që herët me këtë bimë. Ne kemi trashëguar nga të parët tanë 13 rrënjë që nuk u dihet moshë, gjithmonë të gjelbërta e çdo vit japin kokrra. Janë mbjellë në vende ku pemët e tjera e kanë të vështirë jetesën nga thatësira e terreni.



- Pse i vlerësoni veças këto bimë?

- Nuk rriten të larta e kurorën e kanë të gjërë si çadër, kanë dru të fortë. Thonë se as rrufeja nuk i gjuan. Bimë e bekuar. Kur mbillet si fidan, ngul rrënjët në shtresat e tokës, thellë e me një miqësi që zgjat shumë, vite e shekuj. Merr prej saj ujin e çfarë i duhet e i jep asaj, tokës, qëndrueshmërinë, bukurinë e gjetheve në çdo stinë dhe hijen. Thotë historia se njeriu që herët, duke qënë pranë saj ndjeu siguri e ndërtoi banesën, qytetin, kishën e braktisi emigrimin anash brigjeve të lumenjëve. Nga kasollja lëvizëse u vendos në shpinë e përhershme, se nuk ndahej nga ulliri. Kështu u ndërtuan qytetet e botës e shumë të mira brenda tyre. Në fqinjësi me këto bimë të egra e të buta njëherësh e lindi qytetërimi mesdhetar.

- Pse të egra e të buta? - pyetën të dy moshatarët e mi.

- Ditën tjetër do t'ju jap këtë përgjigje si dhe do t'ju tregoj edhe disa gjëra të tjera.

Kisha menduar t'u flisja për Skenderbeun, princin e vendit tim e vendimin e tij që çdo çift i ri përpara se të shkonte në altar detyrohej të mbillte publikisht dy fidana ulliri. Por ditën tjetër me profesor Luigjin ishim në fidanishte, në laborator mes specialistëve e një bote bimore të kontrolluar thellësisht nga mendja njerëzore. U bëra pjesë e tyre. Do të zbatoj detyrat që po më ngarkonte ai për teknikat e reja të shumimit. Do ta shoh me sy se si ndodh. Mrekulli!

Në fidanishte punova pothuajse gjithë pranverën. Plotësova dokumentacionin e drejtova matrikullimin e çdo fidani. Ndjehesha rehat, por edhe i vlerësuar kur profesori në vizitat e tij më përgëzonte për punën e disiplinën time.

- Dua të të besoj edhe një detyrë tjetër, - më tha një ditë në zyrën e specialistëve: - Do të bësh edhe matjet biometrike të një grupi të veçantë fidanash në serë.

Me këtë detyrë, ndonëse ende student, u barazova për nga pozicioni me specialistët e tjerë të fidanishtes. E kuptova se ky besim ishte suksesi im i parë. -Duhet vlerësuar kjo detyrë profesor, e do ta bëj mirë, -u shpreha së brendshmi me veten.

Në fidanishte mbarova detyrat që më ngarkoi profesori e, kur filloi praktika e mekanizimit në fermë, isha me studentët e tjerë tek parku. Pedro drejtonte me profesorin proceset sipas programit. Erdhi edhe radha ime. Me Pedron bëmë gati agregatët sipas radhës. Bëra detyrat e ushtrimet që më dhanë. Nuk më mbajtën shumë. Pas dy ditësh u vlerësova.

- Vazhdo tek fidanishta, - më urdhëroi prap profesori.

Tashmë isha bërë i njohur me specialistët e fidanishtes, të fabrikës së vajit, të laboratorit e parkut. Njerëz që respektonin punën e dijen. Jeta e puna e tyre më diktonin sjelljen e vlerësimin e mundësive që po më krijoheshin. Tash e kisha të qartë se për mua jeta shtyhet përpara me shumë punë e dije. Zbatoj detyrat e radhës.

Krahas punës në fidanishte sipas programit të provimeve formuese nisa dhe studimin nga tema në temë e kapitulli në kapitull. Shpesh shetisja me Robertson, por dhe me studentët. Me Kolombën e Danten. Mora vesh se ishin nga e njëjta zonë, diku larg prej këtu, në jug.

Nuk harroj të dal me vrap në pyllin e kontit. Ndonjë paradreke luaj dhe basketboll në palestër. Tërhoqa edhe studentët pas vetes. Luanim e djersiteshim shumë. U ndjeva mirë mes tyre.

- Po ti qënke basketbollist klasi, - më ngacmoi pas ndeshjes Kolomba.

- Vërtetë kohën nuk e kam shkuar kot.

Në fund të prillit praktika e puna prodhuese përfundoi. Dorëzua projekt-kurset me shkrim te profesori e prisnim



vlerësimet. Filloi sezoni i provimeve. Për mua qyteza ishte vend i qetë e me mundësi për të studiuar. Shumë më mirë se në ILB-në e Tiranës. Paradreke studioj në bibliotekë, pasdreke në shpi.

- Alo Rubin! - Jam Mario. - Kur i ke provimet e shtetit?

- Pse? - pyeta.

- Kam porosi nga Nino që të jem me ty.

- Po Nino ku ndodhet?

- Është diku larg e në provimin e parë do të shoqëroj unë.

- Të falemnderit! Është kënaqësi të jem me ty, - folta e dhashë datën.

- Mirë Rubin! Atë ditë do të shkojmë e vijmë bashkë nga Bari. Dakord!

- Po. Të falemnderit!

Rrugën deri në Bari e bëmë në qetësi. Isha i ngarkuar me përgjegjësinë e shqetësimin e provimit. Makinën e drejtonte Mario. Kur arritëm në UM të Barit, provimi kishte filluar, por unë isha i fundit në listën e grupit tim. Duhej edhe pak kohë që të vinte radha ime. Përshëndeta bashkëstudentët e fillova të bëj ecejake në koridorin e pushtuar nga emocionet.

Edhe Kolomba ishte në pritje tek dera. Vetëm. E përshëndeta e mora buzëqeshjen e saj. Ishte veshur bukur e kishte bërë një tualet të lehtë. Pinte cigare.

Hynin e delnin studentët nga salla e provimit. Secili në qetësinë e vet. Ndryshe nga ata të Tiranës ku në raste të tilla shqetësimet e opinionet shpërndareshin në mënyrë të barabartë e studentët në grup prisnin deri sa të përgjigjej edhe i fundit. Në grup merrnin edhe rezultatet.

Erdhi radha ime. Hyra në sallë. Përshëndeta panelin e profesorëve e mora tezën. Diku u ula. Lexova pyetjet e u qetësova. Fillova t'i zhvilloj me radhë. Ndjehesha i sigurtë.

Fillova të përgjigjem. Paneli, megjithse isha i fundit, më ndoqi me vëmendje. Më bënë disa pyetje. U përgjigja. Dola. Në korridor ishte Kolomba e Mario. Të tjerët kishin ikur. Ishte ora 14 e 10 minuta. Rezultatet do të publikoheshin në orën 16-të.

- Si dole? - pyeti Mario.

- Mendoj se mirë.

- Derisa të dalin rezultatet kemi kohë të hamë drekë.

Ndjehem i çliruar, por kam uri - fola.

- Shkojmë atëherë.

- Eja me ne Kolomba. Mos rri vetëm.

- Faleminderit! - foli vajza e gëzuar për ftesën tonë.

Në orën e caktuar morëm përgjigjet e provimit e u nisëm drejt 'Kastel Blu' Unë me Marion e Kolomba në makinën e saj, pas nesh. Ndalua dikë. Mario më lëshoi timonin. Kishte dhimbje kreje. U shqetësova e para një farmacie ndalua. Mori një ilaç, e piu me ujë e u nisëm prap. Rrugës afër shpisë së tij ndalua. Pas nesh vazhdonte të vinte Kolomba. Ndaloi edhe ajo. Marios ende nuk i kishte pushuar dhimbja.

- Rri Mario. Unë po shkoj me Kolombën. Kemi një pjesë të rrugës bashkë, - fola pasi isha marrë vesh me vajzën.

- Shkon vetë apo të çoj unë deri tek shpia?

- Po, po, pa problem, - foli Mario e ndërroi vend në makinë.

E përshendetëm dhe me Kolombën u nisëm.

- Kishe marrë notë maksimale Rubi? Bravo! Dukeshë mirë që në praktikë, - vazhdoi ajo duke parë jashtë nga xhami i makinës.

- Po e përsëris prap: - Që të siguroj një vend të vlerësueshëm pune, më duhet të kem rrezultate shkollore të larta. Jeta ime nuk ka aset tjetër, këtë e kam të qartë. Ndryshe nga ti e shokët e tu.



- Unë kam të tjera motive. Kujdesi për fermën më ka shtyrë të vazhdoj këtë shkollim. Në fermë duhet që efektiviteti ekonomik të ketë vazhdimisht rritje, ndryshe falimenton, - foli vajza.

- Ashtu është. Në pasuri nuk ka barazi, - fola.

Ndërkaq arritëm në sheshin e qytezës. E ftova vajzën për një kafe. Nuk deshi. E falenderova për shoqërimin e iku.

Sapo hyra në shpi, formova numrin e telefonit të Marios. Doli Brikena.

- Alo! Rubini jam.

- Si je? - më tha Mario se në provim more notë shumë të mirë. Suksesel!

- Të falemnderit! Desha të di si është Mario, kishte pak dhimbje kreje në kthim.

- I ka pushuar e po merret me pëllumbat në kopësht.

- Mirë je ti?

- Mirë, po ti na harrove krejt. Që nga dita e dasmës nuk je dukur më. Im atë, sa herë flas me të, më pyet edhe për ty.

- Çfarë thotë për 'Bensin' që i dhurove?

- Sa nuk fluturon. Ti e kupton se ai i do shumë makinat gjermane.

- Po me shkollën si po ecën?

- Shpresoj që të fillojmë këtë vit, si unë edhe Zana.

- Shumë mirë! - fola e duke i thënë natën e mirë, ula receptorin.

Vazhdova në ritmin tim të punës për provimin e dytë. Gjatë pushimit dilja në shesh, vetëm ose me Roberton shikoja me kënaqësi kujdesin për lulet, shatërvanin, stolat, rruginat, portat e parkingun, ndriçimin, rrjetin hidraulik e gjithçka tjetër. Shikoja muret e ndërtesave ndonëse të vjetra, por të mirëmbajtura këndshëm. Rrezatonin ende fisnikëri. Shikoja që gjithë kohën punohej në mirëmbajtjen e qytezës.

- Janë specialistë të zot e punëtorë të palodhur. E duan shumë këtë vend, - foli Roberto.

- Dhe paguhen mirë, - shtova unë.

- Po. Shumë mirë!

- Kush e drejton qytezën?

- Zgjidhet një këshill, ka një bord dhe në krye me një status të veçantë është konti di Napoli.

E unë sillja në mendje sheshin e Tiranës, të kryeqytetit për të cilin punonte e paguante e gjithë Shqipëria. Isha i zhgënjyer. Kudo kisha lënë nga pas vetëm ngjyrë gri. Pakujdesi. Lulishte të shkatërruara, shatërvane të thara... E me refleksione të tilla vazhdova të përgatis provimin e fundit. Nuk më hiqeshin nga mendja vendlindja e njerëzit e mi. Sëmundje!

Në provimin e fundit shkova me Ninon. Në sallë paneli shtetëror. Prap i fundit. Fola sa e si desha për pyetjet. Nuk më ndërhyne. Kur përfundova më bënë disa pyetje, disi jashtë tezës, por brenda disiplinës shkencore. U përgjigja e me sa pashë në fytyrat e tyre ishin të kënaqur.

Dy më të rinjtë e panelit komunikan mes tyre anglisht për mua duke më adresuar si bashkudhëtar i atyre 'fantazmave' që, pasi kishin zbritur klandestinë me anije të rrëmbyera, qeveria italiane i kishte mbyllur në stadiumin e vjetër të Barit, ku ndodhën ata ngjarje të trishta që u pasqyruan gjërësisht e me tone raciste në shtypin e mediat e vendit.

E dëgjova me vëmendje e me dhimbje cilësimin për bashkatdhetarët e mi e po anglisht iu ktheva atyre: - Edhe unë jam pjesë e tyre, por kam ardhur ndryshe në vendin tuaj. Ju duhet të dini se ata e unë jemi pjesë e një populli që ka hequr të zezat e ullirit e kjo, jo për fajin e tij. Ata nuk janë fantazma, por shqiptonja që me forcë e kurajo kapërcyen telat me gjemba drejt lirisë. Ata nuk gabuan. As unë nuk kam gabuar para tre vitesh. Vrapova drejt ëndrrës, drejt



lirisë. U gjeta tek ju. Gabova? Erdhëm të kërkojmë ndihmën e munguar, - fola.

Të dy profesorët më shikuan me çudi e u zverdhën në fytyrë.

- Ju dini anglisht? - pyetën njëherësh.

- Heshta.

Atë çast i gjithë paneli i pedagogëve u ngri në karrige.

- Ju keni të drejtë. Edhe ne jemi fajtorë për gjendjen e popullit tuaj, - u shpreh përfaqësuesi shtetëror në panel.

Profesor Luigji nga ku ishte vetëm, shihte e dëgjonte. Një fytyrë i vinte e një tjetër i shkonte. Pasi mbaroi fjalën e tij përfaqësuesi shtetëror thirri në drejtimin tim:

- Eja këtu djalë, dua të të jap dorën.

Shkova para katedrës e i dhashë dorën profesorit. Ai nuk më lëshoi e me një zë që depërtoi thellë në shpirtin tim foli: - Të lumtë! Me përgjigjen tënde nderove veten dhe ata që erdhën pas teje që ne i quajtmë pa të drejtë fantazma. Ata janë siç thua ti, shqiponja. Suksesel!

U ngrit në këmbë gjithë paneli, më dhanë dorën e më uruan. Dy profesorët e rinj që u bënë ingranazhi i këtij ngacmimi më kërkuan falje, të përulur më ndoqën me sy.

I kuptova të gjithë e në dalje nga salla i përshendeta. Sytë e profesor Luigjit më ndiqnin me ëmbëlsi. Sfida ishte nga ana ime.

Jashtë më priste Kolomba duke pirë duhan. Në oborr Nino kishte ndezur makinën.

- Si dole? - më pyeti.

- Mirë! - fola e kur po hanim drekë i tregova për incidentin me fjalë në panelin e provimit. Heshti pak e i mërzhitur foli:

- E pashë trazimin në fytyrën tënde, por hidhe pas. Italia e njerëzve të mirë ka edhe të tillë, të lajthitur. Mos u mërzhit, - më qetësoi i miri Nino.

- E kam të qartë! - fola e heshta.
- Ditën e ceremonisë shtetërore të mbylljes së viti akademik unë do të jem në një aktivitet ndërkombëtar në Romë e më vjen keq që nuk do të jem me ty. Do të porosis Marion e profesor Luigjin që të lidhen me ty.
- Pse? - ndërhyri për të parën herë Kolomba.
- Të shoqërojnë Rubinin nga 'Kastel Blu' për në Bari. Është pa makinë dhe ende ndjehet i huaj. I vetëm.
- Mos u trazo. Rruga ime kalon nga 'Kastel Blu'. E marr unë. Udhëtimi vajtje-ardhje me Rubinin shpresoj se do të jetë i këndshëm. Jemi miq të mirë.
- Apo jo Rubi?
- Faleminderit vajzë! - foli Nino.
- Vërtetë, ditën e orën e caktuar ishim me Kolombën në Bari, morëm pjesë në ceremoninë e përfundimit të studimeve dhe pasdreke u kthyem nga erdhëm.
- Të falenderoj Kolomba! Po deshe në bar ose në shpinë time mund të pijmë diçka e të pushosh pak. Mundet edhe të rrish këtu sonte. Kjo është në dorën e dëshirën tënde.
- Jo Rubin. Sonte do të iki, por rezervoj të drejtën që të vij një ditë tjetër. Të lutem a mund të më japësh numrin tënd të telefonit?
- Me kënaqësi. Menjëherë nxora një letër, e shkrova dhe ia dhashë.
- Atëherë, suksese e gjithë të mirat, - përshëndeti Kolomba.
- U ndamë. Ajo ktheu makinën e mori drejtimin e portës së daljes. Iku.



Në fund të qershorit, sipas njoftimit, erdhën profesor Luigji e Nino në fidanishte. U gëzova.

- E nderove veten e vendin nga vjen në provimin e shtetit. Jo vetëm që dole me rezultate shumë të mira, por mbrojte edhe punën e aventurën tënde. Ishte një sfidë që ti e fitove. Bravo djali!

- Ju falemnderit! Unë nuk kam ardhë këtu të sfidoj njeri, por veten. Mbase sot moshatarët e mi më quajnë disi jashtë modulit të tyre, por unë i kam hyrë kësaj rruge: Të merrem me prodhimin bujqësor e t'i kushtoj atij kohë e punë, vëmendje e dëshirë. Sfidat ime është e thjeshtë, në fermë të kem një punë ku të vlerësohem.

- Rubin, marrja e diplomës e zotërimi i gjuhëve të huaja të jep mundësinë që me vullnetin tënd e dijet që ke fituar të bësh punë të mira, - foli profesori e vazhdoi:

- Këtu është arkivi i punës shkencore të bërë në vite nga profesorët e UM të Barit si dhe shumë revista shkencore. Të gjitha të skeduar e janë një burim i rëndësishëm informacioni. Duhet t'i lexosh se aty ka gjera me shumë vlerë e do të të duhen për punën tënde në vazhdimësi.

- Që sot do të shkëputesh nga grupi i Umbertos, do të jesh ndihmësi im në bazë. Kam sjellë edhe planin e punimeve që do të kryhen gjatë muajve të verës në fidanishte. Ti do t'i ndjekësh sipas kalendarit, i pavarur nga unë.

- Qartë? - pyeti profesori.

- Po, -e vazhdoi: -Nëse më lejohet të pyes, ku do të shkosh për pushime profesor?

- Unë jam nga 'Izola Bela' një ishull i veçantë në liqenin e Komos, në Lombardi. Kam vite që nuk kam shkuar atje. Ai vend është i veçantë për mua. Aty dora e njeriut ka bërë mrekullinë me gurin, bimët e ujin. Kam kohë pa e parë e

shumë mall. E ajo dashuri më solli këtu, më afroi e më bëri të afërt me bimën e ullirit. E nuk gabova, do të shkoj pak kohë atje, - mbylli fjalën e tij profesori.

- Në llogarinë tënde në bankë është hedhur bursa shtetërore e vitit si student, mendo të zgjidhësh ndonjë nevojë ditore, - foli prap Nino.

- Ju faleminderit, - fola e i ftova të dy në barin tonë afër laboratorit.

Kur kishim zënë vend, mes nesh erdhi një grua me një ftyrë të mpirë, disi e mbyllur në vete, shumë e tërhequr, trupdrejtë, me sy të futur pak në gropat e tyre. Ftyra e saj disi e kontraktuar, sikur ishte në kundërshtim me trupin. U kujtova se kisha lexuar diku se ftyra është pasqyra e shpirtit. Po çfarë mund të shprehte ftyra e një gruaje si ajo?

Na bërshëndeti e u ul siç erdhi. Qetë e pa shikuar majtas e djathtas.

- Kjo është Ofelia, - foli profesori. E njihni Rubinin? - i drejtohet asaj.

- Ajo heshti. Një heshtje që sipas meje diçka fshihte, po çfarë? Mohim apo pohim?

- Është shefe e laboratorit të fabrikës e fidanishtes, doktoresha Ofeli Baldini e vazhdoi: Bashkëpunëtorja ime më e mirë në këto dhjetë vitet e fundit. Së bashku kemi certifikuar prodhimet e fermës që janë shitur në Itali, gjithë Mesdheun e më larg.

Ofelia dëgjonte. Më shikoi pak me përqëndrim. U tërhoq. Vura re se mes ftyrës së saj e trupit diçka nuk shkonte. Pse pyesja veten? Lëkura e gjymtyrët flisnin për një moshë e trajtesë tjetër. Çfarë fshihej pas asaj ftyre të rënduar? Të lodhur! Vrarëlije si maskë, me një hije sipër. Po pas atyre syve të futur thellë në gropat e tyre çfarë kishte?

- Duhet që sipas programit ju të dy, pra ti Ofeli e Rubin deri në fund të muajit gusht të bëni matjet biometrike tek



grupet e programuara të fidanave që do shpërndahen këtë vit e t'i hidhni në regjistra.

- Po profesor, - u përgjigj Ofelia.

- Rubin?

- Dakord! - fola unë.

- Atëherë me Ninon po largohemi. Ju urojmë punë të mbarë!

Gushti filloi me një vapë të madhe. Vinim më shpejt në fidanishtë. Kryenim detyrat që na la profesori e kohën e lirë lexoja relacionet shkencore të arkivit. Me Ofelinë rrinim disa orë të ditës bashkë, punët na afruan, diskutonim edhe kalendarin e punimeve. Ajo hapet disi me mua duke dalë pak nga vetja. Filloi edhe të shprehet për ndonjë problem, por më shumë më vëzhgonte, po pse?

- Sikur të shkojmë pas pune lart, tek liqeni është më fresk. Vazhdojmë të flasim e lexojmë atje, - sugjeroi çuditërisht një ditë Ofelia kur vapa ishte kthyer në bezdi.

Pranova. Bile u habita me ftesën e papritur të kësaj gruaje.

- Si i erdhi ky mendim? Çfarë e ngacmoi? - mendova me vete.

Në orën 11-të shkuam te liqeni. Aty ishte dhe Roberto me Sandron. Si ne kërkonin mbrojtje nga vapa. I përshendeta me dorë.

- Kush janë këto? - pyeti Ofelia.

Kur i tregova, ajo indiferente, sikur fliste për tuarekët e maleve Atlas, m'u përgjigj: - Nuk i njoh.

Zumë një çadër. Më vonë u lamë në pishinë. Pjesën tjetër të ditës lexonim në qetësi. Shijua dhe freskun që vinte nga malet e sipërfaqja ujore e liqenit. Një ditë morëm një varkë e shëtitëm gjatë në ujin e liqenit. U kënaqëm me pamjet që na ofronte pylli përçark, luginat e shpendët që popullonin ujanën blu.

- Këtu po e kalojmë mirë, është vend shumë interesant,
- u shpreh Ofelia.

- Me sa kam mësuar, këtë vend kështu e ka bërë familja e kontit. Ai e dinte se pa ujë qyteza do të kishte zhvillim të cunguar. Duhej siguruar uji. Për këtë ndërtoi digën e nga një basen i vogël uji krijoi liqenin ku mblodhi rrezervën ujore të domosdoshme për jetën urbane të qytezës e për zhvillimin e jetës bimore të fermës.

- Projekt i menduar mirë!

- Më vonë, siç duket, deri këtu bëri rrugën, ngriti këto ndërtesa banimi e shërbimi që gradualisht mori pamjen e funksionin e një pike pushimi të këndëshme. Në qendër është vila e kontit, rrethuar me lulishte e pemë, me shkallët që zbresin deri në liqen, në molin e vogël ku janë ankoruar disa varka me vela.

- Jetë konti!

Më 16 gusht, çuditërisht, ra shi. Gjithçka ndryshoi. Nuk shkuam në breg të liqenit. Në fidanishte kishim punë. Disa formularë duheshin plotësuar e krahasuar me rezultatet e përpunuara një vit më parë.

Të dielën dola në pyll. Pas shiut ajri aty ishte shumë i pastër, i freskët. Ndjehej aroma e barit të rilindur. Kur u ktheva në qytezë, takova Roberton.

- Si arrite të shoqërohesh me inxhinieren e fabrikës së vajit? - më pyeti i çuditur.

- Pse pyet kështu?

- Çuditem!

- Pa e ditur të vërtetën?

- Cila është e vërteta?

- Ajo, pra Ofelia, më afroi pushime me kërkesën për shoqërim tek liqeni.

- Dhe jo ti?

- Me makinën e saj shkuam atje. Ajo e drejtonte.



Roberto u habit e vazhdoi:

- Ka disa vite këtu e përveçse me profesor Luigjin nuk e kam parë të shoqërohet me asnjë tjetër. Shkon e vjen kudo vetëm, në punë, markete e kishë.

Të nesërmen isha poshtë, në fidanishtë. Ofelia në fabrikë. Në drekë u takuam në bar. Pasi hëngrëm drekën, ajo nuk u largua, por porositi dy kafe.

- Kush është Rubini? - hodhi pyetjen në drejtimin tim.

E shikova drejt e në sytë e zvogluar nga thellimi në ballë. Nuk më thanë gjë. Vendosa të sqaroj pyetjen e saj. Përsërita gjithë korikulumin tim e prita.

Më dëgjoji me shumë interes e vëmendje. Sikur i thithte të gjitha fjalët e mia. Ndërhyri dy herë me pyetjet: - Pse ike nga Shqipëria? - Pse zgjodhe një fermë për të ndërtuar jetën tënde?

Përgjigjet e mia e habiten, e turbulluan, bile e çoroditën. Ofelia heshti. Unë qesha. U ndjeva më i lirë. U shkarkova disi. Pse kështu? A mund të heq nga vetja çdo përjetim? T'i ndaj me një tjetër? Apo të dyzohem në kujtesë? Kjo mund të jetë, apo është njeriu që mund t'i mbartte disa nga ato? Mbase! Pse do t'i duhen? A nuk ka Ofelia kujtimet e veta? - mendova.

PJESA E DYTË

NË FERMË, POR NDRYSHE.

Në fund të gushtit erdhën në fidanishte profesori e administratori i fermës. Po lexoja një studim për ullirin e Sardenjës kur trokitën në derë.

- Mirë se erdhët, - fola e u ngrita në këmbë.

- I paske hapur punë vetes, - foli profesori.

- Vërtetë siç thoni ju është, por pa këto njohuri nuk mund të ec përpara. Nuk i keni rezervuar kot këtu e mbi të gjitha ky studim po më habit, më tërheq e më thërret. Mbase një ditë duhet të shkoj me mision në ishull.

- Pse jo. Mesdheu të shfaq kudo të papritura bimore të pafundme.

Pas kësaj hyrjeje disi befasuese, u ulën në tavolinë. Pas tyre erdhi edhe Ofelia. Gjithnjë e njëjtë. E mpirë, me lëvizje e fjalë të kursyera. Zuri vend në heshtjen e saj. Dëgjonte e shihte.

- Ishim në një takim me kontin. - filloi profesori e vazhdoi, - Unë për arsye pune që sot e në vazhdim do të jem më pak fizikisht i pranishëm në fermë, në fidanishte. Por kjo nuk më pengon që të jem programuesi i gjithë punës që do të bëhet në vazhdim. Bile me kërkesa të reja e me një vizion të ri. Ferma dhe UM i Barit do të bëhen modeli i studimit të bimës së ullirit, kësaj bime të egër dhe shumë të butë që zoti e lindi në Mesdhe për njeriun. Të kujtoj ty



Rubin që bima e ullirit 4000 vjeçare në Luras të Sardenjës apo i Il Barone 2000 vjeçare në Pulia që ti po studion, janë për publikun e historinë e natyrës monumente, por për ne studiuesit një rezervë apo bankë natyrore e çmuar e materialeve biologjike të ruajtura mrekullisht mirë. Fat për ne e breznitë e sotme që duhen shfrytëzuar për të kthyer ullirin në një bimë prodhuese të vajit më të mirë në planet.

Po kjo i takon së ardhmes së afërt. Ne do të vazhdojmë të transformojmë punën e nisur në fidanishte deri tek përdorimi i materialeve biologjike që na vijnë nga kjo ruajtje natyrore.

Këtu profesori ndaloi, më shikoi në sy e hodhi pyetjen:

- Të pëlqen ideja jonë?

- Po, bile është shumë ngacmuese e disi romantike.

- Do të kishe kënaqësinë e vullnetin të bëheshe pjesë e këtij projekti?

- Do të jem i privilegjuar të bëhem pjesë e kësaj pune dhe i kastit që do merret me të.

Konti e Nino kanë besim tek ti e kërkojnë që, nëse ju jeni dakord, pjesën zbatuese të punës në fidanishte ta besojnë ty, të ndjekësh zbatimin e gjithë programit të hartuar për vitet në vazhdim.

- Jam shumë dakord, - fola pa menduar gjatë duke lënë pas modestinë.

Në këtë propozim e ndjeva veten shumë të vlerësuar. E kuptova se profesori ka ndikuar në vendimin e kontit. E pashë në sy. Rrezatonte miqësi e respekt. Edhe siguri.

- Është një mundësi e mirë të depërtosh në të fshehtat e kësaj bime. Ajo duhet të humbë privatësinë saj. Mbase këtu do të fillojë një erë e re në punën e njeriut me këtë bimë të shejtë.

- Së bashku me ty do të jenë dy specialistët e serës e Ofelia me vajzat e laboratorit, - ndërhyri administratori që

vazhdoi: - Ti do të shkëputesh nga rutina e punës me Umberton në fermë. Ke mjaft punë në fidanishtë. Së shpejti do të instalojmë edhe internetin e lidhjet me UM të Barit do të bëhen pa ndërprerje. Këtë vjeshtë e në vazhdim do të punoni të plotësoni kontratat për fidana e vitin tjetër me projektin që citoi profesori. Kohë ka, por edhe nuk ka, - foli ai.

- Qartë Rubin?

- Po ti Ofeli?

Si unë edhe Ofelia shprehëm dakordësinë me detyrat. Ishte një praktikë që e kisha filluar vitin e kaluar, por që këtë vit ishte disi ndryshe, nuk do të kisha mbikqyrjen direkte të profesorit. I pavarur. Gjithçka e kisha unë në kurriz. Do ta mbaja? E dija se të përgatitësh 3 milion fidana për treg e t'i certifikosh ato është një vëllim i madh pune. Po kështu ndjekja e detyrave shkencore që vazhdojnë të aplikohen në bazë është një përgjegjësi e madhe. Provël Jepi Rubin! - i thashë në heshtje vetes.

Profesori e administratori ikën. Ne mbetëm në bazë. Shikova Ofelinë. Sytë e saj nuk shprehnin asgjë. Mbase pak qetësi apo kënaqësi. Pse? Nga erdhi? Çfarë fitoi ajo? Nuk e di. Ta shoh më vonë, mendova me vete.

Në javën e dytë të shtatorit filluam përgatitjet e fidanave për treg. Analiza e të kokrrave, matje biometrike, mbushje formularësh shoqërues e dorëzimi i tyre tek sheshi i marketingut. Vjen ekipi qeveritar i certifikimit. Bëri detyrën e iku. Sakaq me Ofelinë punonim deri vonë. Kur filloi vjelja e prodhimit në fermë, kishim bërë gati për shitje mbi 2 milion fidana. U lehtësuam. Nuk duheshin ngatërruar punët. Çdo gjë në rendin e saj.

Shihja makinat që nga sheshi i marketingut ngarkoheshin me fidana drejt vendeve të mbjelljes së përhershme e gëzohesha. Bashkë me to shkante apo



fluturonte gëzimi im, puna ime, firma e trazimi im, frymëzimi e urimi që bota të ketë më shumë gjelbërim, më shumë vaj ulliri në tavolinat e njerëzve të saj.

Pashë kontratat: Kërkoreshin fidana nga institucione tregtare, shkencore, fetare, bamirëse, ferma e bile edhe kompani që merren me gjelbërimin. Kjo nga Italia, por edhe nga i gjithë rajoni i lagur i Mesdheut. Kudo ku shpërndahet ky lloj fidani, e duan, e duan gjelbërimin e tij. Bota njerëzore nuk po ngopet, megjithse ka bashkëecje të gjatë me të, sa vetë jeta. Po bëhesha pjesë në këtë ecje.

- Më duhet edhe mua një makinë. Puna më kërkon tjetër shpejtësi, - fola një ditë në kafe.

- Mirë ke menduar, - u shpreh Ofelia.

- Si e ku mund ta blej?

Mua më duhet të shkoj një ditë atje ku kam blerë makinën time që t'i bëj disa riparime. Nuk është larg. Shkojmë bashkë e shohim edhe një për ty. Është pikë shitje e makinave italiane që merr përsipër edhe përkujdesjen e riparimet e mëvonshme.

- Dakord. Do t'i them edhe Pedros të na shoqërojë. Ai është inxhinier mekanik e i njej mirë.

Një të shtunë u gjendëm me Ofelinë në pikën e shitjes e të riparimit të makinave. Pas nesh edhe Pedro. Futëm makinën e Ofelisë në kontroll e pritëm ekspertizën.

- Ka nevojë për një riparim që do pak kohë, ndaj do ta mbajmë këtu, pas tri ditësh të vish ta marrësh, - foli përgjegjësi i oficinës dhe tregoi se çfarë nxori kontrolli i saj.

Ofelia i dorëzoi çelsat e makinës riparuesit e dolëm. Në sektorin e shitjes takuam njeriun e duhur e bëmë kërkesën tonë për të blerë një makinë.

- Unë mendoj që kjo është e përshtatshme për ty, - foli i ngarkuari i pikës për një 'FIAT' CHROMA'. Pedro hyri

në makinë, e ndezi, dëgjoji punën e motorit, kontrolloi panelin e bëri disa lëvizje në sheshin e pikës.

- Kontrollo edhe këto tjerat, të gjitha për shitje janë, - ndërhyri prap agjenti i shitjes.

Pedro, por edhe unë, provuam edhe makina të tjera. Mësova edhe çmimet e afruara.

- 'FIAT CHROMA' si makinë dhe me çmimin që ka mendoj se është më e mira për ty. Prandaj të këshilloj që atë të marrësh, - foli Pedro.

Nuk e zgjata. Shkuam në zyrën e agjentit ku bëmë dokumentat e blerjes e me letër kreditin që kisha në portofol, bëra pagesën. Agjenti e nxori makinën deri tek dera, i bëri një mbushje të plotë me karburant e na e dorëzoi.

- Për çdo lloj difekti është mirë të paraqitesh tek ne. E bëjmë me pjesë origjinale, më lirë e me garanci. Zonja, shoqëruesja juaj e ka provuar këtë të mirë, e ke të qartë edhe ti besoj. Kur kishim mbaruar gjithë procedurat e blerjes, u larguam. Pedro u nda nga ne. Unë me Ofelinë u nisëm drejt 'Kastel Blu'. Sapo hymë në autostradë, u përfshimë në lumin e makinave. Ndjehesha mirë, disi i plotësuar. Kisha blerë makinë me punën time e po filloja një jetë të re. Ëndrra po më ndiqte, apo unë po e plotësoja atë. Një farë kërcimi në jetën time. Instinktivisht shkela gazin e ndrrova marrshin. Sikur fluturoja në ajër. Makina punonte shumë mirë.

- Ule shpejtësinë e merr rrugën djathtas. Në majë të kodrës është një lokal. Të kalojmë drekën aty, - propozoi pas pak Ofelia.

Nuk fola asnjë fjalë e me kujdes bëra siç më tha ajo. Në parking ndalua e hymë në lokal. Zumë një tavolinë afër dritares. Ishte ora 14-të. Jashtë ishte vërejtur e pritej të binte shi. Porositëm. Në lokal ishte ngrohtë. Hoqëm rrobat e trasha e u rehatuam.



- Sikur të ishte edhe Pedro, - fola unë.
 - Kush është Pedro, - pyeti prap Ofelia.
 - Shoqëruesi ynë, drejtuesi i parkut afër fabrikës ku punon ti.

- Nuk e njoh. Sot për herë të parë fola me të.
 - Intersant, mendova me vete, por nuk u shpreha.

Erdhi porosia.

- Edhe një shishe verë, - foli Ofelia.

Kamarieri solli verën e ulargua me urimin'oreks të mirë'.

Ofelia ngriti gotën e më uroi:

- Ta gëzofsh makinën!

E ngrita gotën sa laga buzët. Më erdhi në mendje rregullorja e udhëtimit me nene e ligje. Filloi një shi i rrëmbyer. Pas dritares u bë sterrë. Po errej.

- Merr edhe verën time. Unë nuk pi, - fola.

Çuditërisht ajo piu edhe verën time e u bë më e çiltër. Fytyra sikur iu çlirua disi nga ngërçi i përhershëm, sikur i zbukurua. Drita po bënte lojën e vet mbi fytyrën e saj që nuk e kuptoj pse. Vera apo...

- Po Ofelia kush është? - pyeta unë, duke vazhduar një bisedë të lënë në mes para pak kohe që në barin e laboratorit.

Ofelia sikur u gëzua e u zgjua nga pyetja ime. U duk se e priste. Piu edhe pak verë, u rehatua në karrike e filloi: - Kam lindur në periferi të Kozencës në vitin 1958. Kam kryer aty shkollën e mesme e në Napoli u diplomova, në Institutin teknologjik, dega ushqimore. Pas mbarimit të shkollës kam punuar 5 vite teknologe në një fabrikë vaji në Kozenca e kohën tjetër këtu. Një profesor më rekomandoi te konti që pati mirësinë të më pranojë e më dha detyrën e teknologes së fabrikës së vajit. Në vazhdim një profesor tjetër, Luigji që edhe ju e njihni, më ofroi detyrën e përpunimit të të dhënave të fidanave që përgatiten për shitje. Sot punojmë bashkë.

Nga gjithë ky rrëfim i Ofelisë kuptova se ka shumë hije, të pathëna, të fshehta e mbase histori të rrezikshme që mbështjellin personazhin e kësaj historie. Kemi kohë edhe për këto. Mbase më vonë, ose kurrë. Si të dojë ajo. Mund t'i fshehë, t'i dyllosë në mendjen e saj. Gjithë kjo, nëse i pëlqen vetmia si sjellje e gjykim.

- Nisemi?

Paguam e dolëm. Shiu vazhdonte të binte. U nisëm.

- Para nesh, në kodër është kisha e shën Frankos. Sonte është e shtunë e në meshën e mbrëmjes do të lutem aty për shpirtin e një njeriu të dashur, - foli Ofelia,

- Këtu duhet të kthehem?

- Po. Kujdes se rruga ka shumë ujë.

Në sheshin e kishës ndaluam. U futëm brenda. Duke bërë kryq e përkulje sipas ritit zumë vend në stolin e dytë. Kishte edhe disa çifte pleq e tre të vetmuar që luteshin. Prifti zhvillonte predikmin e tij nga altari. E ndiqja duke parë veprimet e Ofelisë. Unë nuk jam krezmuar, nuk kam marrë mësimë katekizmi e nuk di uratët e meshës, vetëm formulën e pagëzimit, mësuar nga gjyshja. Dritë pastë!

Kur mbaroi mesha, ishte vonë. Dolëm në oborr pa folur. Jashtë shiu kishte pushuar. U nisëm drejt qytezës. Trafiku ishte rralluar disi. Ofelia u vendos në ndenjësen mbrapa. Pas pak e pashë të derdhte lot. Nuk ndërhyra. U shtri në sedile duke u marrë me veten. Shihja para. Fashat e dritës ndriçonin sinjalet e rrugës. Diku pashë: 'Kastel Blu' 3 km. Devijova. Vazhdova të drejtoj makinën në qetësi. Ofelia bënte sikur flinte. Kalova portën e madhe të qytezës. Eci përmes sheshit të ndriçuar. Ndaloj në parking. Ofelia gjallërohet me ndaljen e makinës. Jashtë është ftohtë. Pasi dalim në shesh mbyll makinën e shoqëroj Ofelinë. Vazhdon të jetë e tronditur. Nisemi drejt shpisë së saj, afër kishës në katin e dytë. Ofelia nxjerr çelsin e hap derën. Ndezja e dritës



ndriçon pjesën brenda saj. Në korridor ndalojmë. Desha të ndahemi.

- A mund të largohem unë? - fola duke parë Ofelinë në sy.

- Jo. Sonte rri me mua, - foli ajo me një zë lutës e vazhdoi: - Mos më lër vetëm. Kam nevojë për ty këtë natë.

Sakaq më tërhoqi e u futëm në kuzhinë. Ishte freskët. Vumë në përdorim ngrohëset. Pas pak u lehtësuam nga teshat e u ulëm në ndenjëset e buta. Ora e madhe e murit tregonte 10-të e darkës. Ndeza televizorin e ndoqa lajmet: Emigrantë shqiptarë zbresin në Brindizi me gomone si klandestinë. Dy marokenë kapen me drogë. Tri rumune që prostituojnë në Torino kapen nga policia. Lajme që përsëriten, por që shprehin një botë që lëviz. Keq. Po keq e përdreq. Turbullirë. Kështu po vjen jeta. Ec e ndaloje botën të rrotullohet.

Pas pak Ofelia doli nga banjo. Kishte bërë dush e po thante flokët.

- Do lahesh Rubi? - pyeti disi butë.

Në fakt në mëngjes isha larë, por kisha nevojë të pastroj duart e ftyrën. U ngrita. Kur u ktheva, Ofelia kishte nxjerrë mbi tavolinë ushqime e në thekëse kishte vënë disa thela buke. U ula.

- Verë?

- Po, - fola.

Pasi hëngrëm pak ushqim e pimë gjysëm gote verë, e ndjeva veten të lodhur. Doja gjumë. Ofelia pastroi tavolinën e u ul afër meje në ndenjësë.

- Mirë bërë që qëndrove. Sonte jam e tronditur e vetmia do të më mundonte me hijet e saj, do të më terrorizonte. Kjo natë është vazhdim i meshës që ndoqëm. Ndaj të desha këtu.

- Pse? Çfarë të duhem?

Ofelia më shikoi në sy sikur aty të gjente shpëtimin e daljen nga kjo gjendje. Nuk fliste.

- Pse ndodhi sot kjo prishje humori tek ti. Kush është fajtori? Unë? - pyeta.

- Jo. Është histori e gjatë e një kohe disi të largët që shpesh më tndon. Sa mirë që isha me ty se do të kisha vuajtur më shumë. Janë kohëra që përmbysën gjithçka tek unë.

- A mund ta di edhe unë? Përse bëhet fjalë?

- Jo tashti. Do ta mësosh më vonë. Pak nga pak se e kam të vështirë...

Pas pak në dhomën e gjumit m'urdhëroi: - Zhvishu, ja shtrati.

Ashtu veprova.

- Erdha edhe unë, - foli ajo e së bashku u mbështollëm nën një jorgan të butë.

Ishte pjesërisht e zhveshur.

- Sonte nuk jam për më tepër. Kaq dua, të të ndjej ngjitur, - foli e u mbështoll në gjoksin tim. Flejmë, - foli e mori një herë frymë thellë. Pas pak fjeti. Nuk e kuptova pse pas frymëmarrjes në gjoksin tim e zuri gjumi. Si me urdhër. Ç'ndodhi me të? Çfarë siguroi për mushkëritë e saj nga ajo frymëmarrje e thellë? Çfarë arome, locioni apo stabilizanti shpirtëror kërkonte ajo? Vazhdova të mendoj e në dritën e pakët të dhomës shikoja fytyrën e zbehtë të Ofelisë. Enigmatike. E pazbërthyeshme. Çfarë fsheh nën atë perde apo maskë? Kur do të shfaqet siç është në të vërtetë Ofelia? A do të vijë ajo ditë? Si do të ishte kjo shfaqje?

Të nesërmen shkuam bashkë në punë. Gjithë ditën e kalova në serë e arkiv. Nuk e pashë Ofelinë. E dija. Nga puna në laborator më harroi se isha këtu. Apo kështu është ajo? Njeriu i çastit? I pakuptueshëm! I pazbërthyeshëm!



U mora me temën që më ka lënë si detyrë të parë profesori. Shumë materiale duhen sistemuar, përpunuar e dalë me përfundime.

Pas dy ditësh më mori në telefon nga katedra. Mes të tjerave më kërkoi:

- Fillo e përpuno materialin sipas metodikës së UM. Duhet t'ua nisim si ekstrakt edhe katedrave e institucioneve analoge ndonjë reviste shkencore qoftë ajo 'Mediterrano agrikor'. Interesimi për këto përfundime është shumë i madh. Kërkesat për vajin e ullirit kanë arritur majat. Shkenca duhet të vihet në krye të këtij realizimi. Të dalë nga guacka. Qartë besoj?

- Po, profesor.

- Atëherë ku do të jemi ne? Ku do të jesh ti? - pyeti.

-Materiali do shumë punë e zgjat në kohë, - u përgjigja.

- Ashtu është. Askush nuk po të kërkon afate. Mbase duhet një vit apo më tepër. Ndoshta do edhe punë shtesë, shkencore e eksperimentale. E kupton? Studimi duhet të jetë i plotë dhe t'u japë zgjidhje kërkesave e paqartësive që paraqet ky studim i rëndësishëm. Në këtë rrugë nuk do të jesh vetëm. Puno, se ndihma do të të vijë në kohën e duhur.

- Dakord profesor!

VIZITA TE VEÇANTA

1. Me datën 23 dhjetor një telefonatë nga Bari, me një lajm të veçantë vjen tek unë:

- Alo Rubi! - jam Zana. Të marr nga Bari. Po pi kafe me Korinën e të kujtuam ty.

- Përshëndetje! Mirë jeni, - fola pak i çuditur. M'u duk si atentat fjalësh kjo lidhje me ta.

- Mirë ti Zana, po Korina çfarë do? - fola me veten.

- Më 25 dhjetor duam të të bëjmë një vizitë në 'Kastel Blu'. - Na pret?

- Mirë se të vish, por me Korinën i kam mbyllë problemet që në Shqipëri. Ajo me sjelljen e saj ka dalë përfundimisht nga jeta ime. Nuk e kuptoj se çfarë kërkon nga unë. Pse të vije?

- Do të na presësh apo jo?

- Mirë se të vini, - fola e mbylla telefonin.

Vërtetë më 25 dhjetor vajzat erdhën në qytezë. Zana kishte blerë një makinë të mirë e u gëzova me përparimin e saj. Ishte një ditë e ftohtë dhe e vërenjtur. I dhashë dorën përzemërsisht Zanës e majat e gishtave Korinës. Zana ishte shumë mirë, ndërsa Korina ndryshe, me humor të prishur. Siç duket e kuptonte se ishte e humbur në lojën e saj. Nuk desha t'i çoja në shpi. Duke menduar një takim pa tematikë,



mendova t'u jap diçka në barin 'Pëllumbat e Napolit' e t'i përcjell. Por jo. Kishim pirë kafetë kur Zana ndërhyri:

- Korina ka disa kohë që ka ardhë në Itali e nuk po stabilizohet. Ka bërë disa kërkesa e aplikime për punë si violiniste, por nuk i ka buzëqeshur fati.

- Ku jeton? - pyeta si i marrë unë(ç'më duhet mua ku jeton një tradhëtare e shpërdoruese e dashurisë si ajo).

- Ka një të afërme në rrethinat e Barit.

- Pse erdhi sot këtu?

- Të të takojë ty. Nga zjarri e malli i rinisë tuaj diçka duhet të ketë mbetur, mbase hiri, por gjithsesi i juaji është. Ju ngacmon? Kocka mbetet! - foli e qeshi duke parë nga unë.

- Zana nga përvoja jote i nxjerr këto sentimente të djegura? - pyeta.

- Jo, nga dëshira. Ne jemi miq të vjetër, kemi kaluar bashkë rininë e hershme e nuk ka si harrohem apo largohemi kështu.

Vura re Korinën që errësohej vazhdimisht në fytyrën e saj pak të grimuar. Fjalët e mia e vrisnin, e ngacmonin. Ishte në humbjen e shpresës, drejt bjerrjes. E ndjente.

- Kërkoni ndihmë për punë nga unë?

- Jo. Diçka tjetër. Më të afërt.

Ndërkaq bari po mbushej me klientë. Propozova të dilnim. Në shesh i udhëhoqa nga porta verilindore e dolëm në rrugët e pyllit. Ishim më të lirë. Vajzat më futën në mes. Zana ecte e fliste lirshëm, Korina me qafë e fytyrë të mbërthyer pjesërisht me shall nga të ftohtit, vetëm dëgjonte. Si e ngrirë lëvizte krahas nesh. Gojën e mbante mbyllur, bile shtërnguar mes dhëmbëve.

- Si po të ecën puna? - pyeti Zana.

- Mirë, dhashë provimet e mora diplomën. Mbrojta gjuhën italiane e angleze. Tani po punoj në fidanishte nën

kujdesin e drejtimin e UM të Barit e të fermës me një tematikë të caktuar.

- Po nga Shqipëria?

- Jam përpjekur të lidhem me nënën, por jo. Një i afërt në Durrës më sqaroi se linja telefonike me Sektor është prishur. Shpresoj që këtë verë të shkoj e ta shoh. Më ka marrë malli shumë për nënën, të afërmit, vendin e gjithçka që lidhet me mua atje. Korina deshi të fliste diçka, por siç kuptova, nuk pati guxim. Diçka dinte më tepër, por çfarë? Nuk doja të mësoja asgjë prej saj. Ajo nuk u bë pjesë e jetës time, e përbuzi. Nuk më duhen as fjalët e saj.

- Unë mendoj që diçka u ka mbetë pa thënë me Korinën, ndaj ajo është sot këtu. Do të rrijë sonte me ty. Dëgjoje me qetësi.

- Jo Zana!

- Po Rubi. Sot pasdreke unë do të iki. Ti e Kori keni kohë të bisedoni e mbase arrini në një breg, të përparuar disi. Gjithmonë ka një shteg, një fije shprese e nuk shkëputesh përgjithmonë e në gjithçka që të lidh me një femër. Dëgjoje të lutem.

- Ti Zana nuk e di sa e kam dashur unë këtë vajzë. Por nuk e di as sesi u injorova po nga kjo vajzë. Vuri në lojë jetën time sikur unë të isha për të një hijë. Asgjë. E pse? I vinte turp se unë studioja për bujqësi. Donte një aktor apo një kontrabassist që nuk e di as sot saktësisht. E di ti se një nga zhgënjimet e mëdha të rinisë time ishte edhe dashuria ime për këtë vajzë. Ec e kuptoje tash pas 7 vitesh Korinën e ardhjen e saj këtu. Çdo tashti nga unë? Apo ta dijë se me punën në fermë e studimet që po bëj arrita të jem ky që shihni. Shumë më i nderuar, më i vlerësuar se ai me të cilin më ndërroi ajo. Nuk e fsheh. Kam ambicje të madhe.

- Mbase ka diçka për të thënë? - ndërhyri Zana.



- Apo të mohojë atë që më tha në shesh hamshori i saj trupmadh? I di ti Zana deri ku arriti me fytyrjet që më bëri? Si më trajtoi?

- Mos të lutem. Mos i kujto ato fjalë. Kemi pasur shumë të tjera mes nesh që nga ëmbëlsia nuk mund të jenë harruar ende, - theu më në fund heshtjen Korina.

- Korina nuk të fajësoj për zgjedhjen tënde. Ke gjithë të drejtën tënde të giesh lidhjen që do tek njerëz që zgjedh ti, por jo të injorosh ata që të kanë dhënë ty diçka nga shpirti, nga vetja.

Korina dëgjonte. Nuk më ngacmoi më tej. Çfarë fshihej matanë asaj që ajo tha me inat? Siç duket ndjente apo priste një kundërgoditje nga unë. Por jo.

- Kthehemi? - sugjeroi Zana.

Drekën e kaluam në shpinë time. Zana mori detyrën e amvisës. Unë hapa televizorin e shpia u mbush me zëra e tinguj që vinin nga jashtë. Korina heshte. Kishte zënë vend në një ulëse e me sy kontrollonte gjithë shpinë bashkë me veprimet e Zanës.

- Ndonjë fjalë nga Kena? - pyeta.

- Kena e ka ndërprerë stëvitjen. Është me barrë, por ka filluar të përgatitet për provime.

- Shumë mirë! Po ti?

- Edhe unë. Po vazhdoj në kulturën sportive, ndërsa Kena për mësuese.

- Më gëzove me këto lajme. Mario është burrë familjarë e ka qënë fat për shoqen tonë që u lidh me të.

Dreka u zgjat disi. Zana këmbëngulte që Korina të kalonte natën me mua. Nuk e kuptova.

- Do ta pranosh ti një kthim tek ish i fejuari yt durrsak? - e pyeta në një moment Zanën.

- Jo kurrë. Ai më bëri objekt për keq mes të njohurve.

- Gjykimi yt është me dy standarde! Po ta dije ti gjithë lidhjen tonë, do të flisje ndryshe. Nuk ta ka treguar? Ajo nuk ishte thjeshtë ndrrim arome apo buzëqeshje rinore, por më e thellë se kaq. Ndaj më dhemb.

- Mjaft me mua, - shpërtheu prap në fjalë Korina.

- Unë po iki. U uroj që të keni një natë të mirë.

Përcollëm Zanën e mbetëm si të ngrirë në shesh. Si statuja.

- Çfarë të bëj me vajzën? - pyeta veten. Pashë majtas. Banorë të qytezës po hynin në kishë. U kujtova se kishte meshë. Po unë nuk i dija sakramentet.

- Shkojmë në kishë?

- Po, - foli si nën hundë Korina.

Brenda në kishë kishte mjaftueshëm besimtarë. Zume vend në një stol e u përqëndruam tek altari ku prifti vazhdonte të predikonte. Si të tjerët bëra disa herë kryq. Kur erdhi fundi i meshës e prifti komandoi që t'i jipnim dorën e miqësisë njëri-tjetrit, i zgjata timen Korit. Ma zgjati edhe ajo. Ishte një dorë e ftohtë, si pa gjak, dru. Dolëm. Në sheshin para kishës besimtarët po shpërndareshin të qetë drejt shpive të tyre. Po ne? Ku ta çoja atë që më tradhëtoi e më injoroi?

- Shetisim pak?

Ajo nuk foli, por nisi të lëvizte e qetë pas meje.

- Kur ke ardhur në Itali? - e pyeta.

- Rreth një vit më parë, me një kushëririn tim me peshkarexhë.

- Ku ke qëndruar?

- Tek motra e peshkatarit.

- Me se ke jetuar?

- Me pak punë të zezë, por jo të pistë.

- Kështu do të vazhdosh?



- Kam bërë disa aplikime për instrumentiste e po pres. Shpresoj.

- E di që Italia ka violinistë të pafund, vendi i Paganinit e i Stradivarit nuk mendoj se ka vend bosh për një si ti që vetëm në shkollë është rreshtuar në një formacion orkestral? Guxim i madh.

- Mbase gjendet. Kushdo, ku futem edhe unë, ka fatin e vet në këtë botë.

Rruga përfundoi tek dera e shpisë time. Hymë brenda.

- Ende nuk e mora vesh pse erdhe këtu me Zanën? - fola e vazhdova më tej: - Pse qëndrove sonte me mua? Cili shtë misteri i kësaj nate? Çfarë ke sajuar?

Pas pyetjeve ajo heshti. Sillej nëpër shpi duke më parë mua dhe vendin ku jetoja, ushqehesha, punoja e flija. Shkoi edhe në banjo. U lehtësua nga rrobat e rënda e këpucët. U ul në divan.

- Nuk është hera e parë që ne të dy gjendemi vetëm. Disa vite më parë shetisnim bregut të detit, nga Durrësi deri tek kalaja e Skenderbeut në Kepin e Rodonit, verë e dimër. Jemi dashur shumë. Harrove? Në mënyrën tonë nuk lame qejf pa provuar. Deri në marrëzi, - u shpreh ajo.

- I di të gjitha. E kam shijuar shumë atë kohë. Por vetëm aq. Në vazhdim shembe gjithçka si të ishte kështjellë rëre e ndjeva shumë dhimbje. Po ti? - pyeta unë.

- Ndaj erdha të të kërkoj falje për braktisjen e ëndrrës me ty.

- Kaq?

- E pas faljes të mbetemi miq apo diçka më afër. Aq sa ...të duhet ty.

- Jo. Nuk ke falje prej meje. Asnjë milimetër vend nuk ka mbetë për ty. Do të të falja, nëse ti më tradhëtove apo më braktise. Kjo, se pas meje dashurinë, shpirtin e trupin ia dhe një tjetri. Të kam thënë edhe më herët: ishte zgjedhja

jote. Për ty ai tjetri, në konceptin tënd ishte më i mirë se unë e t'i plotësonte dëshirat e ambicjet tej mundësive e cilësive të mia. Qartë?

Vajza shikonte e çuditur edhe e inatosur nga qetësia me të cilën flisja.

- Por unë nuk të fal injorimin që më bërë nëpërmjet atij hamshorit tënd. Më tingëllon ende në vesh fjalori banal e fyes me të cilin ai m'u drejtua mes studentëve para godinës së Institutit të Arteve. Ishte hera e fundit që erdha të të takoj. E di si m'u drejtua? Ja po ta përsëris unë sa për kujtesë. Dëgjoje mirë:

- Po ti çfarë do këtu? Nuk është ky vend për ty. Shko atje ku kundërmon erë plehu, ku balta të mbetet në këpucë e pluhuri nuk të shqitet nga flokët. Ik, o ik nga këtu se na qelbe. E kupton se ka ndarje pozicionesh në këtë botë. Ti je nga ana e kundërt, andej nga llumi. Ky nuk është vendi yt. E kupton se je në vendin e gabuar. Ik se na qelbe. Ik! Këllirë! Fshatar! Në të kundërt të coptova. Kur përfundoi, e shikova me vëmendje. Nuk mendova se më hante, por isha në një ambient krejt kundër meje. I vetëm. E kisha të qartë se ai shprehte fjalët e tua, të njerëzve si ti. -Si duhet të vazhdoj, -mendova? Butësisht u tërhoqa. Kolegët e tu e moshatarët e mi më dëbuan nga mjedisi i tyre. Me bisht ndër shalë. E kupton? I rrahur nga fjalët e sjellja e tyre. Si qen!

Ndërkaq televizioni po jepte lajmet e orës njezet e dy. Transmetohet edhe kronika nga një qytet ku vajza gjysëm të zhveshura shisnin trupin e tyre për llogari të padronëve të tyre. Fatkeqësi. E mes tyre edhe vajza nga vendi im. Dyfish dhimbje.

- Eja të hamë diçka. Edhe në drekë sa i ke parë ushqimet, - fola.



Pas darkës zgjodha të shoh një film. Kuptohet se fjalët më mbaruan. As filmin nuk e çuam deri në fund. Kori kërkoi të flinte.

- Do të flesh në divan, ja çarçafët e bataniet.

Fika televizorin e duke i thënë 'natën e mirë' vajzës, kalova në dhomën e gjumit. Kisha kaluar një ditë të vështirë e të ngarkuar, nervoze.

Kur gjumi po endej në sytë e mi, u hap dera e në dritën e mekët të dhomës së gjumit u shfaq ajo, Korina. Ishte pothuajse e zhveshur e me qetësi u fut në shtratin tim. M'u ngjesh pas trupit si e dinte ajo, e me gjymtyrë më provokoi mes shalëve. U tradhëtova nga pjesët e ndjeshme të trupit tim që më mposhtën. Bëmë seks. Vetëm seks. Në një moment u tërhoqa. Duhet të ruaja veten. Nuk mund të dija se çfarë kishte në mendje një djallinë si Korina. Kur u ngrita, vajza zbuloi barkun e hapi gojën, donte të shkarkoj diku aty produktin e këtij strapacimi fizik. Por jo. Nuk doja ta përdhosja. Shkova në banjo. Ajo erdhi pas meje. Ndeza dritën e pashë Korinën e zhveshur. U zhgënjeva nga një konstatim i hidhur. E njihja mirë trupin e saj e nga hidhërimi nxora fjalët:

- Këto 6-7 vite trupin tënd e paskan deformuar keqas. Nuk të vjen keq. Ishe palcë.

Pashë që Kora i hodhi sytë në trupin tim. Lotët i rrugëtuan në gjithë relievën e fytyrës, mbi cica e ranë në dysheme. Nuk më shqetësonin. Ndjenja për të ishte ngrirë. Dola e shkova në dhomën e gjumit. Fjeta.

- Ku do të çoj? - e pyeta të nesërmen në mëngjes.

- Në Bari.

Kur po futeshim në rrethinat e Barit vajzës i erdhi disi drita në ftyrë.

- Kur e ke ble makinën? - pyeti.

- Nuk ka shumë kohë.

- E drejton mirë.
 - Edhe motorin, kur vendin mbrapa shpesh e rëndoje ti e drejtoja mirë.
 - Po. E kujtoj me mall.
- Diku vajza me zë të mekur kërkoi të ndalonte. Gjeta një vend e ajo zbriti. Më zgjati dorën e u përshëndetëm. Pa u ndaluar askund u nisa drejt ‘Kastel Blu’
- Në darkë më mori në telefon Zana.
- Ku është Kori? - pyeti ajo.
 - Në Bari.
 - Mendova se do të rrinte me ty.
 - Mos e mendo më. Mision i pamundur. As ti mos e vra shpirtin për një vajzë si Kora.
- Zana heshti e si e zënë në faj, uli receptorin.

2. Pas Viti të Ri, papritur shfaqet në fidanishte Kolomba. Kishte ndërruar makinën e mbahej me të madhe. E pashë nga dritarja e arkivit. E takova si ish-shoqe kursi që për disa muaj kishim ndjekur e kryer bashkë praktikat e punën prodhuese në ferma.

- Mirë se erdhe Kolomba! Kënaqësi që ju shoh prap. Me se mund t’ju shërbej?

Ajo u ndriçua disi në fytyrë nga fjalët e mia e pas përshëndetjes foli:

- Më tregoi profesor Luigji se je shkëputur pjesërisht nga rutina prodhuese e fermës e ndjek punën shkencore në fidanishte. Punë e bukur besoj?

- Po, dhe e veçantë për mua, e me disa objektiva ëndërrimtarë që më tërheqin në një labirint ku vullneti e dëshira të ndriçojnë rrugën e zgjedhur. Shpresoj të kap çastin. Mbase suksesin.



- Ndaj kam disa ditë që po mendoj se kur mund të të takoj. Ja erdha.

- Futemi në zyrë apo pimë një kafe?

Në zyrë ajo u habit me dokumentacionin shkencor të arkivit, me programet, konkluzionet e punës shkencore e revistat e ndryshme që ishin skeduar në radhorë të veçantë. Pas kafesë kaluam në fidanishte, në bankën e ruajtjes së materialit biologjik, në studion-laborator të shumimit e më në fund në bazën eksperimentale.

- Ka fitim ferma me gjithë këtë punë shtesë që sipas meje e rëndon prodhimin?

- Në punën time unë udhëhiqem nga detyrat e programuara nga profesori e miratuar nga konti e nuk dua t'ia di për sa thoni ju. Di se të dhënat shkencore të zbatuara në fermë e kanë rritur fitimin e saj në mënyrë të ndjeshme. Kaq besoj se mjafton.

Kolomba dëgjonte me vëmendje duke fikur e nderur cingaret njëra pas tjetrës mes thonjëve të gjatë ngjyrë blu. Në një moment ndërhyri ndryshe:

- Rubin paske fituar shumë nga shkolla, por edhe nga puna. Më tepër se ne të tjerët.

- Mua nuk më shkon në mendje kjo që thoni ju. Nuk e krahasoj veten me të tjerët se më duket mburrje e nuk është e hijëshme. Nuk hyn në cilësitë e mia. Për mua ka rëndësi që pas sqarimit të detyrës ta bëj mirë atë. Kjo nuk tolerohet nga unë. Sakrifikoj edhe nga koha ime. Koha e punës e koha ime shpesh janë të përziera.

- Pak si jashtë formatit të moshatarëve të sotëm?

- E kuptoj hamendësimin tënd. Unë jam lindur e rritur në një familje me kërkesa të kontrollueshme, të vazhdueshme e pa lëshime. Me këtë ngarkesë e nën terrorin e njeriut të braktisur, i caktuar për të punuar në një ekonomi

të largët e të varfër malore ika nga vendi im e erdha këtu, i ndërgjeshëm për zgjidhjen time. Dhe nuk gabova.

- Si është puna e asaj ekonomisë së varfër malore diku në Shqipëri? E kam dëgjuar njëherë, por më është dukur si lojë fjalësh që bëje ti.

Lojë për ty, por për mua ishte vetë ferri.

- Si ferri?

Kur ia tregova çfarë më priste atje, ajo heshti e pas pak foli:

- Ndaj je ngulur në këtë fermë e nuk shikon më tej. Pse je kaq i ngurtë? I mbyllur në vetvete.

- Çdo të thuash me këto fjalë?

- Je vendosur këtu, në këtë hapsirë të kufizuar, e si një murg benediktin gërmon në arkiv, në përvojat e studimet e të tjerëve e pa u kuptuar ke mbetur në këto kodra me këtë gropë në fund. I bllokuar. Çudi! Nuk sheh se çfarë ndodh jashtë prej këtu. Si është ajo bota tjetër?

Kur tha edhe pyetjen e fundit priti reagimin tim, por kur unë heshta ajo foli prap:

- I tillë djalë je ti?

- Sot kam pasaportë italiane, si ti, si i tillë unë nuk jam i penguar që të punoj ku të dua, ku kualifikimi e përfitimi më plotësojnë interesat e qëllimet. Dije se këtu i plotësoj pothuajse më mirë se kudo ata që më nevojiten: studimet shkencore dhe të ardhurat. Aq të nevojshme për një të ri si unë. Kaq mjafton për sot. Më vonë nuk i dihet.

- Po sikur të afroj një detyrë në fermën time, a do të pranoje?

- Me këto mundësi e të mira që trajtohem këtu e shoh të pamundur të kërkoj vend pune tjetër. Kjo edhe nga një mike e mirë si ti.

- Pse kështu?



- Përveç detyrave prodhuese, kryej edhe kërkime shkencore të niveleve të larta, në rang universiteti e akademie. Jam i përfshirë në to e nuk ma do qejfi që me asnjë çmim të mbetem jashtë tyre. Ndjem i vetëdijshëm se këtu, vetëm këtu janë kushtet për të realizuar këtë ëndërr. E ndjej, egzistoj për të. Qartë?

Kolomba heshti. Ndezi cingaren e rradhës e nxori mendimin e saj: -Edhe italisht flet shumë mirë. Nuk dallohesh nga ne.

- Unë flas dhe anglisht. Jam bir i një populli të vogël e kam nevojë të komunikoj me botën e madhe, kjo më ka diktuar nevojën e mësimit të gjuhëve të tjera. E po më shërbejnë. Falë tyre kam arritur deri këtu.

- Mirë. Nëse mundesh a më sqaron së fundi se ku po përqëndrohet sot puna studimore në prodhimin e ullirit.

- Për këtë që kërkoni ju po përgatis një material për revistën 'Mediterrano agrikol' i ngarkuar nga katedra e UM të Barit. Sot kërkimet shkencore në këtë kulturë të rëndësishme janë përqëndruar në sigurimin sa më shumë vaj për një kuintal prodhim kokërr e një hektarë tokë të mbjellë. Këtu fillon studimi. Integrohen shumë kërkesa e kërkohet rezultati. Ai kombinacion që e ka rezultanten më të lartë ka edhe fituesin me vete.

- Qartë, - foli vajza e u ngrit në këmbë. Siç duket do të ikte. Nxori nga çanta një kartëvizitë e ma zgjati:

- Po munde e të mori malli për mua, më njofto. Të pres në fermën time, qoftë dhe për një vizitë, - foli.

U ndamë si miq duke e falenderuar vajzën për vizitën.

3.Instalimi i internetit.

Në zyrën e bazës kisha një kompjuter ku kishte shkruar e arkivuar shumë materiale profesor Luigji. Kur ai iku, më

la porosi që në këtë makinë të vazhdoj të punoj e printoj, duke më lehtësuar shumë dokumentimin e punës time e të pasuroj arkivin. Por më vonë kuptova se kompjuteri ishte për mua një lehtësi shkrimi shumë e mirë, por nuk më mjaftonte. Doja diçka tjetër. Bota ishte shumë më e madhe. Doja të vrapoja drejt saj. Më shpejt. Po si?

- Konti na urdhëroi që të instalojmë rrjetin tonë të internetit, - foli një ditë njëri nga teknikët e ardhur nga kompania.

Ishte për mua një lajm i mirë, një mundësi e re e komunikimit të shpejtë që më gëzoi. Hapa zyrën e krijova të gjitha mundësitë për një operacioni të tillë. Edhe tek zyra e Ofelisë e Pedros u bënë instalimet.

- Ku banoni Rubin? - më pyeti tekniku.

- Në qytezë.

- Doni ta instaloni dhe atje internetin?

- Po. Mendoj të banoj e punoj gjatë këtu.

- Pas tri ditësh do të punojmë atje në shtrirjen e rrjetit për administratën e familjarët. Po munde, kontakto me ne. Kemi porosi edhe nga konti.

- Pa diskutim. Është një mundësi komunikimi e pune që nuk duhet neglizhuar.

Puna në rrjetin e ri u bë si makth për mua, më pushtoi. Adresa, Fb, mesazhet, informacionet, mesanxher, e-mail e shumë e shumë rubrika më pushtuan vëmendjen, kuriozitetin e më nxitën nevojën të eksploroja sa më shumë në hullinë e punëve të mia. Sukses ishte lidhja me profesor Luigjin e me Ninon. Fillova të shkëmbej mendime, t'u dërgoj shqetësime, risi e propozime. Po marr programe e udhëzime, mesazhe e lajmërime. I dërgova profesorit materialin që më ishte kërkuar për tendencat e reja të punës shkencore me ullirin.



Erdhi tek unë në zyrë Ofelia. E nxituar, e ngutur e me një përqëndrim të madh.

- Rubin ti punon me internetin? - pyeti.

- Po. Si instrument e njëhja e si transmetues informacioni po e mësoj.

- Do të më ndihmosh edhe mua?

- Me gjithë qejf.

- Çfarë kërkoni?

- Të hedh të dhënat e laboratorit në formularë e tabela që të kem mundësi t'i përdor në çdo kohë që do të më duhen.

Punova në laborator e brenda një kohe të shkurtër tabelat u ndërtuan në prani të Ofelisë. Të dhënat i hodhëm së bashku. Punë e bukur e me saktësi të madhe.

- Ku e ke mësuar ti?

- Në kolegjin profesional mësova kompjuterin, për internetin, shfrytëzova një udhëzues përdorimi që ma dhanë teknikët. Ja ky është, shfrytëzoje edhe ti.

Pas një muaji mora vlerësimet e profesor Luigjit e katedrës së tij për materialin që kisha nisur. Veças ishin trajtuar materiali teorik, diagramat, grafiqet si dhe konkluzionet. U ndjeva mirë.

Nëpërmjet internetit më vjen urdhëri i parë: Duhet të marrësh deri në fund të marsit farat e ullastrës në stacionin shkencor të Kozencës. Po të nis adresën e kontratën që kemi lidhur para një viti. Printoje e fute në dosje. Planifiko kur të shkosh. Mbaj lidhje me mua e më njofto për gjithçka.

Profesor Luigji.

Kur printoj këtë detyrë të re vjen tek unë Ofelia. E lexon e më shikon në sy.

- Do të ikim bashkë, por me një saktësim: të jemi në Kozenca me 27 mars, - foli prerë.

E shikova në sy. As ata e as fytyra nuk shprehnin pothuajse asgjë për kërkesën e saj. Enigmël! Po ajo fjali si urdhër nga doli? Si u formëzua e tillë kjo datë?

- Pse do të vish me mua e pse me 27 mars të jemi në Kozenca? Ç'është 27 marsi? Çfarë shënon kjo datë për Ofelinë? - ishin pyetjet që më mundonin, por ajo heshte në gjithë qënien e saj. Fytyrëngrirë. Misterioze! Fiksacion gruaje?

- A duhet të jetë më e hapur me mua Ofelia? Nëse po, nga duhet të fillojmë të sqarojmë njëri-tjetrin? Çfarë vështirësish duhet të shkapërcejmë? Nëse jo, si duhet të veprojmë për të sqaruar apo zbërthyer të pathënat e mbyllura te Ofelia?

Gjithsesi, me këto të panjohura, fillova të përgatis dosjen e asaj dite, kur do të nisem drejt Kozencës. Detyrë dhe enigmël!



DREJT JUGUT

Më 25 mars, diku pas dreke, u nisëm. Do të ndiqnim itinerarin e propozuar nga Ofelia: 'Kastel Blu'- Napoli - Kozenca e kthim nga bregu tjetër duke bërë një rreth të shformuar. Ajo pasdreke na dhuroi një kohë të vërenjtur që më vonë u kthye në shi. Unë i jepja makinës. Shiu rëndohej, por makina vazhdonte të çante përmes trupin e gadishullit Apenin. Ecl

- A ndërrojmë vend në timon? - pyeti Ofelia pas tri orë udhëtimiti.

Tek një strehë karburanti ndërruam rolet e vazhduam udhëtimin.

- Ke pasur vizita këto kohë, - më ngacmoi shoqëruesja duke dalë nga qetësia e saj.

U habita. Nuk qenka kaq indiferente sa shfaqej. E kuptova se sido ajo më kontrollonte me indiferencën e saj. Po pse?

- Po nga dy vajza, njëra prej të cilave shqiptare. E njohura ime e rinisë së hershme.

- Mike apo e dashura e atyre kohërave?

- Pse nuk thua shoqe e rinisë?

- Vajzat nuk shpenzojnë kohë për shokët. Me shpirtin e ndezur të aventurës ata kërkojnë vazhdimisht dashurinë si zjarr e ferment të brendshëm. Ua do trupi.

- E vërtetë fjala jote. Vajza shqiptare ka qënë e dashura ime e rinisë së parë e kërkonte rikthimin e kohës rozë tek unë.

- Çfarë kërkonte saktësisht nga ty?

- Ta falja për tradhëtinë që më bëri e mbase t'i krijohej mundësia e një rilidhjeje mes nesh.

- E pranove ofertën e saj?

- Jo.

- Pse?

- Sikur të ishte vetëm tradhëtia në mes, mbase do ta falja, por ishte diçka më e rëndë.

- Si është kjo diçka e rëndë? Si mund ta rëndoje një vajzë të zgjedhurit e saj?

- Ajo nëpëmjet të të dashurit të ri më injoroi, më denigroi deri në limitin që nuk e desha veten.

- Si kështu?

I tregova për fyerjen që ai më bëri para Institutit të Arteve kur shkova ta takoj.

- Si e përjetove ti atë çast?

- U tërhoqa si qen i rrahur dhe nga ajo ditë u mundova ta harroj këtë histori të neveritshme. Ta hedh pas shpine si kujtim të keq.

- Si e kalove atë natë i mbyllur në shpi me ish të dashurën?

- E prita si mikeshë, e dëgjova, por e kundërshtova në çfarë kërkonte prej meje. Lotët e lutjet e saj nuk më mallëngjyen aspak. Nuk ndjeja asnjë grimë dhimbje për të. Respekt si njeri po. Gjithsesi, për aq kohë sa jemi dashur e kemi zbërthyer njëri-tjetrin në të gjithë hapsirat njerëzore. Duhet t'i mohoj?

- Bëre dashuri me të?



- Jo. Seks po. Në fakt e vura të flinte në divan, por ajo erdhi pothuajse dhunshëm në shtratin tim. Donte të më impononte e intrigonte me seksin e saj.

- Dhe të nesëmen iku?

- E çova me makinë deri në rrethinat e Barit. Ia kisha borxh si çdo bashkatdhetari tjetër.- Dhe u ndatë?

- Po, dhe u ktheva në shpinë time siç e quaj tani 'Kastel Blu- Po vajza italiane, kush ishte e çfarë kërkonte nga ti?

- Kolomba është vajza siçiliane që për një vit ka qenë në grup me mua si studente në praktikat profesionale. Njohëm aftësitë praktike dhe rezultatet në provime të njëri tjetrit. Ditën kur u bë ceremonia e mbylljes së vitit akademik, më qëndroi shumë afër. Kaq. Pas një viti e gjysëm rikthehet në fermë, tek unë me porosi të profesor Luigjit. Është pronare e një ferme me ullinj, por ka çfarë të marrë e mësojë nga 'Kastel Blu'.

- Çfarë kërkoi prej teje?

- I fola për fermën, punën prodhuese e shkencore që bëhet aty.

- Ku e gjeti veten e punën në fermën e saj pas asaj që i tregove ti?

- Ndofta këtu duhet gjetur dhe porosia e profesorit që ajo të vijë të më takojë. Në fermën e saj trajtimi i bimës së ullirit, me sa kuptova unë, është në mëshirë të natyrës. Tek ne çdo shërbim ndaj kësaj bime është aq e kontrolluar, e ajo u habit. U habit dhe me numrin e bimëve në njësinë e sipërfaqes e sasinë e vajit që marrim për një bimë, një kuintal prodhim kokërr e njësi prodhimi. Mbeti gojëhapur nga shifrat që i tregova. Më në fund erdhi propozimi konkret e ambicioz i saj:

- Hë! Ta dëgjoj, - shprehu kureshtjen Ofelia.

- A mund të vish e të drejtosh si administrator në fermën time? Do të jemi bashkë, do të të mbështes në të gjithë hapat që do të marrësh në transformimin e saj në një ekonomi në kërkesat e trajtimit modern.

- Dhe ti?

- Më vjen keq, por jam mjaft mirë në 'Kastel Blu', - i thashë prerë

- Pse? - nguli këmbë ajo.

- Nuk e di, por unë vazhdova në linjën time:

- Këtu jam pjesë e një zhvillimi të nisur vite më parë. Konti që është edhe pronari i fermës, i ka hapur dyert me kohë UM të Barit, ka dëgjuar këshillat që i vinin nga atje e pas një kohe pati rezultate të mira e shumë të mira. Ndërtimi i fabrikës së përpunimit të prodhimit e fidanishtja ia kanë shtuar dyfish fitimin.

- Sa të paguan? - vazhdoi të më pyeste Kolomba.

Kur i tregova shumë e parave që marr në vit si dhe shtesat e tjera ajo heshti. Por kur i tregova se këtu më shumë kam varësi pune nga UM se nga administrata e kontit, ajo u habit. E kur i thashë edhe mundësitë që të jem pjesë e studimeve të thelluara në këtë bimë të shejtë, ajo u dorëzua krejt, ngriti duart përpjetë e hodhi dëshirën e fundit: Desha të isha me ty, të të besoj e së bashku të ndërtonim një koloni bimore sipas koncepteve të mia. Nuk qenke fati im. Të uroj gjithë të mirat. Kujtoje Kolombën. U ngrit, më puthi gjatë, derdhi lot e u ndamë.

- Iku edhe Kolomba, po tashti?

- Po shkojmë drejt jugut në rrugën mes shirave të ftohtë të Apenineve.

- Ndalojmë këtu. Është një hotel i vogël, por mjaft i mirë, - foli Ofelia.

Parkuam makinën, morëm çantat e dolëm. Në hollin e hotelit Ofelia më kërkoi kartën time e shkoi tek recepsioni.



Pas pak u kthye me çelsin e një dhome në dorë. Në katin e dytë gjetëm dhomën, hapëm derën e saj e u futëm brenda. Lamë çantat e pas pak zbritëm poshtë. Diçka ndjeja së brendshmi si xhelozë, dëshirë, nevojë apo si vazhdim i natës kur bleva makinën. Edhe atë natë, si sonte binte shi si di Zoti, edhe atë natë erdhëm në dhomë nga një udhëtim i gjatë.

- Po sonte?

Kjo pyetje më lëvizte në trurin tim së bashku me mendimin tjetër: Pse Ofelia shfaq afërsi apo tërheqje fizike me mua, më do peng, apo më kujton si njeri të përdorshëm, të lakueshëm që mund të plotësojë tekat e një gruaje. Zhigolo. Të një harrese apo çfarë ka mbetur nga një grua?

Pas buke u ngjitëm menjëherë në dhomën e hotelit. Jashtë zhaurinte shiu. Isha i lodhur e doja pushim. Ofelia u zhvesh nga një pjesë e rrobave e shkoi në banjo. Unë po prisja ulur në ndenjësën e butë. Kur unë dola prej banjos Ofelia ishte në krevat. Qëndrova para krevatit duke menduar, i mëdyshëzuar.

- Eja. Çpret? - foli nga nënçarçafi.

Ofelia fiku dritën e tavanit e ndezi një tjetër me ndiçim të kufizuar. Sapo hyra në shtrat u mbështoll rreth meje. U puthëm, por buzët e saja ishin disi të ftohta. I gjithë trupi i saj ishte si i mpirë, i davaritur në nxehtësi sikur kërkonte diçka të humbur, të harruar. Veprime disi vetëm instinktive. Jo hormone. Disi përpjekje për të rimarrë veten, për t'u zgjuar. Bëmë seks. Vajza nuk pati orgazëm. Raport i thatë. Habi tjetër e imja. Si kështu?

Të nesërmen në mëngjes ajo u vesh ndryshe. Me pantallona bluxhins, xhokovento e një kapele poshtë së cilës një palë syze dielli të errëta e fshihnin pothuajse krejt identitetin e saj.

- Do t'i biem rrugës periferike të Napolit e do të futemi në autostradën drejt Siçilisë pa u ndalur, - foli si e trembur.

Unë drejtoja makinën e ajo nuk fliste. Shpesh hidhte sytë në disa vende e binte në mendime. Diku derdhi lot. Dukej si e hutuar jashtë këtij realiteti lëvizës. Ishte ora katër pasdite kur si befaz foli: - Dil nga autostrada. Merr rrugën djathtas. Veprova siç më tha Ofelia. Dolëm në një rrugë paralele ku dukej deti Tiren. Këtu ndalo, - foli. Zbritëm. Ishim në sheshin e një hoteli të bukur rrethuar nga pemë e, megjithse ishte mesmars, kishte lule përçark. Drekuam. Zumë një dhomë me pamje nga deti për një natë. Pushuam dy orë. Kur u zgjova pashë Ofelinë që me një buzëqeshje të lehtë më shikonte. Shikimi i saj ishte përqëndruar tek unë sikur donte të më fotografonte, të më fiksonte në sytë e saj si bust, por edhe si i kisha sytë, flokët, vetullat, buzëqeshjen, bile edhe shikimin nën qerpikë. Pse vallë? Çfarë i duhen këto fotografime të portretit tim? Apo çfarë i kujtojnë? Kush jam unë për të. Njeri apo lodër? Hiqe apo... çfarë?

Këto pyetje e hamendësime i mbajta të mbyllura brenda vetes, mbase diku do gjenin përgjigje. Mos qofsha i gabuar!

- Diku, pak kilometra prej këtu është një kishë. Aty ka shërbyer një prift që është mik i hershëm në familjen time. Shpresoj ta takoj, - foli befaz vajza.

Vërtetë pas pak na doli përpara kisha e rrethuar me dafina e selvi. Ndalua makinën në shesh. Para derës së madhe tre burra po bisedonin në gjysëm errësirë, në këmbë.

- Dil nga makina e pyeti se a ndodhet këtu atë Fabricio, - urdhëroi Ofelia.

Pa diskutuar asnjë fjalë, bëra siç më tha ajo. Kur u afrova e bëra mes tyre pyetjen që më diktuan, ata hapën sytë të



çuditur. Njëri prej tyre m'u përgjigj: - Jo mor djalë, atë shkretën e kanë vrarë para 5 vitesh. Nuk e di ti?

U largova në heshtje me një enigmë të madhe, të frikshme e i tulatur. Dëgjova se pas meje erdhi dhe pyetja tjetër: - Nga je o djalë? - por nuk u përgjigja.

Sapo ia dhashë përgjigjen Ofelisë, ajo u mblodh më shumë në vete e më urdhëroi: - Ktheje makinën e rikthehemi në hotel. Shpejt!

Në dhomë Ofelia vazhdoi të rrinte e heshtur, e menduar. Unë nuk i përzihesha.

- Nesër, - foli ajo do të shkojmë tek stacioni i ruajtjes së farërave bimore e pa u ndalur do të vazhdojmë rrugën. Në të dalë të Kozencës është një fshat i bukur. Në varrezat e tij do të ndalemi pak, aty nga dreka.

- Pse detyrimisht në drekë?

- Në këtë kohë aty nuk ka njerëz, pra në një farë fshehtësie.

Përgjigja e Ofelisë e çfarë dëgjova tek kisha, ma shtuan enigmën dhe ndjeva frikë. Dy-tri herë mendova ta pyes se çfarë po bëjmë, çfarë më fshihte, por nuk e prisha indin e thurur nga vajza. Të vazhdojmë. E kam pranuar kështu këtë mision. Edhe me rreziqe.

Të nesërmen në orën njëmbëdhjetë ishim te stacioni shkencor. Ofelia qëndroi në makinë, unë u paraqita në hyrje të tij. Një punonjës shërbimi më ngjiti në katin e dytë të ndërtesës. Takohem me drejtorin e stacionit. Respektohem si specialist fushe dhe i "Kastel Blu". Në dy thasë të etiketuara marr farërat që i sistemoj në garazhin e makinës. Tridhjetë kilogram gjë. U jap dorën të zotërve të stacionit e nisemi. I biem rrugës në veri të Kozencës. Pas disa kilometrash ndalojmë. Djathtas ishte një varrezë e madhe, e rrethuar. Më zuri disi frika, ndjenja njerëzore e vetruajtjes. Pse jo? E dua jetën time.

- Ndalo makinën djathtas portës. Dil prej saj e futu tek porta e vogël, shih nëse ka njeri në varreza. Nëse po, prit deri sa të boshatiset e atëherë eja e më merr.

Ashtu veprova. Vizitova varrezat duke përshkuar me qetësi, kujdes e respekt rruginën mes tyre. Bosh. Asnjë frymë njeriu. Rikthehem tek makina. Ofelia me tufën e luleve në dorë, blerë që në hotel, del nga makina. Veshur me pantallona e xhokovento të zezë, në krye kapelen me strehë e syze, futemi në derën e vogël të zënë për krahu. Lëvizëm në rruginë deri tek një pemë dafine ku shmangemi djathtas. Diku ndalojmë. Lexoj: Varrezat e familjes Guerini, më tej ato Baldini. Ndalojmë para një varri ku shkruhej Enco Franco Baldini, në krye një fotografi fëmije me flokë të gjatë e ftyrë të bukur, poshtë saj gdhendur vitet, 1982-85. Ngjitur me të një varr tjetër Franco Ugo Baldini 1957-1985. E njëjta datë vdekjeje. Mes tyre ndalet Ofelia. Vendosulet në varrin e fëmijës e ulet në gjunj. Derdh lot me psherëtima kryeulur. Kthehet nga varri tjetër. Vendos tufën tjetër, derdh lotët e mbetur e pas pak ngrihet në këmbë. Shkojmë me hap të ngadaltë tek makina. Nisemi.

- Shto shpejtësinë, - foli nga ulësja mbrapa ku po rrinte.

Pas katër orësh udhëtim gati të pafjalë në anën lindore të gadishullit, ndaluam para një hoteli. Zumë dhomë. Pas ngrënies dolëm shetitje. Era e ngrohtë e detit Jon na lëmoi e na dha gjallëri. Frika kishte firuar nga ftyra e Ofelisë. Ishte çliruar prej rrjetit të saj. Dukej më e shkrifëruar. E kuptova sesi më shikoi. Më ëmbël.

- Shetisim pak? - pyeti.

- Po. Lëvizja në makinë na ka mpirë muskujt, bile edhe gjuhën, kanë ngecur fjalët, - fola.

Pashë që Ofelia ndërroi çehre, buzëqeshi lehtë. Më futi krahun e në një rrugë të ngushtë e të ndriçuar buzë detit, shetitëm. Diku ku fillonte kufiri i një kështjelle të vjetër u



kthjem. Prisja të fliste ajo. Të zbërthente enigmën e këtij udhëtimi. Të sqarohesha unë. Por jo. Pse? Çfarë fshihte në këtë lëvizje enigmatike kjo femër. Pse më zgjodhi mua?

- Kisha frikë për vete e ty në këtë mision, - foli më në fund Ofelia.

Këto fjalë më erdhën në vesh si lëngatë që duhej t'i fshihesha, por kaloi e...

- Kush është Ofelia, a mund ta di? - pyeta.

Vajza e ndjeu pyetjen e pas pak u ndal, më shikoi në sy e filloi:

- Unë të kam treguar se kam lindur në rrethinat e Kozencës. Familja ime është siçiliane. Kam një gjysëm-vëllë nga nëna që jeton në Detroit, por me vdekjen e prindërve lidhjet tona janë ndërprerë pothuajse krejt. Pas mbarimit të shkollës u martova me Frankon e linda një djalë, Encon. Me Frankon isha njohur gjatë viteve të shkollës dhe ka qenë mashkulli i vetëm që kam dashur. Ai ishte ekonomist. Në vitin 1985, në një natë të zezë e gjithë ndërtesa e familjes Baldini rrethohet e digjet me gjithë njerëz brenda nga inati i familjes Guerrini. Kjo përplasje thuhet se ishte një larje hesapësh për llogari të trafikimit të armëve me grupet terroriste libiane të tuarekëve. Vetëm unë shpëtova, se atë natë isha në punë, në fabrikën e vajit. Humba edhe djalin, Encon tre vjeç. Të nesërmen prindërit e mi e gjetën të karbonizuar në rrënojat e shpisë. E varrosëm me kufomat e tjera. Vuajta shumë nga kjo humbje. Vrasësit më kërkuan edhe mua, por u fsheha tek prindërit e mi e pas tre muajsh u transferuam fshehtas në Romë. Jetoja e mbyllur në qytetin e madh në një vetmi ekstreme. Asgjë nuk më hynte në sy. Humba interesin për gjithçka. Shkoja e vija në kishë e shoqëruar me prindërit e...kaq ishte frymëmarrja ime. Jetoja me kujtimet e familjes, të burrit e djalit. Vuaja. I shihja në ëndërr e derdhja lot. Të pashtershmët lot më ujësuan e

kënetëzuan sytë e mi. Humba çdo interes për jetën. Shpesh mendja ime punonte për keq. Mohoja jetën, diellin, hënën e çdo gjë mbi tokë. Prindërit m'u gjendën në çdo çast derisa një ditë u shfaq profesor Maksimo Nardi që i kërkoi tim eti që të filloja punë diku larg prej këtu, në fabrikën e vajit të fermës 'Kastel Blu'. Ai kishte qënë profesor në Napoli, më njihte mirë mua dhe punën që bëja, ndaj i propozoi kontit emrin tim me historinë e aftësitë që zotëroja. Në punë ndoqa si fillim programin e profesor Nardit. Më vonë u shfaq profesor Luigji, kapaciteti shkencor i të cilit transformoi gjithë punën në fermë e fabrikë. U bëra kjo që jam, punoj shumë e ruaj vetminë si shoqëruese në këto kohë. Çdo 27 mars, datë kur djali u nda nga jeta e përjetoi shumë keq. Sytë e mi nuk dinë të thahen për asnjë çast. Sa ishin gjallë prindërit, unë shkoja me ta inkonjito në varreza, kam vendosur aty lule e derdhur lot, si sot me ty. Me vdekjen e tyre, ky shërbim u bë pothuajse i pamundur. Ky rast e prania jote më krijuan mundësinë që edhe një herë të kryej detyrimin si e gjallë ndaj tyre.

- Pse më beson mua? - pyeta.

- Që kur të pashë për herë të parë në sheshin e qytezës u trondita me pamjen e sjelljen tënde. Ti paç jetën që të ka dhuruar zoti, por më shkove mallin e Frankos. Më dukesh se jetonte me ty hija e hiri i tij, sjellja e pamja, interesi e qëndrimi ndaj gjithçkaje që të rrethonte. Të pashë në bibliotekë, në markete, në pyllin e kontit, në kishë, në fermë. I vetëm apo i shoqëruar qëndrimi nuk të davaritej, bile as me vajza. Kudo më ngjasoje me Frankon, më hutoje, qetësoje, frymëzoje, gëzoje e fillove të më jepje disi gjallëri. Ishe si një urdhër prej të djegurve, nga nëntoka. Atë natë kur bleme makinën tënde e fjetëm bashkë, kisha mbushur dhjetë vjet pa bërë seks, pa ndjerë erë burri. Isha si e çuditur në ty, ndaj t'u afrova e të mbajta ngjitur. Isha e pazonja për



një shkapërcim vendimi. Trupi im ende nuk kishte dëshirë, ishte mpirë, rrudhosur e nuk reagonte në instinktin femëror pothuajse të fjetur. Natën e dytë, rrugës për në Napoli, në hotelin në Apenine t'u dhashë si munda, me trurin e ndezur, por pa dëshirën trupore të të bërit seks. Nuk pata orgazëm e kuptohet as dashuri, vetëm instinktin e një gruaje që po përgatitesha për dashuri. Sonte shpresoj të të dua me gjithë shqisat e mia. Sikur të isha me Frankon. Grua. E ngrohtë. E lëngëshme.

- Interesante kjo që thua. Unë nuk kam përvojë me femrat, por diçka di:

- Hë? - ndërhyri Ofelia.

- Korina, ish e dashura, po të kalonim tri ditë pa u takuar, sikur merrte flakë. Duhej shuar malli e dëshira medeomos. Më kërkonte e më gjente kudo që isha.

- Kjo tregon se tek mua shoku psikologjik negativ ka vepruar dhunshëm e me një vazhdimsi vrastare që më mpiu, më mrroli e më uli temperaturën e dëshirës për një kohë të gjatë. Humba.

- Po ndryshimi që tani po kërkon të bësh te vetja nga të erdhi?

- Shfaqja jote me këtë lloj dritëzimi sikur më zgjoi ndjenjat e rikthimit në një realitet që e kisha humbur dhunshëm. Isha drejt harresës të qenit grua. Asnjë burrë nuk më ngacmonte në shqisat e mia, nuk më ndizte.

- Intersant!

- Pse thua kështu?

- Po gra me një qasje si puna jote shpesh tjetërsohen, fillojnë e pijnë duhan e alkool, mbushen me tatuazhe, shpesh edhe drogohen, bëjnë jetë të shthurur e të zhytur në qejfe.

- Jo. Ofelia nuk është e tillë.

- Si atëherë?

- Ajo që krijova në ty në fillim ishte një çudi, më vonë një mendim, vazhdoi me një dëshirë që e gjitha u kthye në vendim.

- Çfarë vendimi?

- Me ty të vazhdoj jetën ose pjesërisht atë. Të rizgjohem së brendshmi.

Ndërkaq, disi më të shkrirë, u futëm në mjediset e hotelit. Në recepsion pyetëm a shërbehet në dhomë. Kur morëm përgjigje pozitive, u ngjitëm aty e pritëm. Kur erdhi porosia kishim bërë dush e po ndiqnim drejtpërdrejt një koncert instrumental në television. Dhoma ishte ngrohur mirë.

Ofelia ngriti gotën e verës e disi e gëzuar foli:

- Gëzuar Rubi!

- Gëzuar Ofeli! - iu përgjigja unë e vazhdova: - Kush ta ka vënë këtë emër tragjik?

- Im atë. Ai ishte shekspirian i thekët.

- Po edhe Shekspiri thuhet se këtë emër e ka marrë nga romani 'Arkadia' i autorit italian Sanaxaro. Është figura e një bareshë të bukur e dashuruar marrëzisht.

- Edhe unë marrëzisht e kam dashur Frankon. Kur na lindi djali, sikur e ndamë disi këtë ndjenjë, por gjithsesi, gjithçka mbeti mes nesh.

- Kuptohet se humbja e djalit dhe burrit të ka shkaktuar një traumë të rëndë që ka lënë gjurmë në gjithë atë që e ka emrin Ofeli, nga këmbët deri në majë kreje.

- Gëzuar Rubi! Të falenderoj që u bërë mundësi që pas kaq vitesh të rikthehem disi në jetë. Kur tha këtë fjali, u afrua nga unë e zgjati buzët. U puthëm. Buzët e saj kishin shije, ishin ngrohur e shprehnin disi dritëzimin e fytyrës.

- E kisha harruar shijen e puthjes. Ma ktheve. Dua të ndjej dashurinë...



Kur tavolina ishte shprishur nga thikat, pirujtë e gotat e ishin përloshur nga vera, u ngritëm. Ora po shkonte drej mesnatës. Zhvendosëm tavolinën në një cep e u afruam krevatit të madh. Ofelia hoqi ata pak rroba që kishte veshur dhe u fsheh nën çarçaf. Pas saj dhe unë.

- Sonte dua të bëj dashuri me ty Rubi, - foli e më mbështolli me krahët e saj duke më puthur në buzë, në gjoks e kudo. Iu përgjigja edhe unë. Bëmë dashuri. Ndjeva orgazmën e saj. Ngrohtësinë e lagështinë e trupit të saj.

- Më bëre të ndjehem grua. Më ringjalle dëshirat. Të falenderoj. - foli e ngazëllyer e më shtrëngonte nga vetja.

Çfarë përjetonte vallë vajza? I isha dorëzuar në gjithçka. Kjo natë ishte e saj. Sundonte si Kleopatra. A duhet ta pranoj një lidhje të tillë? Po si?

KTHIM NË SHQIPËRI

I pajisur me pasaportë italiane, me diplomë të UM të Barit, dokument të përhershme pune dhe kartë bankare, bëhem gati të nisem për në vendlindje, pas pesë vitesh larguar. Më priste nëna. Mendimi i parë më shkoi atje, ku shteti im kishte menduar të më çonte e të shprishja vitet e rinisë time, në malet e Macukullit. I dyti në pyetjen: - si mund të kthehesha prej andej tek nëna? Përfytyroja veten, një njeri karikaturë mbathur me opinga, pa asnjë llogari bankare, duke kaluar në rrugë rrëpira, mbi majë karrocërish e vagona treni të shpartalluar, me një çantë shpine ngarkuar ku do kisha rrobat e palara e ndonjë libër ku kisha kaluar orët e mërzisë atje në dhomën time të ftohtë. Njeri pa personalitet, pa perspektivë, pa të tashme e të ardhme. I regjistruar në borderotë me ditëpune të kooperativës e në zborin vjetor të stërvitjes ushtarake, në listën e rogl e në ndonjë marrëzi tjetër. Shpresëhumbur nga larg duke kujtuar me nostalgji dashurinë e vrarë me Korinën, kepin e Rodonit me kisha të harruara e kështjellën e rrënuar. Hiç njeri. Eremit. Si nga bjerrja.

- Do të iki në Shqipëri. Malli për nënën, babanë, vëllanë e të afëmit po më gërryen. Nuk duroj më.

- Shumë mirë po bën, po kur do të niseshe? - pyeti Ofelia.

- Të enjten më 12 korrik, porosita biletën për target.



- Në Bari mbushe makinën me ushqime se nuk i dihet gjendjes atje, -tha e vazhdoi: - Dua të di çfarë trupi ka nëna jote?

- Pothuajse sa ti. Pak më e shndoshë.

- Do të përgatis një pako për të, ti mendo ndonjë gjë për vëllanë.

- Të falemnderit Ofeli! Po më gjendesh.

Në të vërtetë që nga udhëtimi në Kozenca ishim parë rrallë, unë në punë me ngarkesë të madhe e ajo u kthye në stereotipin e saj të mëvetësisë. Ishte ky rast që na ribashkoi. Nuk mund të largohesha nga qyteza pa e lajmëruar. Ajo e priti lajmin si rast kortezie nga ana ime, por edhe si mundësi për të më lehtësuar udhëtimin për te prindërit e mi.

Më 11 korrik, në darkë më merr në telefon Korina: - Alo, Rubi! - kam marrë vesh se nesër do të nisesh për në Shqipëri. A takohemi diku në Bari?

- Dakord! Është një bar në hyrje të portit. Aty takohemi.

Darkën e kalova me Ofelinë. Që nga marsi ishim si të harruar. Ajo rrinte si e hutuar, e fshehur, e padëshirë. Çfarë kishte vallë? Apo çfarë fshihte nga unë? Lëvozhgën e mban ende? Edhe gjumin e bëri pak të trazuar. Ngjishej fort pas meje.

Të nesërmen mora pakon që kishte përgatitur për nënën e u nisa. Në derën e portit më priste Korina. Futa makinën në kontroll, mora dokumentin e udhëtimit dhe e lashë në parkim. Në barin përballë zura vend me Korinën.

- Kur të shkosh në shpì, të lutem asnjë fjalë për mua, - hapi ajo bisedën e para.

- Se çfarë ka ndodhur mes nesh, është histori e mbyllur si këtu dhe atje ku nisi, - foli unë.

- Gjithsesi, duhet t'i vlerësoje lotët e mi.

- Nuk e kupton se ndjeshmëria për ty është zbehur, është shuar pothuajse krejt, besoj e kuptove edhe në shtrat,

bëmë seks e gjithçka që doje ti, por nuk e ndjeve asnjë çast dashurinë time. E hapa derën e shpisë e të prita, por derën e shpirtit e gjete e do ta gjesh mbyllur përgjithmonë. Ti ke dalë nga jeta ime e kthim pas nuk ka. Kërko fatin tënd sa nuk është vonë.

- Nuk do të më urresh?

- Jo. Tek unë nuk egziston njësia morale e urrejtjes njerëzore. Do të të kujtoj me aq sa kemi qenë bashkë. Kaq? Dhe si braktisëse e saj. Si ikanake drejt një aventure tjetër. Pse e vajton rrugën e zgjedhur me dëshirë nga ti? Pendimi yt është i pavlerë, si gjethe vjeshte. Vetëm nostalgji.

- Nuk më mbetet asgjë tjetër, veç të të uroj rrugë të mbarë në Shqipëri, - përfundoi Korina.

Pashë orën. Kishim kaluar si pa u ndjerë mbi tre orë. U habita. Mirë kur ishim të dashuruar minutat e orë iknin shpejt, po tashti? Nuk e di përgjigjen. Inerci? Apo fizika e kujtesës?

Arritja në Durrës më ngriu entuziazmin. Paraqes dokumentat e mia e të makinës në doganë. Habitem me sjelljet e punonjësve të shërbimit, policë e doganierë. Një mik i tim eti, oficer policie në port, bëhet shpëtimtar e më nxori nga thonjtë e tyre e nga një rjepje e mundëshme.

- Keq, o njerëzit e mi! Në pesë vite jeni tjetërsuar, apo shprehni qenien tuaj të vërtetë. Varfëria nuk është turp, por një gjendje që duhet përmirsuar me punë. Kurrsesi kështu. Ndjem i turpëruar nga ju.

Me këtë gjendje shpirtërore dal nga porti, nga Durrësi e çaj rrugën e shkatërruar drejt Vorës. Nga Vora në Sektor është shumë më keq. Dikur nuk më bënte përshtypje se aq kisha parë, por sot ndjej habinë e prapambetjes.

Shoh fshatin e më në fund shpinë ku kam lindur. Ndjej nostalgjinë e jetës time të më turbullojë shpirtin. Është kohë dreke e shumë vapë. Futem në oborrin e shpisë time. Ndaloj



afër derës së jashtme. Shoh kudo pakujdesi njerëzore. Hapet dera e në sheshin e vogël del ajo, nëna. Nëna ime e shtrenjtë habitet me makinën para ahkallëve prej çimentoje të shpisë. Dal nga makina e ajo çuditet edhe më shumë. Fërkon sytë e sqaron më shumë pamjen. Si mëmëzonjat fisnike të Arbërisë.

- Rubin, djali i nënës, erdhe më në fund të më shohësh, - foli e një lumë lotësh rrëshqitën në faqet e saj. Kishte filluar të plakët nëna, mbase edhe ikja ime ia kishte shtuar rrudhat. Ulemi në shkallë të përqaftuar. Lot, fjalë e dashuri nëne përzihen bashkë. Pas rënies së valës së parë të kësaj emfaze nënë-djalë, futemi brenda në shpi. Dhe mjedisi aty ishte ai i para pesë vitesh. Disi më i përkeqësuar. U vendosëm në ulëse.

- Ku ishte këto pesë vite, o bir? Ku humbe? S'na dërgove një lajm a letër? Po një telefonatë? Iku gjithë bota, por nojftonin. Mua të shkretës më mbetën lotët në sy.

- Në Itali. I ngarkuar vazhdimisht me punë e qëllime. Ju kam kërkuar disa herë në telefon, por në Vorë më thoshin se linja për në Sektor është prishur, vjedhur me shtylla e tela.

- Ashtu ndodhi vërtetë. Brenda një nate të mallkuarit e zhduken, - foli ajo e vazhdoi:

- Si të shkon jeta?

- Mbarova shkollën e lënë pa përfunduar këtu.

- Ku punon?

- Në një fermë ku kultivohet ulliri.

- Si të trajtojnë aty?

- Shumë mirë.

- Si shumë mirë?

- Punoj e paguhem shumë mirë për punën që bëj. Kam shpi, llogari bankare, makinën time e pasaportë italiane që hap portat e çdo shteti.

- I kënaqur je?
- Shumë! Mendo për një çast sikur të kisha shkuar atje, larg në Macukull si do të isha. Një gjysëm njeri me një punë rutinë e një rrogë që nuk do të më mjaftonte të mbaja veten.
- Thuhet se ike edhe nga inati i prishjes me Korinën?
- Vërtetë isha i mbushur me inat edhe për këtë akt të saj. Atëherë ajo nuk mendoj se unë, një specialist i përbuzur bujqësie, fshatar me çizme që do të grisja ditët e netët mes baltrave e shirave, duke bindur e drejtuar fshatarët erëklirë në punët e tyre bujqësore, të isha përkrah saj. Donte diçka tjetër.
- Po aty ku je, si e çfarë bën?
- Merrem me punë krijuese siç bën arkitekti, violinisti, shkrimtari, inxhinieri apo skulptori e gëzoj të mirat e saj. Bile trajtohem edhe më mirë se disa prej tyre. Për të ndërruar disi drejtimin e pyetjeve fola:
- Po ti nënë si je?
- Ja e vetme këtu në shpi, hap e mbyll ditën.
- Po im atë?
- Jemi divorcuar. Ai jeton në Tiranë me një grua tjetër.
- Po im vëlla, Maksi?
- Edhe ai jeton në Tiranë. Është martuar, kanë blerë një hapësirë ndërtimi e kanë hapur një farmaci diku afër stadiumit 'Dinamo'.
- Ti me se jeton?
- Pas mbylljes së ndërmarrjes, kam një asistencë sociale e me çfarë nxjerr nga puna rreth shpisë. Më han vetmia, por si t'ia bëj?
- U ngrita në këmbë, e mora për dore e dolëm në tremen e shpisë, para makinës time.
- Ta shkarkojmë, - folat e zbrita mbrapa saj, tek bagazhi.



E hapa. Mora me rrallë pakot me ushqime, bidonat me vaj ulliri, verë e lëngje frutash. Në fund edhe pakon dedikuar nënës me veshmbatje nga Ofelia. U futëm me to në shpi.

- Ç'ke bërë kështu, o bir?

- Vjen Maksi ndonjëherë këtu?

- Po, shpesh. Ka grua të mirë. Ndonëse prindërit e saj u riatdhesuan në Izrael, ajo nuk iku. Presin edhe një fëmijë. Më kanë kërkuar disa herë të shkoj të banoj me ta.

- Por ti nuk pranon?

- Ashtu është.

- Po sikur të vish tek unë, në Itali?

- Jo.

- Po sikur të të blej një apartament në një pallat afër Maksit në Tiranë?

Po të ishte për në Tiranë, rri me Maksin, por nuk dua të largohem nga Sektori. Këtu kam lindur e u bëra nënë. Ju linda e ju rrita ju. Kam shumë kujtime që më mbajnë gjallë.

Pasi kontrollova shpinë me mallin e fëmijërisë e rinisë, me dhimbje pashë se ajo po ronitej, po humbte tërësisht funksionin. Mora menjëherë një vendim të beftë:

- Po sikur të rindërtoj këtë shpi, ta rikonstruktoj e të shtoj katin e dytë? - pyeta nënën.

Ajo u habit nga propozimi im e foli:

- Kushton shumë se... mirë do të ishte. Këtu është vend i mirë për jetesë.

Pashë se kur nëna tha këto fjalë fytyra e sytë i morën dritë. E donte këtë vend. Kjo shpi duhet ribërë nga e para. Po si e kush?

- Do t'na bësh drekën nënë?

- U hutova në fjalë të pafund e harrova se djali është lodhur nga rruga e gjatë, - foli.

- Çfarë do të më japësh?

- Sallatë me domate, kos e vezë.

- Vaj ulliri kam sjellë unë. Më lejo të bëj unë makaronat. Kam sjellë dhe një furnelë me gaz.

Pas drekës pushuam pak. Në darkë erdhën edhe kushërinjtë e u kënaqëm. Erdhi edhe Edi. Ai punonte inxhinier ndërtimi.

Të nesërmen bisedoj me Edin e nënën: - Dua ta rindërtoj këtë shpi, rikonstruksion të katit të parë dhe shtesë katin e dytë. Të projektohet i gjithë rrjeti elektrik, hidraulik, telefonik, internetit, të klimës e ndriçimit. Dua të bëj një shpi pushimi për të qënë. Rrethuar me një mur dy metra të lartë e sipër tij një shtesë me rrjetë teli. Porta e madhe me qiellzanë mbuluar me tjegulla duhet ndërtuar me gur të gdhendur.

- E bën ti projektin me të gjitha këto hollësi?

- Po, - u përgjigj Edi.

- Ku duhet miratuar e marrë leja e ndërtimit?

- Këtu në komunë.

- Shumë mirë! Sapo të miratohet projekti të fillosh nga puna me avllinë, pastaj me objektin.

- Dakord! Para se të largohesh për në Itali të bëjmë bashkë një konsultë projekti, në këto kushte nuk është problem miratimi i tij. Kam gati një skuadër ndërtimi që u hanë duart për punë, - sqaroi Edi.

- Nesër do të shkoj me nënën në Tiranë, të takoj Maksin e babin, t'i shoh e të zgjidh ndonjë problem ligjor me të e pas një jave do të jem prap këtu e flasim. Ti puno. Kur të jesh gati mund të fillosh nga puna. Të gjitha llogaritë i ke me mua e nënën. Mos ngurro, se për çfarë të thashë i kam paratë. Nëna dëgjonte e tek ajo pashë një gëzim të brendshëm. Krenohej me mua.

Ditën e tretë me nënën u nisëm për në Tiranë. Nëna kishte ndryshuar, veshur me rroba të mira, sandale të bukura, një çantë të shtrenjtë, orë e vëthë të veçantë, një



palë syze dielli fotokromatike i mbulonin sytë. U gëzova me pamjen e saj. Ishte zbukuruar.

Rruga Vorë-Tiranë ishte rregulluar. Tek stadium 'Dinamo' ndaluan në një parking e zbritëm. Diku afër ishte farmacia. Maksi me të shoqen ishin aty, po punonin. U habitën me shfaqjen tonë të beftë. Maksi m'u hodh në qafë me shumë mall. Nëna puthi në faqe Ueldën. Në një cep të dyqanit kishte një kënd ndenjeje, ku edhe u ulëm. Aty u shërbyen edhe kafet e mirëseardhjes. Uelda ishte vajzë e bukur. U gëzova për rregullimin e jetës së vëllait tim.

- Kur paske ardhur vëlla?

- Kam tri ditë.

- E qetësove mamin besoj?

Nga ku ishte, nëna zgjatí e mbështeti kryet në supin tim e heshti. Ndjente gëzim mes nesh.

- E shoh se paska ndryshuar pamjen. Siç duket djali e ka kujtuar veçmas.

- Edhe ty nuk të ka harruar, - foli nëna e nga çanta nxori dy ora e një rrobë për nusen.

- Të falemnderit Rubi! - foli Maksi. Uelda qeshi e siç kuptova, ajo u gëzua me praninë time si vëllai i burrit të saj.

- Dyqanin e kemi blerë me kredi, ndërsa shpinë e kemi me qera. Shpresoj që në fund të këtij viti të shlyejmë kredinë e pastaj të mendojmë për një shpi tonën këtu rrotull. Shërbimi farmaceutik është sot një biznes i suksesshëm. Kam dhënë edhe unë disa provime e shpresoj që vitin tjetër të marr diplomën e lejen e ushtrimit të profesionit të farmacistit.

- E braktise detyrën e mësuesit?

- Punë e bukur, por e thatë dhe çdo ditë po humbet motivet. Shteti nuk e vlerëson arsimin.

Drekën e kaluam në shpinë e Maksit, ndërsa darkën në një lokal jashtë qytetit. Shkuam me makinën time. Ua kisha borxh një mbrëmje të këndëshme. Nëna u gëzua shumë. Edhe Uelda. Gjeta rast e bisedova për shpinë në Sektor me Maksin. I tregova për bisedën me nënën e projektin me inxhinier Edin.

- Unë sot financiarisht jam ngusht, por më vonë...

- Këtë pjesë e marr unë përsipër, ti të kesh kujdesin e informacionin e vazhdueshëm nga Tirana për ecurinë e problemet që do të dalin gjatë zbatimit të projektit që po bëhet.

- Dakord!

- Do të bisedoj nesër me babin, - fola në një çast kur mbetëm vetëm.

- Pse? - pyeti Maksi.

- Ai është si ne bashkëpronar i shpisë e truallit. Nuk dua ngatërresa.

- Mos u merr me të. Qëkur u divorcua me nënën...

- E ka ndërtuar një jetë të re. E drejtë e zgjedhje e tij. Unë e ti duhet ta respektojmë për sa ka bërë për ne. Na kanë rritur e me nënën kanë qënë kërkues e kujdestarë të mirë ndaj nesh. Ai është interesuar që ne të marrim arsimin e lartë. Për këtë duhet t'i jemi mirënjohës, - fola unë.

- Unë nuk e takoj.

- E di se ku punon?

- Po. Ka një dyqan e shet farëra e pesticide bujqësore në kombinat. Deri aty të çoj unë. Nëna nuk duhet ta marrë vesh.

- Po ajo e ka të qartë se ai është ati ynë. Nuk e shmagem dot. Është pjesë e jetës tonë.

- Por na braktisi.

- E di me cilën është lidhur?



- Po. Me një grua për të cilën dikur është dënuar, e kanë përjashtuar nga partia e ulur në detyrë.

- Pra ka qënë e dashura e tij.

- Merre si të duash.

Të nesërmen ora nëntë ishim në lagjen e kombinatit. Një qoshe magazine ishte sistemuar ndryshe e kishte marrë pamjen e një dyqani që në paranikë kishte thasë e dy banaqe që mbroheshin nga rrezet e diellit nga një çadër e madhe. Në një karrige rrinte ai, babai ynë e priste blerësit.

- Ndalo të zbres, - foli Maksi diku larg e vazhdoi: - unë kthehem me autobus.

- Mirë! Takohemi tek farmacia.

Maksi doli, ndërsa unë u afrova tek dyqani. Ndalova. Hapa makinën e u shfaqta përballë tij.

- Babi, mundem të takohemi? - fola.

- Ai hapi sytë e foli: - Mirë se erdhe, o bir!

- Mirë se të gjeta! - fola e i zgjata dorën.

Ai më tërhoqi në gjoksin e tij e më përqafoi me mall. Bashkë me aromën atërore ndjeva edhe dashurinë e tij.

- Kur ke ardhur?

- Para tri ditësh.

- Si ke qenë?

- Mirë.

- Me se je marrë atje ku shkove?

Kur i tregova gjithë çfarë kisha bërë nga 2 korriku 1990 e deri tani, ai u zgjerua disi. U ndje mirë e foli: - Të lumtël! Jam krenar për sukseset tuaja. Je djalë i guximshëm. Më tejkalove me guximin tënd.

Unë heshta e në pak sekonda rikujtova gjithçka kishte ndodhur nga ajo ditë e ambasadave. Isha plotësisht i sinqertë me tim atë. Prita reagimin e tij.

- E takove Maksin?

- Po. Edhe nënën. Ti je i treti për nga radha, por jo nga rëndësia. Je ati ynë e erdha jo vetëm të të takoj, por edhe të bisedoj.

- Si ishte jot'ëmë?

- Dua të rikonstruktoj shpinë e vjetër në Sektor, - fola e në vazhdim i tregova gjithë projektin tim për atë vend e bisedën me inxhinier Edin.

- Nga ti dua dakordësinë e një deklarate noteriale që gjithë atë vend ua dhuron fëmijëve e ish bashkëshortes tënde, nënës time.

- Të falenderoj, o bir! Më hoqe nga shpirti një peshë që më rëndonte: Vetminë e nënës tuaj e ndjej së brendshmi. Më vjen mirë që po i rrini pranë, - foli ai.

I zgjata një pako të vogël. Si për tim atë. U gëzua. U hap.

- Të falemnderit për kujtesën!

- Do të pijmë bashkë një kafe?

- Me gjithë qejf, - foli im atë e nga karriga ku ishte ulur, u ngrit e u fut në brendësi të dyqanit. Pas pak doli disi më i veshur e me këpucë në këmbë. Kishte pak bark të kërcyer.

- Shkojmë me makinë?

- Po, - foli ai e i hapa derën.

Kur u rehatua në makinë e u nisëm, pyeti prap:

- E jotja kjo makinë?

- Po.

- Mua më mbeti motoçikleta.

Qesha e njëherësh kujtova veten sa krenarë ndjehesha dikur me atë zhurmëmadh kur ecja si era.

Diku më poshtë ishte një lokal i ri.

- Çdo të pish?

Ai mori një kafe e konjak e unë një kakao.

- Maksi është rregulluar. Ka një grua të mirë. Nuk ia kam merakun. Sa për çfarë kërkove ti, deklaratën e pasurisë



do ta përpiloj dhe firmos tek një notere. Pas një muaji të vijë e ta marrë Maksi.

- Kur do të ikish?

- Më 18 gusht. Më presin shumë punë atje.

- Të ç'natyre janë?

- Studime e përpunim të të dhënave fushore e laboratorike si dhe praktika në bazë.

- Si praktika?

- Në bazën ku punoj unë, përgatiten e çertifkohen tre milion fidana ulliri të cilësisë së parë në vit që shpërndahen për t'u mbjellë në të gjitha vendet e Mesdheut.

- Sa e madhe është ferma?

- Ka një sipërfaqe prej pesëqind hektarë ku kultivohen 75 000 rrënjë ullinj në moshë e teknika të ndryshme, por ka edhe një fabrikë moderne të përpunimit të prodhimit dhe një fidanishte ku përdoren metodat më të përparuara të prodhimit të fidanave. Me ciklin e mbyllur që zbatohet, ferma ka rritur shumë efektivitetin e punës e është bërë një model i përparuar i zhvillimit bujqësor në të gjithë Mesdheun.

- Dhe ti je pjesë e stafit të saj?

- Po.

- E trajtohesh si ata.

- Po, pa dallim. Edhe zyrtarisht jam si ata.

- Po shkolla?

I tregova për ikjen, shkollën e vështirësitë që më nxori administrata e Institutit, pastaj provimet e fillimi i punës në bazën shkencore të fermës ku zbatohet porositë e detyrat që më vijnë nga UM i Barit.

- Si paguhesh?

Kur i tregova shumë e pagesës vjetore, ai u habit. Heshti. Mendohet.

- Si e more vendimin e ikjes? - pyeti, me sa kuptova unë më tepër nga kurioziteti si prind.

- Kur mora emrimin në Macukull të Matit, u bëra bishë nga inati. Kujtova fatin e Maksit në malësinë e Krujës. Një revoltë e brendshme zhvillohej në heshtje tek unë në kërkim të një zgjidhjeje tjetër, ndryshe. Dhe erdhi 2 korriku. Si nga qielli. Fat apo... Shkapërceva derën e ambasadës, si ylberin. Ndërrova si njeri. U tjetërsova. Ika. E sot ja ku jam.

- Më bëre të ndjehem krenar, o bir! - foli e u ngrit në këmbë.

U ndamë para dyqanit të tij. Ai zbriti e unë u nisa. Në pasqyrën e makinës e pashë që për disa minuta nuk lëvizte nga vendi. Shikonte makinën ku unë brenda saj po largohesha. Mall babai i ngrirë. Bust.

Në darkë vonë me nënën, vëllanë e të shoqen dolëm rrugëve të Tiranës: Zogu i Zi, pallati i sportit 'Partizani', stacioni i trenit, spitalet, kinostudio, qyteti studenti, liceu artistik, radio-televizioni shqiptar, galeria e arteve, teatri popullor, pallati i madh i kulturës, kinema 'Partizani', sheshi 'Skenderbe' e në fund godina qendrore e Universitetit të Tiranës. Kur kaluam para ndërtesës të Institutit të Lartë të Arteve, heshtën njerëzit e mi. I kuptova. Ishte një mall i madh. Zhgënjim. Tek stadiumi 'Dinamo' parkuam makinën. Ora ishte dy pas mesnate. Tirana kishte filluar ta prishte gjumin e natës. Arritëm në shpinë ku flinte Maksi.

- Nesër do të nisem për në Sektor. Kam konsultë me Edin për projektin e shpisë dhe duhet të bëj disa ditë plazh me nënën. E ke harruar kur në fëmijëri na merrte përdore e na çonte në bregdet? Po munde eja disa ditë dhe ti me Ueldën.

- Unë nuk vij dot se kam punë, por edhe Uelda ka disa shqetësime shëndetsore. Më vjen mirë për nënën që po e



gëzon. Kur të arrish në Itali më merr menjëherë në telefon,
- foli Maksi.

Rrugës për në Sektor po mendoja me vete: Si jemi ndarë kështu? Nëna në vendlindje, unë në Itali, im atë në një lagje të kombinatit ku ka formuar një jetë të re e nuk komunikon me pjesën tjetër të familjes e në fund Maksi me Ueldën që presin një fëmijë. Katër. Seicili në mënyrën e tij do vendin ku ka zgjedhur të jetojë.

Për një ditë e gjysëm me Edin folëm e morëm nëpër duar gjithë projektin e avllisë me portën e ramë dakord. Për shpinë përcaktuam ngjyrat, dyert e dritaret, xhamat dyfish, oxhakun në dhomën e ndënjes e transformimin e banjos, por edhe tremen para derës së jashtme të shpisë. Folëm edhe për materialet, disa prej tyre i mora përsipër unë t'i sillja nga Italia.

- Mund të filloj nga ndërtimi i avllisë pa ikur ti, - foli Edi.

- Kujdes portën, bëje me gurë hijerëndë e të gdhendur bukur.

Me nënën për disa ditë shkuam në plazh. Morëm rreze dielli, u lamë në det e drekën e kalonim në lokalet portative që kishin filluar të ngriheshin si infrastrukturë e ardhshme e bregdetit.

Më dhjetë gusht Edi me skuadrën e tij filloi punën me avllinë. Sipas piketave nisi sistemimi e hapja e kanalit me traktor. Makinat sillnin gurët, blloqet e betonit, rërën e gëlqeren. Të nesërmen filloi puna. Me nënën i gëzoheshim kësaj fillese të re. Më 18 gusht, para se të nisesh, u gëzova me metrat e para të murit, pjesë e avllisë së ardhëshme.

Nëna më përcolli deri tek makina, u përqaftuam dhe u nisa. Më priste puna, atje larg në fermën 'Kastel Blu'. Jepi Rubi! - i fola vetes.

NË QYTEZË E BAZË

Më 19 gusht isha në qytezë. Dua vërtetë më shumë vendin ku isha e lashë të dashurit, por edhe këtu ndjehem mjaft mirë. Ec e ndaje këtë ndjesi tek unë. Isha i dyzuar. Shumë pyetje i bëra vetes gjatë rrugës, por përgjigje për së mbari nuk gjeta. Merru me veten, thashë. Ke shumë për të bërë për dashurinë dhe punën.

Në shpi arrita i lodhur. Pas një dushi rashë e fjeta. U ngrita në orën 20 nga gjumi.

- Alo Ofeli, - jam Rubini.

- Kur arrite?

- Sot në drekë.

- Si e kalove në Shqipëri?

- Shumë mirë! I takove të gjithë. Prindërit dhe vëllanë.

Veças me nënën bëra 17 ditë plazh. U gëzuam ajo dhe unë. Kishte gjashtë vite pa vajtur në bregdet.

- Unë kam më shumë, - ndërhyri Ofelia.

- Pse ma bën këtë paralelizëm? - pyeta.

- Nesër është e dielë, kam pushim e a mund të më shoqërosh mua në bregdet. Të bëj edhe unë një ditë plazh, - më kërkoi me një fare lutje.

- Pse jo. I lirë jam. Nisemi në orën gjashtë drejt bregdetit?

- Dakord! Më prit aty apo shkojmë me makinën time.

- Merr tënden se e imja e ka kondicionerin me difekt.



- Natën e mirë!

Kur Ofelia uli receptorin unë veshja sandalet e dola në shesh. Takova Roberton dhe shetita me të. I tregova për vajtjen në Shqipëri e projektin e shpisë time atje.

- Rreth shpisë kam edhe një sipërfaqe prej 2200 metrash katrorë. Dua që ta gjelbëroj atë vend me një projekt të mirë me pemë frutore, bimë zbukuresë, me rrugina e pika pushimi me hije. Të bëhet një kopësht ku gjelbërimi të mbulojë tokën. Nga kjo sipërfaqe do të përjashtohen 500 metra katrorë mbrapa shpie që nëna kërkon të jetë kopësht perimesh me një serë të vogël, ku të ketë mundësi që të shkruftohet.

- Si është vendosja e shpisë në këtë sipërfaqe? - pyeti Roberto.

Kur ia shpjegova vendosjen e shpisë, avllinë, portën e madhe e garazhin e ardhshëm, ai foli:

- Kur mund të përfundojë së ndërtuari shpia?

- Në pranverë.

- E sipas të dhënave që mora do të bëj një projekt të mirë, zbatimi i të cilit do pak kohë e shpenzime. Kuptohet pas ndërtimit të shpisë.

- Të falemnderit inxhinier!

Të nesërmen në orën gjashtë u nisa drejt bregdetit si shoqërues i Ofelisë. Në një plazh të vogël ndaluam. Parkuam makinën në një hije e u drejtuam tek lokali. Porositëm një çadër e dy shezllonga, morëm numrin e dolëm. U zhveshëm nën çadër. Rrezet e mëngjesit na përkëdhelnin lëkurën.

- Ti je krejt e bardhë Ofeli, kujdes se të djeg dielli, - dhashë këshillën time.

- Kam marrë një tubet me krem plazhi. A më ndihmon të lyhem?

Duke e lyer ndjeva se lëkura e trupit të Ofelisë ishte e butë si mëndafsh. E donte përkëdheljen time. Pra tek unë ndjente një dorë të butë, të dashur e të pëlqyer për një grua.

- Pse në qytezë Ofelinë e cilësojnë si të pa afrueshme, të ftohtë e që nuk i jep shoqëri askujt? Në kishë, shitore e në punë gjithmonë e vetme e me një shikim të dyshimtë, të tretur. Pse kjo sjellje e veçantë?

Kur ia thashë gjitha këto që kisha dëgjuar për të, ajo pa u menduar fare m'u drejtua:

- Njerëzia më dukej sikur padrejtësisht e në heshtje më shpalli luftë, më vrau djalin, burrin e çfaroi gjithë familjen Bandini e deshi të më vriste edhe mua. Ndaj iu fsheha, e harrova, e braktisa në gjithçka të mirë e të keqe që kishte.

- Thonë që konti e profesori janë të vetmit që i ke begenisë.

- Je edhe ti, që kur të pashë për herë të parë e arsytet t'i kam treguar. Nuk u nisa nga kombësia jote se nuk e dija, por nga disa shenja të jashtme që të shembëllenin me Frankon, ish burrin tim të vvarë. Por më vonë, kur mora vesh se je shqiptar, interesimi për ty u rrit dyfish. Më erdhën në mëndje thëniet e tim eti për një mësues arbëresh në Katanaxaro.

- Çfarë kujton nga ata thënie?

- Thonte se ata kishin ardhur nga Arbëria pas pushtimit nga perandoria turke. Ishin pjesë e familjeve të mëdha që si kudo në Europë kishin një zhvillim të brendshëm shumë të lavdërueshëm. Mbaj mend që veçonte, se në kodin e tyre kishin zënë vend respekti ndaj gruas e fëmijëve. Jo si këtu, por në një mënyrë shumë të veçantë: Gruaja nuk të fut në gjak, por as nuk lan gjak, që donte të thoshte se mbrojtja fizike e saj ishte e siguar, sublime, po kështu edhe fëmija mashkull deri sa të bëhet për pushkë, pra të



rritej. Jo si tek ne, shoqëri e sëmurë, budallaqe që vret gratë. Edhe fëmijët. Bëhet kjo çmenduri? Pse ndodh kjo në vendin tim?

- Sot kur kanë kaluar 10 vite nga ajo histori e dhimbshme në Kozenca, unë prap nuk mund të afrohem aty se ende e ndjej ftohtësinë e ashpërsinë ndaj ne të dobtëve. Pse kështu? Në vend që të mbrohem, sulmohem. Kulturë kjo?

- Futemi në det, - propozova.

Uji ishte i ngrohtë, i pastër, pa dallgë. Të ftonte për të notuar. Një not i lehtë si përkëdhelje më erdhi si dëshirë. Fillova të lëviz. Vazhdova pa u ndalur. Diku nxora kryet nga uji. Ofelia vinte paralel me mua. Notonte si sirenë, mirë e pa u sforcurar sikur rrëshqiste mbi ujë. Vazhduam të notonim. Dikur u kthyem. Poshtë nesh uji ishte blu. Kuptohej se ishte thellë. Pashë bregun, shumë njerëz aty e në ujë, por jo thellë si ne. Ndalua. Luajtëm me ujin.

- Dalim?

Kur arritëm në breg, unë lëkurënxirë e Ofelia e bardhë, bënim shumë përshtypje.

- Po na shohin me çudi.

- Kanë të drejtë. Ti je lëkurënxirë, ndërsa unë qumësht.

Ndërsa ajo fliste, unë vërej se Ofelia kishte shtuar në peshë, barku i ishte fryrë, fytyra i kishte marrë një pamje tjetër, më e zbardhur, më e zgjeruar. Gjoksi i ishte smadhuar.

- Ku qënke nxirë ti Rubin?

- Të tregova se bëra njëzet ditë plazh në Shqipëri. Me nënën. E kisha detyrë, por dhe dëshirë që ajo të ndjente për pak kohë rehatinë e gëzimin e pranisë time aty. Ishte pushimi që na kishte munguar. Atje e kuptova se ajo jetonte e vetme. U shqetësova për të.

- Pse?

Kur i tregova se çfarë kishte ndodhur në familje gjatë mungesës time ajo tha:



- Diçka që tek ne ndodh shpesh.
- E do t'i rregulloj shpinë që ta ndjejë veten mirë.
- Si do t'ia rregullosh?

Kur i tregova projektet e mia me Edin, ajo pa e diskutuar tha:

- Të lumtë Rubi, je djalë i dashur.

Rreth orës pesë pasdreke u shplamë disi e u nisëm drejt qytezës. Kishte trafik e patëm kohë të bisedonim lirshëm njeri me tjetrin.

- Më ke thënë se vetmia ka lindur tek ti nga dhimbja e frika? Kjo përsa të ndodhi në rrethinat e Kozencës. Po pse vazhdon të njëjtën sjellje edhe këtu? Edhe pasi ka kaluar disa kohë? A nuk të rëndon ky qëndrim? A nuk gjen ndonjë mundësi e kohë të shtensionohesh?

- Isha e fiksuar te një jetë e humbur, e ngurtë, pa shpresë. Hija e burrit e sytë e djalit më ndiqnin kudo. Atje dhe këtu.

- Saktësisht a ke menduar se diçka duhet ndryshuar tek ti?

- Asnjë herë e në asnjë çast. Për si ndryshova, ta kam thënë. Qe një hije burri që m'u shfaq e më ndryshoi. Këtë ta kam thënë e nuk kam si të ta përsëris. Rubi, ti e munde heshtjen time. Më rizgjove. Më ringjalle shpresën e një jete të harruar, të braktisur. Bile edhe njerëzit e tjerë kam filluar t'i shoh ndryshe. Më miqësorë.

Në qytezë erdhëm pasi kishte rënë nata. Parkuam makinën. E ftova Ofelinë në shpinë time. Pa fjalë, për krahu u ngjitëm në katin e dytë. U zhveshëm e u futëm në banjo. Hoqëm disi lodhjen e plazhit. Pasi u rehatuam para televizorit, mora në telefon Maksin. Doli shpejt.

- Alo Maksi. Arrita në Itali e jam mirë.

- Si e le punën e shpisë në Sektor? - pyeti ai

- Miratuam projektin e bërë nga Edi. Filloi puna me avllinë. Po munde kontrolloje më shpesh e më informo



sesi ecin punimet aty. Ndonjë problem që do të ketë nëna mos e harro, ma thuaj. Pas një muaj do të marrësh deklaratën e pasurisë nga babai. Çoja ta mbajë ajo.

Ndërsa flisja me vëllanë, Ofelia, ndonëse nuk e kuptonte gjuhën tonë, gëzohej sesi komunikojta me të. E pëlqente një rraport të sinqertë e të mirë mes nesh.

Pamë pjesërisht një film të Felinit. Ishim të lodhur e gjumi po na mposhtëte.

- Flejmë? Nuk duroj më, -folja.

Ofelia u ngrit e para e u fut në dhomën time të gjumit, hoqi ato pak rroba që kishte e u shtri. Pashë që kishte marrë një skuqje të lehtë. Kur u shtriva afër saj, ndjeva nxehtësinë e ditës së sotme. Fërgëllonte në gjithë lëkurën e saj. Më tërhoqi me një buzëqeshje e shikim nga vetja. Më hodhi duart në qafë e u puthëm me mall. Ishte e tëra e lëngëzuar.

- Të dua e të dëshiroj shumë, - foli ajo.

Bëmë dashuri, të ëmblën dashuri që na bëri një trup. Ofelia ishte më shumë kërkuese se herët e tjera në këtë lidhje. E harruam lodhjen. Riaktivizuam forcat fizike e shpirtërore. Ajo dashuronte me gjithçka kishte. Sikur të ishte hera e fundit. Kërkoj edhe nga unë të njejtën gjë. Siç duket, ngarkesa ditore e rrezeve të diellit në plazh e mungesa ime i kishin ripërtërirë dëshirat, e kishte ndezur së brendshmi. Pasi luajtëm si deshëm me buzët, cicat e u lidhëm, erdhi edhe shkrehja fizike, shijuam qetësinë e disiplinimin e frymëmarrjes. U kënaqa edhe unë. Ishte një lidhje ndryshe nga të tjerat me Ofelinë. Gjymtyrët e shqisat ranë në qetësi, shijonin pasvalën. Ishte natë gushti. Gjashtë muaj pas udhëtimit së bashku në Jug Ofelia ndjehej e transformuar. Si kështu? Çfarë kishte ndodhë me të? Ende se kuptoja saktësisht. Me këto mendime më zuri gjumi. Të nesërmen u ngritëm vonë. Ishim të lodhur. Bëra mëngjesin si mikpritës që isha dhe ftova mysafiren në tavolinë. U çudita

me oreksin disi të shtuar të Ofelisë. E krahasova këtë konstatim timin me vaktet që kaluam bashkë në udhëtimin në jug të Italisë dhe ia thashë.

- Ke të drejtë. Je vrojtues i vëmëndshëm Rubi. Shumë gjëra kanë ndryshuar tek unë që kur ishim bashkë në blerjen e makinës tënde. I mban mend?

- Natën e parë fjetëm të veshur, si dy qenie të pandjeshme.

- Si shpjegohet kjo?

- Të kam treguar se kisha dhjetë vite pa shoqërinë e një burri në shtrat. Dhimbja e frika më kishin bërë të pandjeshme, dru. Isha drejt fundit si njeri. Kisha nevojë për aromën e djersës së një mashkulli e të rifitoja shijet e humbura aq të nevojshme për një femër, për një grua.

- Po kur shkuam në Jug ndryshove në kërkesa.

- Po. Kishte filluar rigjallërimi i strukturave shpirtërore, më shumë se aromën dehëse mashkullore, kërkoja diçka tjetër, diku më thellë shpirtit e trupit tim. E kur kaluam qytetin e Otrantos, përjetova orgazmën e parë, si nevojë e shprehje e dëshirës time fizike. Mbase aty fara jote, gjen apo takon në rrugëtimin e tij si partnere vezoret e mia. Atëherë në vaginë ndodhi ajo që prisja. Ajo u trondit e i dha pasgoditjet dehëse në gjithë shqisat e trupit tim të mpirë. U zgjova.

- Çfarë prisje?

- Një embrion të ngjizur ngadalë, me dëshirën e ndezur femërore që të zhvillohet deri në njeri.

- Pse kështu?

- Dua një fëmijë që të jetë krejtësisht i imi. Më nevojitet mua si oksigjen.

- Po unë?

- Ti nuk ke detyrime. Bëmë dashuri, si qejf e kaq. Për më tepër ti ke të drejtë të vazhdosh të bësh jetën tënde të



lirë. I lirë edhe me mua. Në asgjë nuk më bën të ndjem keq.

- Po mbrëmë?

- Si mbrëmë?

- Kush ishte ti me gjithë atë dëshirë për të bërë dashuri?

- Ajo që kërkoja ndaj vetes të isha. Grua. Të ndjehesha grua e plotësuar, e mbushur me hormone si herët kur ngjiza Encon, të kërkoja maksimumin e kënaqësisë në trupin tim, të goditej që të ndizej vagina ime deri në harbm, pra ishte faza e tretë e raportit me ty e në mëndje ai, shembëllimi hënor-nokturn Franko. Mbase mbrëmë isha zjarr, prush e për këtë ndikoi ngarkesa biologjike e trupit tim, rrezet e diellit, uji i Adriatikut e ardhja apo shfaqja jote pas një muaji mungese. E arrita zenitin femëror. Të kam sqaruar edhe më parë se tek ti shoh jo vetëm Rubinin, por edhe shembëllimin hyjnor të Frankos, në një figurinë që ka qenë e mbetet ende dashuria që i vetëm edhe në ëndërr më ndez e trazon shpirtin tim.

- E unë duhet të mbush atë zbrazëti?

- Mbase krijuesi të ka dërguar ty në këtë mision tokësor si njeri.

Unë qesha. Ndoshta nuk e kuptova këtë ndjesi të Ofelisë. Kjo nga kultura e pakët fetare që kam fituar deri tani.

- Unë vij nga një vend ateist ku lutja, falja, liturgjia e sakramenti nuk janë pjesë e edukatës qytetare. Këtu ndryshon puna, shkoj shpesh në kishë. Më pëlqen mesha e predikimi që bëhet aty. Kam një libër lutjesh e kur shkoj, lexoj e ndjek gjithë meshën. Si italianët, si ti.

- Mirë ke bërë. Vazhdoje. Po pikturat që ka kisha në qiellzanë e anash murit aty i ke parë ?

- Po. Dhe jam mahnitur.

- Pse?

- Gjithë ato skena pikturale mbushur me dashuri, dalë nga dora e mjeshtrave të mëdhenj të penelit italian, janë investim kulturor i pavdekshëm. Kujdes i vazhdueshëm. Bekim i pandërprerë. Edhe ti pyet: - Si kishe ndryshuar mbrëmë?

- Mos kjo është përgjigja e pyetjes që të bëra?

Ndërkaq mes fjalëve kishim përfunduar mëngjesin e po përgatiteshim të shkonim poshtë, tek baza. Në zyrë menjëherë hapa postën elektronike. Kisha disa mesazhe nga profesor Luigji për studimet pjesore të dorëzuara dhe një porosi të veçantë: Përgatit një material të plotë për tendencat e sotme të kultivimit të ullirit. Në vazhdim më orientonte se në cilat studime të kryera do të mbështetësha.

- Dakord profesor! - fola me mendjen time. Shpresoj që do ta përgatis materialin siç e do niveli i studimeve tona në fermë si dhe ai i UM të Barit. Dola nga zyra. Në mëndje më vinin të gjitha praktikrat e zbatuara e rezultatet e arritura në bazën eksperimentale. Ata më entuziazmonin mua, por edhe profesorin e kontin.

Takova kolegët e mi të punës, pashë serat, bazën prodhuese, zbatimet e reja e përgatitjen për shitjet e reja të fidanave. U ndjeva mirë mes tyre. Gjithçka e kontrolluar si duhet. Pavarësisht nga temperaturat e larta të stinës, këtu uji qarkullon në disa mënyra e bimët janë të gjalla, të freskëta. U gëzova. E ndjeva veten krenar që drejtoj një punë të tillë.

Në zyrë pas këtij frymëzimi, fillova të punoj pa u lodhur. Arkivi, të dhënat e provave fushore e laboratorike ishin aty. Të dhëna frymëzuese. Më dukej vetja se po fluturoja në një botë të veçantë, mes vlerave që natyra i kishte, disi iluzore, por i duheshin rrëmbyer.

Duke u thelluar në çdo nyje studimore, shoh se vazhdimisht ka kërkesa të reja. Ka detaje disi të panjohura. Informoj katedrën. Ndalohe. Si do të ndërtohet skema e



këtij studimi? Duke mbyllur një studim hapen fisha të reja të vëmendjes time që skedohen veças. Ia nis katedrës si projekt -program. Pres çfarë të më udhëzojnë.

- Alo Rubin.

- Po profesor.

- Propozimet tuaja qëndrojnë. Shpresoj që këto skedime do të ndryshojnë edhe konfigurimin e ardhshëm të studimeve në bazë.

Kryqëzohem në këto lëvizje që bëj dhe me Ofelinë. E shoh. Vishtet disi ndryshe, me fustane të gjëra, barra e ka rënduar. Megjithse e ngarkuar, kështu duket më e lëvizshme, më e gjallë e me më shumë energji. Rrezaton disi ndryshe, kjo jo vetëm për sytë e mi. Disi jashtë asaj që isha mësuar ta shoh. I gëzohej ngarkesës së saj. E donte.

- Rubin. Ti je njeriu më i afërt e i dashur që mund t'i drejtohem në këtë moment të vështirë, e të të besoj. Dua ndihmën tënde në lindje. Kam marrë çfarë duhet nga qendra shëndetsore e qytezës e me një shpi lindje kam kontraktuar fazën fundore. Nga ti kërkoj që të më lëvizësh me makinë si dhe të më gjesh një punonjëse shërbimi para e pas lindjes, - m'u drejtua Ofelia.

- Kur mendohet të lindësh? - pyeta.

- Rreth datës 15 dhjetor. Nga data 10 dhjetor punonjësja e shërbimit të jetë tek unë. Mendoj që të jetë një shqiptare. E njohin mëmësinë e janë më të pastra se ata me ngjyrë. Ti mbase mban lidhje me ndonjë grua të re nga vendi yt. Do ta marr në punë me kontratë e ta paguaj mirë.

- Për pjesën time si Rubin unë jam gati në çdo kohë me makinë. Për punonjësen e shërbimit do të mendoj e do të të sqaroj.

Kërkesat e Ofelisë më vunë në lëvizje. Telefonova Zanën: - Alo, Zana! Mirë je?

- Mirë Rubi. Luaj e studioj.
- Po ndonjë djalë të mirë?
- Ende jo.
- Po nga Brikena?
- Aha! Ajo përkohësisht është shkëputur nga stërvitja, ka lindur vajzë e vazhdon të japë provimet.
- Po Korina?
- Korina është keq. Kudo ku kërkon punë, dështon. Siç duket mallkimi yt po e ndjek nga pas.
- A mund të punojë ajo ndihmëse në shpi tek një grua e re? Do të ketë pak punë e një pagë të mirë me një kontratë ligjore të hapur. Unë e njoh atë grua. Është e arsimuar mirë e tip i qetë. Jeton e vetme këtu në qytezë.
- Me këto kushte që thua ti unë mendoj se i afrohet një mundësi e mirë të futet me rregulla në jetën italiane. Jeta është edhe sakrificë e duhet pranuar si e tillë.
- Bisedoje ti me Korinën e, nëse bini dakord, të më marrë në telefon.
- Sa i mirë je Rubi!
- Të kuptova Zana. Unë Korinën mike nuk e kam më, por armike jo, ama. Do ta respektoj për aq sa kam pasur me të e ta ndihmoj. Kaq.
- Po t'i ndodhte një femre kjo që thua ti për Korinën, as sytë nuk do të m'i hidhte.
- E di. Diku kam lexuar se inatit të femrës e kafshimit të gjarprit duhet t'i ruhem fort.
- Në fund të nëntorit, një pasdreke vonë, Korina trokiti në derën e shpisë time. Ishte e gëzuar dhe e kënaqur me interesimin tim. Menjëherë u nisëm te shpia e Ofelisë. Trokitëm. E rënduar nga barra ajo na hapi derën.
- Mirëmbërëma Ofeli!
- Mirë se erdhe, - u përgjigj ajo e na dha dorën duke na ftuar brenda.



E pashë që mezi lëvizte e kishte nevojë për ndihmë.

- Kjo është Korina, një vajzë shqiptare që unë ta kam sjellë si shoqëruese. Bisedoni e besoj që do ta gjeni dakordësinë me njëra-tjetrën.

Ofelia e shikoi me vëmendje nga kryet tek këmbët vajzën e pa u menduar gjatë foli:

- E ke sqaruar për punën që do të bëjë? Për kushtet?

- Po për të gjitha.

- Që sonte të rrijë këtu me mua.

Dola prej aty duke menduar se mes tyre do të vendoset një marrëveshje zonjash. Kjo, se unë isha garanti i saj. Si ndërmjetës për të dyja. Të dyja dinin pothuajse shumë për mua, por jo për njëra-tjetrën. Hihe. Të dyja kishin diçka të mirë nga unë që e dinin, por nuk e shprehnin, e ruanin e nuk e përdornin. Kjo do t'i mbante të afruara e në respekt për avenirin e njëra-tjetrës.

Pasa disa ditësh më merr prap në telefon Ofelia:

- Alo Rubi, - mirë je? U harrove në punë e nuk na kujtove.

- Po Ofeli. Kam pasur e kam shumë punë, por nuk të harroj. Jam në pritje të sinjalit tënd. Po me Korinën si e kalon? Si të duket?

- Thirra juristin e i bëra një kontratë pune të favorshme për të. Pas tre vitesh ka të drejtë të kërkojë dokumentat ligjore të qëndrimit e punësimit në Itali. Deri tani merremi vesh mjaft mirë.

- Kur të kesh nevojë për të lëvizur, më njofto. Mos e lër për në minutin e fundit.

- Për këtë të telefonova. Sipas konsultës janë orët e fundit, prandaj të jesh në kontakt të vazhdueshëm me mua. Pres një vizitë nga mamia e qytezës që të më këshillojë se kur mund të shkoj në spital.

- Gati jam unë e makina. Ti vetëm fol.

- Zemër!

Të mërkurën paradite me 22 dhjetor në një ditë me shi Ofelia shtrohet në shpinë e lindjes. Pas pesë orësh lindi djalë dhe e gëzoi shumë. Me Korinën isha vazhdimisht në ndjekje të gjendjes shëndetsore të nënës e fëmijës. E ndjente veten nën kujdes të vazhdueshëm. Gëzohej. Korina nuk largohej prej saj e fëmijës, as ditën e as natën. Pas katër ditësh, të tre i solla në shpi. Vazhdova të punoj në bazë me punët shkencore e çertifikimin e fidanave për shitje. Pas pune me Ofelinë e djalin.

Për Krishtlindje e Vitin e Ri kisha menduar të shkoj tek nëna, por si erdhi puna me Ofelinë, nuk mund të largohesha. Mora në telefon Maksin. E pyeta për nënën e të shoqen, për babin e ecurinë e punëve në shpi.

- Nëna është mirë. Edi e ka rregulluar të banojë përkohësisht tek jerevija. Gjithë ditën interesohet për punën në shpi e është e kënaqur. Avllia ka dalë shumë e mirë, i kanë vënë edhe shtesën sipër prej rrjete hekuri. Shpia po përfundon si karabina. Inxhinier Edit, më ka dhënë një listë për ty. Shkruaj: Mora lapsin e shkrova emrat e artikujve e sasinë e pajisjeve e materialeve elektrike, hidraulike, pllakave majolike për dysheme e banjo, dyerve e kondicionerëve e ku më vonë shtova nga vetja dyshekë, aparate televizive, lavatriçe, sobë e disa tapeta e rrugica.

- Si është jot shoqe? - pyeta Maksin.

- Nga fundi i shkurtit mendohet se mund të lind, ndaj e ruan veten.

- E more dokumentin tek babai?

- E ka sjellë vetë tek farmacia dhe ia kishte dhënë Ueldës. Gruaja me të cilën ai jeton ka lind djalë.

- Qenkemi shtuar me një gjysëm vëlla kështu?



Dhe unë kujtova rastin e takimit me babain, ku e shoqja nuk doli të më takonte se kishte qënë e ngarkuar. Siç duket i vinte turp. Pse?

Ndërkaq në kafene u takova me Ofelinë. Kishte rifilluar pjesërisht punën pas lindjes së djalit. E pashë në sy. I kishin dalë nga thellësia e sikur ishin dritëzuar më shumë. Donte më shumë natyrë, hapsirë. Kishte ndryshuar shumë në pamjen fizike të saj

- Si është djali? - pyeta.

- Shumë mirë. Korina duket vajzë e kujdesshme. I zbaton mirë porositë e infermieres.

- Si ia vure emrin?

- Enco, - u përgjigj.

Kur përmendi emrin e djalit, m'u kujtuan varrezat në Kozenca. Edhe fëmija me Frankon kishte pasur të njëjtin emër. Duke ruajtur privatësinë që kërkonte e ëma me këtë lindje, pranova pa folur edhe vendosjen e këtij emri. Ishte në dëshirën e saj. Vazhdonte riardhja e rigjetja e qenies së saj në atë që donte e kërkonte ajo.

I tregova për punët e kryera dhe nisjen me e-mail në katedër të tyre.

- Shumë mirë. Pret përgjigje që materiali të arkivohet.

- Edhe për fillimin e zbatimeve të reja?

Pas disa ditësh erdhi vetë profesori.

- Nga shtatë propozime, këtë vit janë miratuar vetëm tre. Propozimet tuaja u vlerësuan. Ata ndikuan në ndryshimin e drejtimit të punës shkencore. Këtë ia raportova rektorit e kontit. Nino Ferreti është shumë entuziast me punën tënde. Të sjell përshendetjet e tij.

- Po për ndërhyrjen në mekanizmin e qelizës?

- Duhet një bashkëpunim i Ofelisë me një fiziologe bimësh, grup që do të krijohet më vonë. Është një studim

i thellë e me interes të madh. Ka pasur disa tratativa para jush, por janë ndërprerë në mes.

- E di. Këtë ma tha edhe Ofelia kur e diskutova projekt-idenë me të.

Po nisem në Shqipëri. Dua të shoh e të kontrolloj punën që po bëhet në shpinë e re. Njoftova edhe Ofelinë. Kur po ndahesha, ajo më zgjati një tufë me para. Siç duket i kishte bërë gati. Kujdes i tepërt mikeje. Hezitova t'i marr.

- Merri. Do të të duhen. Janë mirësia e miqësisë tënde. Thjesht për qejf. Më kupto.

Në Bari mora me qera një kamion me karroceri të mbuluar e në disa pika grosiste bleva materialet sipas listës së përgatitur më parë. Parkova makinën time, ndërsa kamionin e ngarkuar e futa në pikën e kontrollit. Me shoferin u bëmë gati për udhëtimin me target. Në Durrës prap problem me nëpunësit shqiptarë të portit. Kur dola prej aty, u ndjeva keq. Nuk justifikohej sjellja e tyre. Në Sektor arrita në drekë. Në kodër ngrihej shpia e fëmijërisë time, tashmë dykatëshe që më bënte të drithërohesha. Ishte rrethuar nga avllia e bukur e mbyllej nga porta me dy anësore guri hijerëndë. U ndjeva mirë. Ndalua. Hapa vetë portën ende pa çati e makina u fut brenda oborrit. Nëna e inxhinier Edi më ndiqnin nga cepi tjetër i shpisë. Qeshnin.

- Erdhe? - folën të dy njëherësh.

U përqafova me nënën e Edin. Nëna ishte mirë. Shpia ishte mbuluar.

- Ke ardhë në kohën e duhur, - foli Edi që kontrolloi ngarkesën e urdhëroi: Dyert, tapiceritë e pajisjet elektronike i fusim në jerevi, pllakat e pajisjet hidraulike e elektrike në banesë. Që nesër fillojmë punën me to.

Kur punëtorët po shkarkonin pajisjet, me Edin e nënën kontrolluam punën e bërë. Më pëlqeu shumë.



- Të lumtë Edi! Edhe me avllinë ke punuar mirë. Veçanërisht me derën që e kisha merak. Pikë të dobët ajo për mua.

- Mos i shpenzo fjalët para se të heqim tapën e shampanjës, - foli ai.

Qeshëm të tre. Nëna sa nuk fluturonte.

Në oborr i dhashë edhe projektin për rregullimin e kopështit përgatitur nga Roberto.

- Për këtë punë unë di pak, por kam një shok inxhinier pyjesh që merret me gjelbrimin e shpresoj që këtë vjeshë edhe ky projekt të mbyllet.

- E shikon si është? Shkretëtirë!

- Do ta kthejmë këtë vend në një pikë pushimi. Model si e do ti.

- Ka ujë rrjeti?

- Si po vijnë punët, më mirë është të bëjmë një shpim e një depozitë 200 metërkubshe që të furnizojë me ujë në të gjithë vitin.

- Ashtu do ta bëjmë, - foli, por në pranverë. Tani për tani mbaroni këto punime që keni në dorë. Këtë vjeshë nëna ime do të jetojë këtu si mbretëreshë.

Ajo qeshi e lumturuar nga fjalët e mia.

- I ke paguar punëtorët? - e pyeta me të qeshur nënën.

- Sa më ka thënë Edi e për çdo 15 ditësh.

Kontrollova llogarinë me nënën, nxora e i dhashë një shtesë page Edit si dhe për punëtorët.

- Vjen Maksi këtu?

- Po, por ka një javë që nuk ka ardhur.

- Nuk kam mundësi ta takoj. Sonte do të nisem për në Bari, ndaj të m'i blesh bebit nga unë krevatin e gjithë pelenat e duhura, - i foli nënës.

Pasi hëngrëm me Edin e shoferin barez drekën që na përgatiti nëna, u nisëm për në Durrës. Të nesërmen në drekë isha në qytezë.

* * *

Rutinën e asaj pranvere e grishi botimi i artikullit shkencor të shkruar nga unë në revistën 'Mediterrano agrikol'. Pati një ndjeshmëri të veçantë nga opinionioni shkencor, nga katedra e UM e nga konti. Ai erdhi një ditë në bazë, pimë kafe bashkë e më përgëzoi. Ishte i kënaqur.

Një javë më vonë në fermë erdhi Kolomba. E pashë kur zbriti nga makina. Vazhdonte të pinte duhan.

- Si të kam Rubi, - foli e u puthëm në faqe.

- Mirë! Gjithë kohën në punë.

- Dhe rezultate të prekshme. Gëzohem për ty si shok kursi, por..

- Çfarë?

- T'i paska futur dy këmbët në një këpucë fermeri me programe e detyra, - vazhdoi ajo në të sajën.

- E ke gabim. Ai asnjë rast nuk ka ndërhyrë në kohën time. Mua këto vite pune, përjashtuar kohën kur punoja me punëtorët e prodhimit, nuk më është treguar orar, por detyrat. E kam nocion, rregull, detyrim, edukatë.

- Sa të paguan konti?

- Kur i tregova pagesën vjetore sipas kontratës ajo u habit. Ftyra iu zvoglua e me dyshim foli prap: - Kaq shumë para për një specialist emigrant e në moshë kaq të re si ti?

E pashë në sy. Nuk e njoha Kolombën.

- Një pjesë të kësaj page e marr nga fondet akademike të UM të Barit. E të dy institucionet nuk pyesin për kombësinë e moshën. Ata vlerësojnë punën që bëj.



- Ndaj je mbyllur në këtë humbëtitë? Si murg.

- Kjo humbëtitë që thua ti është ndër qytezat më të mira të Europës, me një popullsi të vogël, por shumë të vlerësuar që jeton më mirë se kudo në Itali. Klima e ambienti i saj janë në favor të njeriut si rrallë në një vend tjetër. Shihi, jetoji e atëherë do të flasësh ndryshe.

- Po Italia e Europa është shumë më e madhe se kaq?

- Këto vite kam pasur rastin ta shoh pjesërisht Italinë, Romën, Firencen, Venecien e Milanon. Do ta shoh edhe pjesën tjetër. Kam kohë. Gjithçka në kohën e duhur.

- Dhe rri gjithnjë sportiv?

- Unë kam pasur një rini sportive që po më ndjek. M'u kthye me kohë në edukate personale. Këtu gjej mundësi që ta mbaj veten në formë.

Kolomba qeshi e duke ndezur një cigare tjetër foli: - Po, duket edhe në pamjen rinore që ruan. Të admiroj.

- Të falemnderit! - u shpreha e vazhdova: Pse ke ardhur këtu?

- Të takoj një mik të suksesshëm.

- Tjetër?

- Ta ftoj për një vizitë në jug të Italisë. Në fermën time.

- Me gjithë qejf.

- Kur mund të të pres?

Ishte ftesa e dytë që më bënte Kolomba. Vendosa t'i përgjigjem:

- Për miq e njerëz të veçantë si ti unë gjej e planifikoj kohë kurdo.

Nga zyra ku ishim, Kolomba u njoh me studimet e mia në arkiv si dhe projektet që vazhdonin e prisnin radhën të kalonin nga letrat në bazën eksperimentale. Vizita në bazë, serë, laborator e në bankën e ruajtjes së materialeve bimore e turbulluan vazhën.

- Tashti e kuptova pse kjo fermë ka rezultate kaq të mira, - foli e duke më parë në sy vazhdoi:

- Pa dyshim edhe lidhjet me UM të Barit e kanë bërë të tillë.

- Dhe respekti e vlerësimi i punës së specialistëve, - plotësova unë.

- Pse e thekson vazhdimisht këtë fjali të fundit?

- Puna e një specialist të mirë në fermë është një investim me afat të gjatë, rezultatet e të cilit vijnë gjithnjë në rritje. Këtë e kam kuptuar nga raportet e kontit me ta në fermë, në historinë e zhvillimit të saj. Ata janë trajtuar gjithmonë mirë dhe kur ferma ishte në ditë jo të mira. Këtu gabojnë një pjesë e fermerëve, ku futeni ndoshta edhe ju.

Në një moment diskutimi iu drejtova si me forcë:

- Me sa kuptova unë, bimën e ullirit e trajtoni pjesërisht si të egër. Gabim i madh.

- Si duhet përmirsuar kjo? - pyeti e shqetësuar Kolomba.

Kur i tregova punën që bëhet në 'Kastel Blu' për këtë qëllim hallkë pas hallke, ajo më shikoi në sy thellë e foli: - Im atë tashmë nuk merret me fermën, artriti e ka vënë përfundi. Unë jam e vetme.

Në këtë çast ajo u inatos me veten e m'u drejtua: - Pse nuk vjen të punosh me mua? Do të kesh gjithçka që të duhet... edhe mua.

- Të falemnderit për besimin e respektin. Unë nuk mund të braktis punën e nisur, rrugën e filluar e njerëzit që më kanë besuar e më duan.

E trazuar nga dështimi i kërkesë së saj të përsëritur e për të dalë nga ky ngërç ajo foli:

- Ke të drejtë. Po bëhen disa vite që mbaruam shkollën. Ti vrapove, unë ngeca në vend. Të lumtë. Edhe kaq, je mësim për mua. Të falenderoj!



PAS DY VITESH

Gjithnjë në bazë me punën kërkimore, mes leximeve e studimeve. Më kanë rrëmbyer me magjinë e tyre. Fe e veçantë. Ndjem i tjetërsuar në këtë botë të re. Ndjej kënaqësinë e të gjendurit mes tyre. Këshilla, bashkëbisedime e vëmendje nga trupa shkencore e UM i Barit. Shumë i interesuar edhe konti. Rraportoj për çdo hallkë e detaj të punës në katedër. Ka rezultate që na gëzojnë. U përgatën e u botuan në revistën e njohur mesdhetare.

Ftohem në UM të Barit të mbaj dy leksione. Në auditor përveç studentëve ishin edhe disa pedagogë, konti, Nino Ferreti si dhe dy pedagogë të rinj nga UB i Tiranës e kryeredaktori i revistës shkencore ‘Mediterrano agrikor’ zoti Sorano. Me profesor Luigjin, diku veças, rrinte e dëgjonte edhe Ofelia. Të dy lektoriumet bëhen radhazi e përbënin një ditë të veçantë mësimore. Leksionet e shkruara, videot e sekuencat filmike nga puna shkencore në ‘Kastel Blu’ ishin gjithë materiali që u dhurova të pranishmëve. Një pjesë prej tyre u përsëriten disa herë e u bënë objekt i një bashkëbisedimi të veçantë që vazhdoi gjatë. Planifikuar për dy seanca me nga 90 minuta, e gjithë dita mësimore u mbyll pas 300 minutash. Të gjithë ishin të interesuar për çfarë referova.

Në fund, në emër të katedrës shefi i saj, profesor Luigji sqaroi auditorin:

- Falenderoj bashkëpunëtorin tonë më të ri, Rubinin. Të gjitha referencat shkencore që u parashtuan para jush janë pjesë e studimeve të katedrës tonë që do të ribëhen apo përsëriten me të njëjtin format në vazhdim në disa zona të Mesdheut. Materiali mësimor që u paraqit, bën pjesë në programin e miratuar në këshillin shkencor të UM të Barit për formimin e studentëve e fermerëve. Kuptohet që 'Kastel Blu' është pararendëse e këtyre studimeve e lektori është zbatuesi i parë i tyre.

Pasi u ndava me profesorin e dy bashkëatdhetarët e mi, u nisa me Ofelinë drejt qytezës.

- Të gjithë në sallë e vlerësuan punën tënde, - foli Ofelia.

Nuk u përgjigja. Pashë në sy vajzën. Kishte ndryshuar në gjithçka. Dukej më e gjallë, më e hapur. Ishte veshur me rroba me ngjyra të tjera, kishte ndrruar modën e flokëve, bënte tualet, bile edhe këpucët i kishte me taka më të larta. E risolla në mendje pamjen e saj në sallë: Dëgjonte me vëmëndje, diskutonte me kolegët, jepte mendime e me sy më kërkonte mua si pikë referimi. Ishte ripërtërirë.

- Nuk e di pse profesori ma la vetëm mua materialin referues? - pyeta.

- Po, se ti e ke zbatuar, bile ke përpunuar edhe rezultatet. Në emrin tënd është botuar edhe në revistën shkencore, - ndërhyri Ofelia.

Heshta. Mbase kështu ishte më mirë. Diku në mesin e udhëtimit na doli përpara lokali ku kisha drekuar para disa vitesh me Ninon. Kisha kujtime të mira. Parkova makinën e dolëm.

- Do të hamë diçka, - foli.

Ofelia nuk foli, më kapi dorën e së bashku zumë vend në një tavolinë. Porositëm.



- Mirë bëre. Kemi kohë që nuk kemi drekuar bashkë. Na ke harruar. Nuk e di pse. Unë apo Korina jemi shkak?

- Jo nuk ju kam lënë jashtë vëmëndjes. Kam pasur ngarkesë të madhe në bazë, por edhe interesimi për shpinë në Shqipëri më ka kushtuar kohë e vëmendje. Të kam treguar. M'u desh të shkoja dy herë atje që të përfundojë siç desha unë i gjithë projekti. Tash jam i qetë. Po kështu nusja e vëllait lindi vajzë dhe nga babai kemi një vëlla tjetër. U bëmë tre.

- Lum si ti, - foli Ofelia. Je me shumë njerëz përreth. Jo si unë e vetme në këtë botë.

Pashë që gropat e syve iu mbushën me lot. Zgjata dorën time e kapa të sajën. U shtriq. E pranoi miqësinë e ngrohtësinë prej gjymtyrëve të mi. E kuptova mërzhitinë e saj.

- Më fall! - Duhet të kisha qëndruar më afër teje e djalit.

- Dhe ai mbush tre vjeç pas pak ditësh?

- Sa shpejt ikin vitet. Fluturojnë.

- Po. Dhe ti duhet të jesh përkrah meje në këtë ditëlindje.

- Pa diskutim që po. Ku do ta festojmë?

- Në darkë në shpinë e qytezës. Duhet të përfitojmë nga Krishtlindjet e të shkojmë në Romë, Firence apo Milano? Zgjidh ti, - foli me dashuri Ofelia.

- Po Korina?

- Po bëhen tri vite që ajo vajzë rri me mua e djalin tim. Kur dita është e mirë, del e shetit në pyll. Merr me vete edhe violinën e i bie në qetësinë e natyrës. Encon e mrekullojnë tingujt e veglës. Ai është lidhur shumë me Korinën.

- Kam dëgjuar se luan dhe me orkestrën e lokalit të qytezës.

- Po. Të shtunave e të dielave kur ka pushim. Të shkrifërojë gishtat, të mprehë vëmendjen.

- Kur i mbaron kontrata me ty?
- Në fund të këtij viti, por mund të vazhdojë deri në shtatorin e ardhshëm, kohë kur djali fillon edukimin parashkollor.
- Po pas kësaj kohe?
- Vajza ka aplikuar për të fituar letrat italiane të qëndrimit që shpresoj se do t'i miratohen e të rregullohet diku tjetër. Do ta ndihmoj. Ia vlen. Mendoj si për vete.
- Do ta marrim edhe Korinën në festën e Encos?
- Po. Të shqetëson ty prania e saj me ne?
- Jo. Unë jam ndarë njëherë e mirë me të, por nuk di deri ku është raporti yt me të.
- Për mua është një vajzë e mirë, për Encon një edukatore me violinë.
- Pi pak verë. Është prodhim i kolegjit ku është drejtor Nino Ferreti. Ka pak alkol, por është e shijëshme.
- U nisëm drejt qytezës. Ishte një ditë tetori e bukur. Vjeshta po jepte shenjat e saj. Disa pemë kishin filluar të zverdhnin gjethet. Dukeshin ngjyrat e florinjta të tyre.
- Një piktor në Shqipëri e ka fiksuar mrekullisht bukur këtë ngjyrë në telajo. Më pëlqen shumë kjo stinë.
- Edhe mua.
- Edhe ti Ofeli ke marrë ngjyrën e stinës. Më dukesh mirë kështu.
- Të faleminderit Rubi!
- Ndërkaq arritëm në qytezën tonë të bukur. Aty ende ishte verë, gjelbërimi e kujdesi i pandërprerë na bënte të ndjeheshim mirë.
- Mirupafshim nesër në bazë, - foli Ofelia e u nis drejt banesës së saj.
- Sheshi i qytezës ishte i populluar nga njerëz që shetisnin, veçmas, në çift apo grupe. Me sa kam kuptuar, janë të kënaqur me jetën e tyre. Në dukje indiferentë, por më



pëlqenin si të tillë. Shumë të interesuar për veten. Egoistë. Po si qytetarë të vjetër! Të mençur e të urtë. Mua më konsiderojnë pjesë të tyre. Në respekt të tyre edhe unë sillem sipas kodeve që ishin stamposur në çdo pjesë që përbën jetën e qytetës. E shihja këtë kudo. Edhe ata më shohin mua. Në punë, në shetitje, në kishë, në shesh e supermarket, gjithnjë në qetësinë e tyre. E unë e dua këtë lloj qetësie. Jam mësuar ta respektoj si ajrin, diellin, shiun e erën. Si natën e ditën.

I kënaqur me këto mendime, hyra në shpi. Deri më 22 dhjetor kisha kohë të mendoja për ditëlindjen e Encos, për pakon e vendin ku mund të kalonim mirë këto ditë pushimesh. Por jo. Mendja ime mbeti aty. Për çfarë? Për pakon. Çdo të zgjedh që të gëzohet Encon, ti ndez fantazinë e motivet e jetës në rritje. Cili do të jetë vendi ku të kalojmë ditët e pushimeve dimërore? Cili qytet na afronte me analogjitë apo të veçantat e tij? Mendoj kudo, në rrugë, punë, kur drejtoj makinën, kur ha, punoj në bazë, para se të flija, pra kudo. Isha i motivuar të bëja gjënë e duhur. Si sfidë ndaj vetes, Ofelisë e shoqërueses tonë Korina. Me Encon ndryshonte puna, ai ishte si lodër e vogël, e gjallë për ne.

Më datën 22 dhjetor qëllloi ditë e shtunë, e vërenjtur e herë pas here binte shi. Deri në orën 15-të punova dhe nisa disa materiale drejt kabinetit të kontit e në katedër të UM të Barit. Në shpi më priste përgatitja për të shkuar në darkën e festës, tek Ofelia. Pas një tualeti e dreke rashë e fjeta. Më zuri menjëherë gjumi.

U zgjova nga një zile e zgjatur telefoni. Ishte ajo.

- Alo Rubi! Kur do të vish nga ne?

- Sa të bëhem gati. Zëre se erdha, - fola e u ngrita.

Vesha një palë xhinsa blu, një këmishë me lule, triko me jakë në formë v-je ngjyrë kafe e xhokoventon

treçerekshe. Në këmbë çorape e atletike sportive të errëta. Vendosa orën në dorë. Mora pakot e dola. Jashtë shiu kishte pushuar, por bënte ftohtë. Rrugës granili rrëshqiste nën gjurmët e mia. Trokita në derën e shpisë së Ofelisë.

- Urdhëroni! Më ftoi duke qeshur ajo.

Hyra e vendosa mbi tavolinë dhuratat. I dhashë dorën Ofelisë, e putha në dy faqet e ndezura dhe e urova:

- Me jetë të gjatë e të lumtur Enco!

- Të falenderit! - foli duke u skuqur më shumë, por në sy ndrinte.

Përqafova Encon e i dhashë dorën Korinës. Hoqa xhokoventon e këpucët e zura vend në divan. Shpia kishte marrë disi aromë kuzhine. Festë.

- Kam sjellë një kuti me disa shishe verë kolegji, - i foli Ofelisë.

- Kam marrë edhe unë verë, por edhe ti mirë bëre. Vera nuk është kurrë tepër në gëzime.

RAI jepte lajmet. Enco luante. Korina merrej me përgatitjen e darkës.

Pas pak në tavolinë jam mes Ofelisë e Korinës. Po gëzohem. Uroj Encon e Ofelinë në çdo ngritje gote. Enco më vinte afër me gjysma fjalësh, ndërsa Ofelia, e plotësuar, shpreh gëzimin me të gjitha shqisat. Ndjehet mirë. Edhe unë e shijoj këtë ndjenjë.

- Sot me ju po festoj këtë çast të lumtur të jetës time. Jeni njerëzit që u gjendët pranë meje e ju dua. Ju falenderit! - u shpreh Ofelia.

- Kam sjellë një pako me dy dhurata, - foli e u ngrita nga karriga ku isha. Zbulova të parën: Një makinë me bateri që ec. E ndeza.

- Eja Enco, - foli dhe e vura në ndenjësë. E mësova si vihet në lëvizje.

- Ec vetë dhe drejtoje me timon, - foli



Enco filloi të lëvizte në koridor e kthim, në fillim me frikë e pastaj më me guxim. Të tre ne të rriturit u vumë në ndjekje të lëvizjes së tij. Ai sa vinte e gëzohej.

Pas pak hapa dhuratën e dytë: një violinë. Ajo hutoi gratë, Korinën për profesionin e saj, ndërsa Ofelinë me një farë xhelozie apo droje. S'e kuptova pse, por ndërhyra menjëherë:

- Makina është pajisja që po përshpejton kohën, e këtë ia uroj Encos, ndërsa violina është vegla që nxjerr tinguj që shpresoj të mbushin jetën e djalit. Të dyja këto janë dëshirë e imja.

Ofelia e Korina u gëzuan.

Në vazhdim edhe ata hapen dhuratat e tyre. Në fund Ofelia solli në tavolinë dy fotografi të zmadhuara të Encos, futur në korniza të veçanta. Kishte dalë me flokë të gjatë e disi i qeshur. Dukej pothuajse një shkrepje aparati në dy kopje.

- Po, pse dy? - pyeta.

- Shif mbrapa shënimin, - foli Ofelia.

I pashë e heshta. Enco Franko Baldini. Mars 1985 ndërsa tjetra po Enco Franko Baldini, por dhjetor 1998. E kuptova diçiturën me mendjen time. Ofelia kërkonte një fëmijë në pamje si Enco i Kozencës, bir i Frankos. E gjeti si shëmbëllim, si dëshirë e ëndërr. Lavdi Zotit si përsëriten krijesat e kësaj bote. Të njëjtën ftyrë, sy, vetulla, flokë. Magji nga lartësia. Mrekulli! Dy fotografi nga kohë të ndryshme që nuk mund të dallohen njëra nga tjetra.

- Qartë! Çfarë deshe ke gjetur. Është krejtësisht i joti.

- Të falemnderit! - foli Ofelia që e dalë nga një makth foli:

- Ku do t'i vazhdojmë pushimet? Ke menduar?

- Po. Në Parma ose Gjenova. Zgjidhni ju.

Pa më kërkuar shpjegime, të dyja vendosën për Parmën. Edhe unë u gëzova me këtë zgjedhje. Nuk i di motivet që i shtynë vajzat për këtë vendim, por për vete isha i qartë: Aty ishte varrosur Nikola Paganini, mjeshtri virtuoz i interpretimit në violinë, që vodhi tingujt nga natyra dhe i solli në salla për njerëzit. E kishte një jetë bohemi, që nuk u bë kurrë familjar e la pas me këngëtaren e kërcimtaren Antonia Bianki një djalë: Achilio Çiro Aleksandro. Pra, aty do të gjenim një qytet të lashtë e do të na ofronte shumë enigme e mrekullit nga krahina e Emilia-Romanjës.

Me këto mendime për udhëtimin e nesërm u ngrita në këmbë.

- Po dal. Nesër ora 9-të do nisemi. Duhet të përgatitemi. Ofelia më përcolli deri tek dera. Korina e Enco mbetën në dhomën e ngrenies. Kur po ndaheshim, Ofelia e kënaqur për mbrëmjen, më zgjati buzët e u puthëm. U puthëm si të dashur. Në vetmi? Jo! Nga dera e dhomës ku po festonim, u shfaq fytyra e Korinës me dy sy ziliqarë e filmuan gjithë seancën e kësaj puthjeje. E pashë sesi iu venit shikimi përballë e dy sytë që i njihja mirë, perënduan. U tërhoq e mundur. Mbase vuante e qante gabimin e saj me këtë tango sysh të përlotur. Tango lotësh. Nostalgji për një kohë gabimisht të prishur prej saj.

- Natën e mirë Ofeli!

- Natën e mirë, zemër!

Të nesërmen shkuam deri në Bari. Në pritje të trenit parkuam në ruajtje makinën e premë biletat. U nisëm. Në një kompartiment u rehatuam. Jashtë ishte kohë e vrenjtur e herë-herë binte shi. Luanim me Encon.

- Kori, nxirre violinën e bjeri një melodie, - urdhëroi Ofelia.

Pas tre-katër interpretimeve që gëzuan edhe Encon, iu drejtova Korinës:



- E di se në Parma është varri i violinistit virtuoz Nikola Paganini?

- Jo nuk e di.

- Në fakt, ai ka vdekur në Francë, në Nisë më 1840-tën, por kisha nuk e lejoi të varroset atje. E kishte shkishëruar me pretendimin se nga violina e tij nxirrte tinguj që i huazonte nga djalli.

- Po pse u lejua të varrosej në Parma?

- Ka një lëshim nga papa dhe në vitin 1876 u gjet një vend për këtë gjeni në varrezat 'Villeta' të qytetit.

- Në Institut veprat e tij i kam dëgjuar disa herë të regjistruara e të vjen keq që është trajtuar kështu. Lavdia ka çmim të lartë.

- E Parma sot nderohet me të, edhe se vituoz i është në varr.

Treni ecte në terrene ku shiu ishte kthyer në borë.

- O, shiheni, shi i bardhë, - foli nëpër dhëmbë Enco. Qeshëm të tre. Qeshi edhe djali.

Në stacion morëm një taksì. Parma ishte e mbuluar nga bora. Mrekulli.

- Duam një apartament për 10 ditë, - foli Ofelia.

Ndaluam para hotelit 'Il Giardino degli Artisti'. Në reception na orientuan për në katin e dytë. Ishte një apartament me ngrohje, me dy dhoma fjetjeje, kuzhinë e dhomë ndenjeje. Sapo hymë ne, ngrohësi hidraulik i dhomës filloi të punonte. Xhamat dyfish kishin nga jashtë kristale akulli. Pashë termometrën: jashtë temperatura ishte minus 5, brenda 7 gradë Celsius. U sistemua. Në njëerën dhomë vendosi rrobat Ofelia, në tjetrën Korina me Encon. Kuptohet se kjo ishte zgjidhja e Ofelisë. Unë do të flija me të. Gjithçka dakord në heshtje.

- Si mund të gjejmë një guidë e një makinë me qera? - pyetëm tek receptioni.

- Megjithse jashtë kohës turistike, ne ofrojmë edhe këtë shërbim, me makinë e shofer.

- Shumë mirë! - fola i kënaqur.

Në darkë ndoqëm meshën e Krishtlindjeve në kishën afër hotelit. Të nesërmen filluam vizitat në qytet. Megjithse herë pas here binte borë shërbimi ndërçytetas i mbante rrugët të hapura. Mundëm të realizonim çdo ditë planin tonë të vizitave. Pamë Katedralen e Parmës, më e madhja në të gjithë Italinë, sheshin Duomo me Baptisterin e famshëm e ritin e tij të pagëzimit ndërtuar në vitin 1270, Manastirin San Paolo, Kishën e Shën Pjetrit Apostull, Bazilikën e Santa Maria della Steccata e shumë vepra të tjera kulturi. Kudo art e mrekulli ndërtuese në stilin barok apo, kulturë të lartë e ruajtje perfekte të saj. Pamë galerinë arkeologjike, kombëtare, Glauco Lombardi e Bacchi, galerinë e fotove e monumentet e ndryshme si ai i fitores. Pamë edhe varrezat Villeta ku preheshin mbetjet e trupit të Paganinit, një ndërtim me mburojë, brenda së cilës ishte gjysëm truporja e violinistit të famshëm, vepër skulpturore e gjenovezit Varni.

E kështu ditë pas dite u njohëm dhe me lumin Parma, shijuam djathin e famshëm Parmigiano Reggiano, kujtuam romanin 'Manastiri i Parmës' të Stendalit, historinë e lashtë të qytetit, vendlindjen e muzikantit Arturo Toscanini, shumë piktorëve, skulptorëve e njërëzve të shquar të Parmës. Ndjehet kudo se është qytet me histori, por që ruhet e studiohet, zhvillim e kulturë që pasurohet vazhdimisht e i bën krenarë njerëzit e tij.

Po gjithçka kaloi shpejt. Enco gëzohej në hutimin e tij, Korina habitej me çfarë shikonte, Ofelia rinohej e ftohtësia dimërore me borë sikur po e gjallëronte. Unë përkrah tyre ndjeja forcën e njeriut që në një vend normal kthehet në



vlerë që ruhet e përcakton të ardhmen. E në Parma kështu ka ndodhur.

- Pse më more në krevat këto ditë parme? - pyeta Ofelinë rrugës në kthim.

Korina hapi sytë e çuditur nga fjalët që i shkuan në vesh. Provokacion ky?

- Se desha të shijoj deri në fund kënaqësitë e mbrëmjeve në këto pushime. Bashkëjetesa me ty më shtoi forcën, frymëmarrjen. Tashmë jam grua e plotësuar dhe me ndjesi të forta. Si bashkëmoshataret e mia. Nuk kam të drejtë ta shijoj? Gabova se të zgjodha ty?

- Si kështu?

- E kupton që unë kisha humbur ndjenjën më të shenjtë për një grua, mëmësinë. Ti ma risolle e për këtë të falenderoj.

Unë dëgjoja fjalët e Ofelisë, por me sy ndiqja Korinën, mënyrën se si e përjetonte ajo këtë dëgjesë në pendimin e humbjen e saj që e pranonte me pezm. Nuk shpreha triumf. Ishte i panevojshëm.

Korina pas asaj që dëgjoji, u tërhoq. Rrinte me Encon. Unë mendoja e Ofelia kishte humbur disi në pamjet që vinin nga jashtë kompartimentit, vreshtat nën borë, cungjet e braktisura nga gjethet sikur kërkonin ndihmë. Diku në një lum një tufë rosash bënin lojën e tyre në ujin e shkrirë pjesërisht.

Dukej sikur natyra flinte nën këtë borë. I ishte nënshtruar me gjithçka asaj.

Arritëm pasdreke në Bari. Binte një shi i imët. Ishte shumë më ngrohtë se në Parma. Shkova në parking e mora makinën. U nisëm drejt 'Kastel Blu'. Ndalojmë para shpisë së Ofelisë. Zbresim. Valixhet e çantat i nxorëm nga makina e i ngjitëm lart. Tek dera përqafova Encon, i dhashë dorën Korinës e u ndava me Ofelinë.

- Të falemnderit! Na dhuroat një dhjetëditësh shumë të këndshëm. Ditë e netë Parme. Për t'u mbajtur mend, - fola.

- Po. Më pas mund të kemi dhe ditë Verone, Kremone, Padova, Bolonje e shqiptare, - u shpreh Ofelia tashmë e tjetërsuar. E ndjente veten plotësisht grua të rizgjuar. E hapur.

Nga ku ishte Korinës, i ndryshoi disa herë harta e ftyrës nga çfarë dëgjoji.



PROJEKTE

Më 5 janar iu riktheva punës në bazë. Fillonte përgatitja e sezionit të ri. Hap postën elektronike: mesazhe urimi për Vitin e Ri nga Kolomba, Nino Ferreti, profesor Luigji e Mario, Zana e Brikena. Me vonesë, por me mirësjellje u ktheva përgjigje. Më pas një lajmërim: Më 10 janar në bazë në një work-shop do të paraqitet programi i punës kërkimore-shkencore i UM të Barit për kulturën e ullirit. Vazhdonte me emrat e personaliteteve që do të marrin pjesë. Në sallë do të jenë gjithë punonjësit e specialistët e bazës. Poshtë firma:

Luigji Guarnieri.

Shef i Katedrës në UM të Barit.

Ditën e caktuar erdhën të ngarkuarit e aktivitetit si dhe konti. Ky i fundit më thirri pranë vetes e më pyeti shumë i interesuar:

- Je i kënaqur me mbajtjen e work-shopit këtu?

- Shumë. Të falenderoj për mundësinë që më krijove të tregoj arritjet e grupit, pjesë e të cilit unë jam.

Ai qeshi e me profesorin më paraqitën para autoriteteve shkencore që ishin të pranishëm:

- Ky është Rubin G. autori i artikujve shkencorë që, me problemet që ka kërkuar të sqarojë, na ka intriguar të gjithëve.

U habita. Vërtetë unë kisha qenë mbikqyrësi i këtij programi, por jo krijuesi apo kërkuesi. Pse ma shkarkojnë të gjithin mua. Modesti? Rrobë inteligjente. Pse pra?

Kur ia thashë këtë mendim profesorit, ai qeshi e, si gjithmonë u përgjigj:

- Rëndësi ka rezultati që kërkojmë. Bëhet fjalë për një qasje ndryshe në punën me bimën e ullirit. Ku do të arrijmë? Punë grupi. Ndaj edhe jemi mbledhur sot.

Nga ku ishte konti, ndiqte bisedën time me profesorin. Gjithnjë në stofin e tij.

Work-shopi u zhvillua në frymën e bashkëbisedimit. Në fillim unë e profesor Luigji paraqitëm nëpërmjet tekstit, videove e filmave tezat e studimit të ri, rezultatet e pjesëshme e pastaj u bënë diskutime e u dhanë mendime alternative. Gjithë kjo do t'i paraprinte një pune të zgjeruar në gjithë Mesdheun. Rritja e prodhimit të vajit të ullirit është një strategji globale, - mbylli fjalën e tij profesor Luigji.

Përfaqësuesi i KE-së i pranishëm, me specialistët e FAO-s, në fund të takimit pranoi sfidën e 'Kastel Blu' e të UM të Barit e garantoj e tha:

- Nëse rezultatet studimore në këtë bimë do të jenë të tilla, mbështetja financiare e institucioneve ndërkombëtare do të jetë e madhe. Jeni në qëndër të vëmendjes. Ne do të bëhemi që këtë vit mbështetës e garant i punës suaj.

Në ditët në vazhdim me profesor Luigjin punuam për të bërë pjesë të programit të ri të gjithë çfarë u tha aty. Në skemat fushore të studimit u bënë disa ndryshime përmbajtësore, për të nxitur verifikimin e shpejtë të tezave të work-shopit.

- Sot ty Rubi e Ofeli do t'ju jap edhe lajmin e fundit, - foli në takimin e vjeshtës profesor Luigji:

- Çështje ky lajm e si lidhet me ne? - ndërhyra unë.



- Në takimin e fundit të bordit nderinstitucional u vendos që, posa të bëhet aktiv i gjithë fondi i parashikuar, do të fillojmë menjëherë nga puna në vendet e Mesdheut ku kemi bazat tona vartëse si dhe të ngrejmë një të re. Ku do të thoni ju?

- Në Shqipëri, - fola unë.

- Po. Do të zbatojmë edhe aty tematikën tonë të re. Ti Rubi e Ofeli mendohet të jeni zbatuesit e mbikqyrësit e projektit.

- Kush do të financojë?

- BERZH dhe FAO.

- Kush e drejton?

- UM i Barit e qeveria italiane, spanjolle e franceze, por edhe shtetet e tjera që janë përfshirë në këtë studim të madh.

- Për ne është bingo?

- Pa diskutim po. E gjitha kjo i rrit vlerën punës tonë e autoritetin institucionit që përfaqësojmë në botën shkencore.

- Po këto shtete kanë dhe institucionet e tyre të linjës?

- Ato zbatojnë programet e tyre shkencore, ne do të kemi projektin tonë. Do të kërkojmë nga qeveritë e vendeve pritëse ndihmë e garanci për të siguruar një punë të qetë të specialistëve që do të angazhojmë në këtë sipërmarrje shkencore. Në Shqipëri parlamenti ka miratuar ligjin për shitblerjen e tokës që na krijon mundësinë e ngritjes të një baze tonën, që do të jetë bërthama e një ferme moderne të së ardhmes. Si 'Kastel Blu'.

- Po pronarët? - pyeta.

- Baza e ferma natyrisht që do të kenë nevojë për punëtorë e specialistë të mirëpaguar, ku të parët do të jenë ata.

- Pra baza do të jetë pronë e jona e ne do ta mbajmë nën vëzhgim të përhershëm?

- Po. Bile do të vazhdojmë edhe të investojmë.
- Në ç'drejtim?
- Për zgjerimin, modernizimin e prodhimit e në krijimin e një cikli të mbyllur si këtu.
- E ne do të vazhdojmë të jemi raportues të përhershëm?
- Po dhe programues e mbikqyrës të punës që do të bëhet atje.
- Kur mendohet të merret ky vendim?
- Shpresoj para fundit të këtij viti. Në janarin tjetër ju të filloni punën e re. Deri atëherë do të përgatisni materialin mbjellës për të gjitha bazat duke futur edhe atë të Shqipërisë. Ne do të nisim që heret të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në qeveritë e vendeve pritëse e ju do të jeni konsulentët e kontrolluesit e gjithë punës që do të bëhet atje. Bazat tona në Mesdhe duhen transformuar, ndërsa në Shqipëri duhet që gjithçka të nisë nga e para.
- Gjithsesi, ne punën shtesë për projektin europian e kemi nisur praktikisht, - foli Ofelia.
- Për çfarë e ke fjalën? - pyeti profesori.
- Për ndërhyrjen në mezokarpin e kokrrës së ullirit, në qelizat parenkimatike të tij ku formohen pikëzat e vajit e do të planifikohen studime, - sqaroi Ofelia.
- Si e mendoni ju këtë ndërhyrje?
- Ka pasur e ka shumë studime të mezokarpit në elementë si oleanoli, gliceridet e vartësia e sasisë së vajit në kokërr prej tyre. Por studimet nuk kanë qenë të plota. Nuk është provuar se në muajt korrik, gusht e shtator, kur bëhet shndërrimi i këtyre elementëve në vaj, sa ndikon agrofondi i përdorur në formimin e tyre. Kjo është një punë e vështirë e ndërvarur mes elementëve që përbëjnë jetën e kontrolluar e integrale të bimës. Do ndjekje periodike në gjithë spektrin e formimit të tyre e atëherë mund të arrijmë rezultatet e duhura. Jemi para një pune të lodhshme që do një kordinim



perfekt mes agrokultivuesve të bimës e specialistëve të analizës laboratorike. Uji, fondi ushqimor, ndriçimi diellor, temperatura e ajrit dhe e tokës do të jenë në limitet e tyre të kontrollit e të zhvillimit të proceseve në gjethe e mezokarp. Parametrat duhen gjetur e pastaj me kujdes e korrektesë profesionale të arrihen e të ruhen, - foli Ofelia.

- Po, por ia vlen një punë e tillë. Sikur në të gjithë prodhimin e ullirit kokërr të rritet rrezja e vaji me një përqind, sa ton vaji do të kemi më tepër se sot? A do të ishte një shërbim cilësor në të ushqyerit e banorëve të planetit? Kjo është detyrë e mision për ne, - mbylli bisedën e tij profesori.

* * *

- Shihe Korinën. Po shetit me Encon.

- Intersant! Sa shumë është lidhur djali me të. Sikur i ka ra me lëmsh kokës. Ajo i përkushtohet shumë. E ndihmon të vishet, të lahet, të hajë e pa u mërzhitur shetit me të. I ka futur dashurinë për tingujt e violinës e shpesh i tregon edhe përralla.

- Më the se i ka ardhur një ftesë për t'u paraqitur në një konkurs nga një orkestër në Bari?

- Më 6 prill do të paraqitet në komision. I ka ardhur edhe programi. Po përgatitet.

- Si do të bësh me djalin, nëse ikën Kori?

- Keq do ta kem deri në shtator. Kur të fillojë sistemi parashkollor do ta rregjistroj aty. Ka kushte të mira e orar të zgjatur.

Kora në datën e caktuar u paraqit në konkurs, por nuk e pranuan. Isha me Ofelinë e Encon kur erdhi e na tregoi. Ishte e mërzhitur.

- Si ndodhi? - e pyeti Ofelia.
- Kishin kërkesa shumë të larta. Ishim tridhjetë e tre konkurentë për dy vende.
- Mos u mërzit. Do të kesh edhe raste të tjera. Shih ofertat e përvoja e këtij konkurimi të të shërbejë si mësim.
- Një të dielë fundprilli kaluam paradreken në pyllin e kontit. Unë e Ofelia me djalin shetisnim në freskinë e natyrës që po rilindëte, ndërsa Korina përreth dy orë ushtrohej në violinë. Tingujt që lëshonte vegla u përzien me ata të pyllit e u kënaqem. Një simfoni e freskët. Këtë kisha dashur që herët tek Korina.
- Në fillim të qershorit ftohet përsëri për konkurim në orkestrën e një kische. Kur u kthye, ishte e kënaqur. Kishte fituar një vend punë me tri ditë në javë. Ndonëse me pagesë jo sa tek Ofelia, por si fillim mirë. Ishte në profesionin e saj.
- Deri sa të fillosh punën e re vazhdo të jetosh me mua. Merr patentën e makinës e të jesh e pavarur, e lirë në zgjedhjet tuaja. Dokumentat e qëndrimit në Itali i ke siguruar. Je vazjë e shkolluar. Nxirr mësim, se jeta mund edhe të vështirësohet. Qartë?
- Të faleminderit dokoreshë! - u shpreh Korina.
- Kur do të fillosh punë? - e pyeti Ofelia.
- Më 3 shtator, ditën e premte ora 15-të duhet të jem në sallën e kishës për të filluar provat me orkestrën.
- Deri atëherë merru me Encon e shpinë time. Me 10 korrik do të ikim për pushime në bregdet.
- Do të vish me ne?
- Po.
- Po pas pushimeve?
- Shpresoj që në gusht të marr patentën e makinës e të shkoj në Shqipëri. U bë kohë e gjatë që prindërit e mi nuk i kam parë. Nuk e dinë ku jam. Më kërkojnë.



Pashë që Ofelia e miratoi itinerarin e projektuar nga Korina.

Ditët në vazhdim u rrëmbeva nga puna në bazë, ajo praktike, dokumentare e studimore. Pothuajse çdo javë nga UM i Barit profesor Luigji kërkonte informacion për punën e rezultatet ku isha përfshirë. Ishin të çuditshme e më rrëmbenin me befasinë e tyre.

Më 15 qershor zbriti në bazë prap profesori. Isha në zyrë e po ndiqja një emision televiziv nga Shqipëria. Pas pak erdhi dhe Ofelia. Flitej për misionarin katolik Antonio Sharra në dioqezën e Sapës, në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë. Gazetari shetiste me kamerën e tij në kodra, fshatra e kudo dukej dora e kujdesi prej misionari i këtij njeriu me veladon. Kërkonte të mbilleshin kudo fidana ulliri.

- E njeh Rubin?

- Po. Më kujtohet që vjet në vjeshtë erdhi këtu me kontin e kërkoi fidana.

- Ti Rubin katolik je? - më pyeti Ofelia

- Nga familja po, por kur kam lindur, kishte një vit që ishin mbyllur kishat. Nuk jam pagëzuar e as krezmuar. Prindërit po. E ke vënë re që nuk i di mirë shërbimet kishëtare e sakramentet? Kur shkoj në Shqipëri, ndjek me nënën ndonjë meshë aty e në kishën e Shën Antonit në Kepin e Rodonit. Është një kishë interesante aty. Po pse po më pyet?

Kur dëgjoi pyetjen time profesori ndërhyri:

- Në hartën topografike kadastrale të përgatitur nga UM i Barit mendohet që aty, mes kepit të Rodonit ku është kisha e qytetit të Durrësit, të gjendet një sipërfaqe toke për ngritjen e bazës tonë e të ideohet ferma që do të ngrihet më vonë.

- Më bëhet qejfi profesor. Unë e njoh atë zonë. Që tani po mendoj për atë vend.

- Shumë mirë! Të jetuarit me detyrën gjithmonë sjellë sukses.

Pas një diskutimi të tillë profesor shikoi gjithë punën e bërë në bazë, dokumentacionin shoqëruar e në fund udhëzoi masat e veçanta në përgatitjen e fidejave për në Shqipëri, Spanjë, Greqi, Francë e Portugali, shoqëruar me dhjetë përqind shtesë si garanci.

- E qartë profesor.

- Kjo punë do shumë mund e dije, ndaj vlerësohen specialistët, - foli profesor e vazhdoi:

- Po në vendin tuaj, se nuk të kam pyetur, ke dëgjuar sesi janë trajtuar specialistët e bujqësisë?

Risolla në mëndje disa biseda në shpi të tim eti e mbi bazën e tyre formulova përgjigjen: - Shumë keq. Në mënyrën sesi ishte organizuar prodhimi bujqësor ata punonin shumë, ishin aty në shi, baltë, pluhur, vapë e suferinë e paguheshin mjaft pak. Më e keqja ishte se meritat e punës së tyre, dhe kishin mjaft, i merrnin drejtuesit politikë që në përgjithsi ishin injorantë. Shumë nga këta specialistë janë edhe dënuar, duke u ngarkuar faje të paqena mbi supet e brishta. Ishin gjithmonë nën goditje e nuk kishin kurrë orar pune e pushimi me një pagë qesharake. Argatë të shkolluar.

- Ty Rubin a të vlerësohet puna që bën? Si mendon? - pyeti hapur profesor.

- Jam shumë i kënaqur. Bile në ata kufij mirëbesimi që nuk e prisja.

- Pse nuk e prisje?

- Jam ende i ri dhe emigrant.

- Kjo, se konti e institucioni ynë e vlerësojnë punën që bëhet këtu. Nuk duan t'ia dinë për origjinën, ngjyrën e fenë. Tek ne vlerësohet puna e qëndrimi ndaj saj. Jetojmë në kohë moderne.



- Ju jam mirënjohës! - fola e heshta.

Pashë Ofelinë që dëgjonte me vëmendje të shtuar fjalët e profesorit për mua. Si jashtë formatit të saj. Ishte zgjuar tek ajo ndjesia për mua. U gëzova. Ajo është një vlerë njerëzore e veçantë që, sipas meje, duhet respektuar e ruajtur, bile edhe dashur. Nuk e di se si mund të jetë më tej kjo grua, por, gjithsesi, është ndryshe nga ata që kam njohur deri më sot. Dhe e dua shumë.

Në ditën e fundit të gushtit Korina përgatitet të shkojë në punën e ofruar nga famullia, diku larg prej nesh e kërkoi ndihmë: - A mund të më shoqëroni deri atje?

- Le të vijë Rubi, mbase ju ka mbetë ndonjë fjalë pa thënë, - foli duke qeshur Ofelia.

Pasi ngarkuam valixhet e çantat, Korina u nda me lot në sy me Encon edhe me Ofelinë. U nisëm. Ora ishte dhjetë paradite.

- Është larg prej këtu? - pyeta.

- Me autobus pothuajse një orë, - u përgjigj Korina e vrenjtur në fytyrë.

- Më dukesh e pakënaqur nga ky largim?

- Po iki nga qyteza pa realizuar qëllimet e mia.

- Unë mendoj se realizove mjaft prej tyre, legalizove dokumentat e qëndrimit në Itali, more patentën e makinës e sigurove një mbështetje financiare të mirë.

- Po kjo nuk është kryesorja.

- Pse ku doje të arrije ti?

- Të doja ty. Të gjithin si në shkollën e mesme.

- Aventurë! Daulle e shpuar që nuk e dëgjojnë më veshët e mi.

- Por unë shpresoja.

- Edhe kështu, në paudhësinë tënde, të ndihmova? Apo ti nuk e konsideron të tillë?

- Po të falemnderit, por kërkoja që të thyeja vendimin tënd ndaj meje.

- E ke gabim. Po të kisha bërë unë një gabim si i joti, ti apo çdo shpirt gruaje do të më kishte vrarë. Unë jo. Në rastin tënd më të keq të ndihmova. Edhe kaq mjaft. Bëra të pamundurën.

- Edhe Ofelia kështu më ka thënë, - ndërhyri Kori.

- Ajo është bijë Siçilie e zotëron një kod të veçantë dashurie ndaj burrit.

- Cili është ky kod?

- Çdo vajzë e lidhur në martesë e do burrin mbi gjithçka, mbi prindërit e fëmijët, ai bëhet ylli i saj polar.

- Po jashtë këtij kodi?

- Shumë vajza, sipas Ofelisë, janë dënuar, bile edhe vrarë.

- Po me Ofelinë sa të lidhur jeni? - pyeti si me inat Korina.

- Me Ofelinë më lidhin shumë gjëra, shtrati, djali, puna në bazë, laboratorit, studimet e së fundi dhe projekti i madh europian që të dy të jemi pjesë e tij. Lidhje shpirtërore, mendore e pune.

- Nuk të vjen keq që e ke lidh jetën tënde me një grua dhjetë vite më të madhe se ti?

- Jo, bile nuk më shqetëson fare. Mendësi e kaluar, e papërfillshme.

- Si kështu?

- Po me një vajzë të re e konsumova dashurinë time, vrullin, egërsinë, kafshërinë e sot nuk më gëzojnë. Dua gjëra të tjera. Njeriun. Kuptoje se mbase dhe ty të vlen.

Korina heshti. Shikonte rrugën përpara. Kafshonte disi buzën. Era që hynte nga xhami i makinës luante me flokët e saj.



- Kalo djathtas, - foli. Rruga që më tregoi Korina ishte anash një kodre mbuluar me ullinj e vreshta të ngarkuara me prodhim. Fillim vjeshte.

- Pijmë një kafe, - propozoi ajo kur para nesh u shfaq një lokal.

- Vend i bukur, - foli unë.

- Desha që në këtë fundshoqërimi të pijmë një kafe bashkë, se nuk e di ku e kur mund të takohemi më, e në shenjë mirënjohje e respekti që tregove ndaj meje në qytezë. Unë vërtetë kërkova shumë prej teje, t'u dhashë me gjithçka kisha që në takimin e parë këtu, por ti nuk luajte nga pozicioni i ngurtësuar ndaj meje. Gjithsesi, të uroj gjithë të mirat! - mbylli zemërthyer bisedën Kori.

Pas kafesë shkuam tek famullia. Një murgeshë i doli para. E ndihmova të çonte valixhet e çantat në dhomën që i treguan e u ndamë. Në kthim më erdhi keq për Korinën që e mbylli veten, mbase përkohësisht, në një ambient të tillë. Në shoqëri murgeshash. Nuk ishte tip i tillë. A do ta duronte ajo këtë lloj jete? Mbase do t'i bënte mirë!

Të nesërmen me Ofelinë dërguam në shkollë Encon. Festë për ne e hidhërim për djalin. E pranoi me vështirësi regjimin e ri. Do të mësohet ai, por edhe ne.

- Në orën 16-të ejani ta merrni, - foli kujdestarja e qeshur.

Diku para afatit të paralajmëruar, sapo mbaroi punën, pashë që Ofelia u nis drejt qytezës. Kujdes i sinkronizuar nëne. Në vazhdim po kalojmë shpesh gjithë kohën bashkë. Luajmë me Encon e në ditët e pushimit dalim në pyll a shetisim në shesh. Rifillova vrapin e darkave. Shpesh luaj basketboll në palestër. Filluan të vinë si spektatorë Ofelia me Encon. Më duartrokisnin deri sa mbaronte loja. Gëzohesha për praninë e tyre.

Gëzoheshin edhe ata për mua.

AKTOR I PROJEKTTIT

Më pesëmbëdhjetë dhjetor, sipas paralajmërimit, erdhi në bazë profesor Luigji. Filluam menjëherë nga puna përgatitore. Veçmas për bazën e re në Shqipëri. Me vendet e tjera të Mesdheut na mbetet të përmirsojmë bashkëpunimin me metodikë të re, krejt ndryshe nga herët e tjera.

- Janë gati metodikat e kontratat. Të gjithë dokumentacionin shoqërues e keni në dosje: shqip e italisht. Ndiq procedurën e caktuar. Ndhmës me ty do të jetë atasheu ekonomik i ambasadës tonë në Tiranë. Mos lini asgjë mbrapa pa kryer e përmbushur. Është provë për ty që kërkon vëmendje e aftësi. Këtë radhë si specialist je i vetëm. Është prove kujdesi, durimi, dijesh, vendimarrje e gjakftohtësie.

Profesori kur përpërfundoi ngriti kryet nga letra që kishte përpara, më shikoi në sy, pastaj Ofelinë e foli prap:

- Në korrik e gusht, kur do të marrim të dhënat e para do të jeni me Ofelinë në Shqipëri. Qartë?

- Dakord! - folëm me një zë unë e Ofelia.

-Sot është 15 dhjetor, më 19 dhjetor mendoj që të nisesh në Shqipëri. Të kalosh Krishtlindjet atje me njerëzit e tu e në prag të Vitit të Ri të keni përcaktuar të gjitha masat e duhura që pas festës të nis puna për bazën tonë të re.



- Qartë?

Shikova në sy profesorin, pastaj Ofelinë. Më inkurajonin të dy. Kishte hedhur besimin e tij tek unë.

Ditët që më kishin mbetur u mora me përgatitjen për misionin në Shqipëri. Më ndihmonte edhe Ofelia. Lexova edhe një herë gjithë procedurat ligjore e praktikat për përgatitjen e provës fushore e gradualisht formova një ide të plotë se ku do ta filloja këtë përpjekje të re e të veçantë.

Më 19 dhjetor u nisa. Porti ishte rregulluar disi. Kur arrita në Sektor, tek dera e oborrit ndalova, hapa dy kapakshen, u futa brenda e atëherë pashë nënën. E trazuar nga zhurma doli në treme. Ishte ditë dhjetori e frynte një erë e ftohtë.

- Si je nënë? - e pyeta.

- Mirë, o djali i nënës. Që kur më njoftove se do të vije minutat më dukeshin të gjata.

U përqaftuam me mall e shikoja se si ishte transformuar shpia e vendi ku ishte ajo. U futëm brenda me çanta e valixhe në krah.

- Mirë je nënë? Ke ftohtë?

- Jo bir! OXHAKU rri gjithë kohën ndezur.

- Shumë mirë! Shpia duhet të jetë e ngrohtë në dimër. Pse i thonë e 'ëmbra shpi'?

- Je e kënaqur nga rregullimi i oborrit e gjithçka tjetër përçark sajë?

- Po bir! Punëtorët që sjell Edi punojnë mirë si në pemtore edhe në serë. Unë kujdesem më shumë për pulat.

Qesha. E dija që nuk i rrinin duart asnjëherë rehat.

- Gjithçka është mirë, sera, depozita e ujit e ullinjtë.

- Pemët do t'i krasis pas vitit të ri.

- Edhe kështu mirë janë, por ti e di më mirë.

- Prodhuan këtë vit?

- Po mjaft mirë. Mori edhe Maksi.

- Të kam sjell një bidon vaj ulliri. por nga ai i miri fare.
- Po Maksit?
- Edhe Maksit.
- Të keqen nëna, po shkon nga tridhjeta, a mendon edhe ti për një nuse? - foli ajo e shqetësuar.

- Më ka marrë malli për një drekë nga duart tuaja, - i foli, duke ndërruar drejtimin e bisedës me të.

Të nesërmen me nënën u nisëm drejt Tiranës. Në farmaci takuam Maksin. Kishte marrë lejen e ushtrimit të profesionit. Pas pak erdhi dhe Uelda me vajzën. U gëzova me të. Lashë aty nënën e dola. Takova tim atë. E ndjente vetminë. Moskomunikimi me Maksin e gërryente së brendshmi. Në aneksin e dyqanit ku po rrinim, erdhi edhe e shoqja me djalin, gjysëm vëllain tim. Luajta me të. Në pamje gruaja e tim eti ishte më e re se nëna dhe e mbajtur mirë.

- Mirë po e kaloni?

- Po. Paguam të gjitha borxhet e mendojmë të fillojmë një shpi të re në kodrën mbrapa dyqanit.

- Më vjen mirë. Edhe shpinë në Sektor e kemi rregulluar mirë.

- E kam marrë vesh e u gëzova. Po pse ke ardhur? - pyeti.

Kur i tregova misionin tim, ai mori një pamje urtie e foli:

- Bravo të qoftë! Ec përpara me guxim e pa u thyer. Ky sukses është vetëm i yti. Ndjehem krenar!

Pasi u ndava më babanë, u gjenda në dyert e ambasadës italiane. Takova atasheun kulturor e ekonomik e biseduam gjatë. Paraqita gjithë dokumentacionin që kisha me vete. Në Ministrinë e Bujqësisë na priti zevëndës ministri. Lexohet protokoli e firmoset aktmarrëveshja ngjitur duke



mbyllur edhe datën 20 dhjetor, ditën e parë në misionin tim të ri.

Të nesërmen më 21 dhjetor u gjendëm në ILB me dy nëpunësit e ambasadës. Takuam zevëndës dekanin dhe Stefanin, pedagogun që kishte qenë në leksionin tim në UM të Barit.

Pas takimit paraqita arsyet e ardhjes e programin:

- Diku këtu do të ngrejme një bazë eksperimentale europiane nën drejtimin e UM të Barit.

- Shumë mirë! - tha zevëndës dekani që vazhdoi: - si mund t'ju ndihmojmë?

- Do të kemi nevojë të bëjmë analizat grimcametrike e agrokimike të tokës ku do të ngrejme bazën. Paguajmë pa problem.

- Tjetër?

- Na duhet edhe një specialist i kualifikuar si frutikulturist, por edhe organizator e komunikues në italisht ose anglisht. Do të lidhim me të një kontratë pune 15 vjeçare.

- Për kërkesën e parë, problemi është i thjeshtë, sa një praktikë laboratorit me studentët, ndërsa i dyti ha shumë diskutim.

- Pse? - ndërhyra unë.

- Sipas kërkesave tuaja është e vështirë të gjenden kandidaturat që kërkoni.

- Është një i papunë, ish pedagog që mund të jetë një kandidaturë e përshtatshme për ju, - foli Stefani nga ku dëgjonte.

- Pse është i papunë? - pyeta.

- Se ka mendimet e tij dhe është me titull shkencor, personalitet, inat mes kolegësh, - sqaroi po Stefani.

- Po të tjerë konkurentë? - pyeta prap.

- Janë edhe dy pedagogë me kohë të pjesëshme, - plotësoi zëvendës titullari.

- A mund t'i takojmë nesër e t'i marrim në intervistë të tre, - foli.

- Posi. I njoftojmë ne.

Shoqëruesit e mi të ambasadës mbetën të kënaqur për rrjedhën e shpejtë që morën bisedimet. Përpilua më bashku tezat e intervistës e u ndamë. Unë shkova te Maksi ku ishte edhe nëna e kaluam një darkë të mirë mes nesh. Të nesërmen në orë 9-të në një klasë të Institutit, morëm në intervistë tre kandidatët e lajmëruar. Leonard Shtjefni, ishte kandidatura më e përshtatshme për punën tonë dhe pa e zgjatur lidhëm kontratën e punës me të.

Kur në zyrën e dekanit dhamë rezultatet e intervistës e vendimin tonë ata u habitën.

- Na dhatë një mësim të mirë sesi zgjidhet drejt një detyrë si kjo, - foli ai.

- Siç duket Rubini paske marrë shumë nga Europa, - tha me të qeshur sekretarja.

Unë heshta, por brenda ziejta nga inati.

- Nëpër këto rrugë kam kaluar edhe unë atje. Asgjë nuk të falë kush, por duhet ta fitosh me shumë dije e punë, - foli e heshta.

Ua përktheva shoqëruesve të ambasadës dialogun e ata qeshën duke luajtur kryet. E kuptuan thelbin e gjithë bisedës e miratuan qëndrimin tim. Prisnin ndoshta një reagim tjetër për çfarë kishte ndodhur vite më parë me mua. Por jo. Nuk më interesonte ai incident i tejkaluar. Unë arrita çfarë desha.

Të nesërmen ne të tre dhe Leonard Shtjefni ishim në komunën e Sektorit. Kryetari i komunës, kur i paraqitëm dokumentat e i treguam arsyen e vizitës, u gëzua shumë e ishte gati në gjithçka që ky projekt të realizohej aty. Vuri në dispozicion përgjegjshin e kadastrës, topografin e hartat



topografike kadastrale të nevojshme. Pas një pushimi të vogël në kafe u ndamë me të.

U zhvendosëm ngadalë duke kontrolluar gjithë tokat arë në faqen perëndimore të kodrave në drejtim të Kepit të Rodonit. Krahasonim pamjet në natyrë me ato në hartë. Shënuam disa pika. Bëmë disa kontrole direkt në fushë. Donim një tokë me cilësitë e kërkuara. Më në fund gjetëm një hapësirë që ramë dakord me Leonardin se ishte më e mira. Pyeta topografin:

- Sipërfaqja?

- 3.5 ha. - u përgjigj ai.

- Pjerrësia?

- 2 deri 7 përqind, me kundrejtim nga perëndimi.

- Po sipërfaqet përçark sa hektarë janë pa u shkëputur, bllok?

- Rreth treqind hektarë, - u përgjigj pas pak ai.

E unë risillja në mendje porosinë e profesorit që të mendohet me kohë mundësia që baza të jetë qendra apo bërthama e zgjerimit drejt një ferme të madhe, sipas modelit të 'Kastel Blu'. Kjo kërkonte toka të lira. E kështu po ndodh. Kontrolluam me sy përbërjen mekanike, bimësinë spontane, burimet ujore, kufijtë natyrorë e mbajta shënime se çfarë duhej rregulluar. Bëra detyrën.

- A ka këtu rreth ndonjë ujëmbledhës? - pyeta.

- Po, por është dëmtuar e mban pak ujë.

Mbajta shënim një mundësi të re për funksionimin e fermës së ardhëshme.

- Ku mund ta gjejmë pronarin e kësaj toke, - pyeta përgjegjësin e kadastrës.

Kur ai më tregoi emrin e tij, u sqarova me veten. Mark Bushi, pronari i tokës sipas ligjit shqiptar 75-01 është një i afërt i Edit, inxhinierit që më ndërtoi shpinë.

- I ka dokumentat e tokës ky Bushi? - pyeta.



- Po.

- Duhet ta takojmë që sot, - fola dhe ua përktheva bisedën edhe punonjësve të ambasadës. Të dy e miratuan mendimin tim.

Para se të shkonim në zyrat e komunës, hodha edhe një herë sytë rreth e qark asaj hapësire ku do të jetë puna jonë për një kohë të gjatë. Kudo djerr. Më erdhi keq. Para 10 vitesh këtu kishte një aktivitet të madh bujqësor. Çkishte ndodhur?

- Ligji 75-01 ka shkaktuar hemoragji njerëzore, veçmas rinia po emigron në masë, - ndërhyri Leonardi.

- Fshati po boshatiset. Shqipëria po boshatiset. Si kështu? Kush do ta kultivojë tokën? - pyeta.

Marku më priste te zyrat e komunës. Ishte një burrë rreth 50 vjeç, i qetë, me dy sy që të shikonin drejtpëdrejt. Kur i dhashë dorën gishtat e dorës së tij të vrazhdë më gricën timen. E kuptova se kisha të bëja me një njeri të munduar në punë. Kishte gjashtë fëmijë të vegjël. E kuptova pa filluar se biseda me të duhet të ishte e kujdesshme, e matur e me shumë dashamirësi. Tolerante.

- Mark si je? - e pyeta kur u takuam.

- Keq, - foli.

- Pse?

- Pa punë. Pa lek. Pa asgjë. Varfëri.

- Po ke tokë?

- Kam, por është larg e duhen pare ta punoj, ta mbjell e shumë shpenzime të tjera. Pa vlerë del gjithshka.

- Po sikur ta blejë dikush?

- Ia jap me të dyja duart.

- Sa mund të jetë çmimi sipas teje?

Kur e tha çmimin u habita. Kërkonte shumë pak i shkreti njeri për një tokë që do të bëhet model prodhimi. Gjithçka nga halli e padija.



- Po sikur të japin dhjetë herë më shumë për tokën e me ty të lidhim një kontratë të përhershme pune aty?

Burri fërkoj sytë e i menduar m'u drejtua:

- Mos u tall me mua fukaranë.

- Jo e kam seriozisht. Dua që tokën tënde ta blejmë e ti të jesh punëtor i parë i saj.

Marku u habit me çfarë po i dëgjonin veshët. Zuri vend mirë në karrige e pyeti:

- I kujt je ti, o djalë?

Kur i tregova, ai heshti, e pas pak foli: - Mësuesi?

- Jo. I vogli.

- Po ai me sa di ka ikë ndër të parët me ambasadat jashtë shtetit?

- Kam ikë, por tashti u riktheva.

- Po ndryshe nga të tjerët. Jeni racë e zgjuar. Të kam njohur edhe gjyshin, Lekën e ndjerë.

- Si do t'ia bëjmë me tokën?

- Bëj si të duash ti, të besoj se nuk ma ke me të hedhur, - foli i dorëzuar burri i ngratë.

Gjithë bisedën ua përktheva shoqëruesve e menduam që është një rast i mirë të kryejmë detyrat tona e të nxjerrim nga e keqja një familje.

- Atëherë të bëjmë kontratën e blerjes. Kjo do të rritë dhe besimin e njerëzve tek ne e projekti, - foli mes grupit.

Mendonim për fillimin e shpejtë të detyrës.

Më 27 dhjetor u miratua kontrata e gjithë projekti në mbledhjen e këshillit të komunës ku ishin të pranishëm dhe punonjësit e ambasadës italiane. I hapet rruga fillimit të punës në bazë pas Vitit të Ri.

Po para Viti të Ri Marku mori lekët e tokës e lidhëm kontratën e punës me të. U gëzua. Edhe unë u gëzova për Markun e fëmijët e tij.

I dhashë detyrat ndërtuese Edit. Rrethimi i gjithë sipërfaqes prej 3.5 ha me rrjetë teli e ndërtimi i portës hyrëse, të themeleve të depos e zyrave, të vendosjes së pompave të ujit e rrjetit hidraulik, të rrjetit elektrik e vendosjes së transformatorit e bazamentit të gjeneratorit. I dhashë detyra edhe Leonardit.

Në heshtje urova veten: - Fillim të mbarë e me pak pengesa!

Më 7 janar u ktheva në bazë. Makina, eskavatorë, hekura çimento e punëtorë me në krye Edi inxhinierin, po i jepnin jetë projektit të ri. Koha e mirë e favorizonte kryerjen shpejt të punimeve. U gëzova. Pas një jave muri rrethues e shtesa prej rrjete teli mori formë. Filloi edhe ndërtimi i portës kryesore e në vazhdim, bazamenti i ndërtesave administrative brenda rrethimit. Unë e shoqëruesit e mi u ndjemë të kënaqur. Puna po ecte mirë. Kur përfundoi së ngrituri porta, mora në punë edhe dy punëtorët e parë, roje objekti. Ditën Marku e natën një tjetër.

Gjatë kohës që punohej në bazë, u nisa për në periferi të Athinës. Atje puna ishte ndryshe, baza ishte e ngritur, funksiononte. Materialet shkresore dërguar nga ne ishin në dorë të punonjësve shkencorë që ishin në pritje të materialeve mbjellëse. U ndjeva i kënaqur. Gjithçka ndryshohej me firmën time. Më nderonin, megjithse e dinin se isha shqiptar. E bënë mirë detyrën ata.

Kur u riktheva në Shqipëri, baza po ngrihej. Po sistemohej sipas skemave. Edi me skuadrën e tij kishte mbaruar së ngrituri edhe rrjetin elektrik. Gjithçka mbyllej brenda portës.

Në fund të janarit erdhën kontenierët me konstruksionet e depove, zyrat, gjeneratorin, transformatorin e u shkarkuan në vendet e tyre. U montuan e u bënë funksionale. Tashti kishim këtu edhe zyrat e magazinat. Inxhinieri hidraulik



njoftoi pas shpimit se uji ishte i bollshëm për ujitjen e tepronte. Në darkën e 27 janarit u ndezën dritat në ndërtesat e bazës tonë studimore. Porta hapej e mbyllej me pult komandimi. Rruginat e qarkullimit brenda bazës e ata jashtë saj deri poshtë tek rruga ekzistuese ishin shtruar me gurë, zhavor e çakëll.

Pas sistemimit, toka e bazës punohet, merrren kampionet për analiza e dërgohen në laboratorin e Institutit Bujqësor. Topografi piketon vendmbjelljet e pritshme nën kontrollin e Leonardit që tashmë kishte marrë komandën e gjithë punëve të bazës.

Më 4 shkurt vijjnë kontenierët e tjerë ngarkuar me fidanët që kisha çertifikuar me Ofelinë në ‘Kastel Blu’. Ishte edhe firma ime aty. E kontrolloi atasheu ekonomik i ambasadës zoti Batisti, njohu firmën time e qeshi:

- Ja ku na erdhi edhe puna jote në fermë. Bravo të qoftël! Punë e bukur, ta kam zili! Nuk janë më të nderuar se ti e puna jote as arkitektët, piktorët e muzikantët. Duart e mendja jote janë më të harmonizuara se ata të një skulptori. Kudo shihet një praktikë shkencore e kulturuar. Të lumtël!

Heshta para këtij njeriu të nderuar që po më shoqëronte ditë me radhë mua djalin shqiptar me pasaportë italiane. Ishte misioni im i parë si njeri i ditur. E jam në vendin tim ku emocionet, duart e mendja luajnë ëmbël me respektin për njerëzit që takoj. A janë të kënaqur nga unë Leonardit, Marku e të tjerë?

Me mendime të pafundme ndjek mbjelljet e fidanave. Baza fillon e merr jetën e gjelbërt që projektova diku larg, në ‘Kastel Blu’.

- Pse të mos vijë kjo provë edhe në Shqipëri? Çfarë i mungon këtij vendi që e shoh të laskaruar? Ta fillojmë me këtë qelizë zhvillimi të përparuar. Si në Europël - mendoja.

Me 14 mars përfundoi e gjithë puna në bazë. U vendos në ballë të saj edhe tabela ku shkruheshin me bojë vaji në një llamarinë të trashë të dhënat kryesore të objektit.

Më 15 mars pres në Rinas profesor Luigjin e shkojmë drejt bazës. Te porta Marku me detyrën si roje na ndalon e bën kontrollin e fletë hyrjes. Profesori qeshi.

- Rregulli, - fola unë.

- Kështu do ta sjellim këtu atë që është ngritur me shekuj në 'Kastel Blu'.

Pas parkimit të makinës i paraqes profesorit Leonardin, përgjegjësin e bazës. Nga ku jemi, shohim gjithë rrethojën, bimët e mbjella sipas skemave, tubat e ujitjes me pika të shtrira sipas rreshtave, zyrat e magazinën. Gjithçka sipas projektit. Para nesh deti na përshendet me valët blu.

- Bravo! Keni bërë zgjedhjen e duhur e punë të bukur, - i përmbloodhi me një fjalë gjithë vlerësimet e tij profesori e vazhdoi:

- Presim rezultatet e studimit. Ky është fillimi i kësaj pune me mision përmirsimin e jetës së njeriut. Më shumë se kudo kjo duhet në Shqipëri. Në fqinjën tonë të vogël.

U gëzova nga fjalët inkurajuese në drejtim të vendit tim.

Profesori hodhi sytë jashtë bazës e nga shqetësimi i tij nxori pyetjen:

- Edhe rrugës nga erdha, edhe këtu, kudo shoh toka të lëna djerr, nuk kultivohen. Pse kështu?

U ndjeva keq me qëndrimin e njerëzve të mi, por gjithsesi edhe kjo e ka shpjegimin e vet.

- Sistemi superkolektivist e vrau punën duke e kthyer në dënim, - fola.

- Po ai sistem iku, e unë pyes pse ky qëndrim ndaj punës me tokën? - vazhdoi profesori.



- Toka nuk shkoi tek pronarët, copëzimi e demotivoi punën me të. E ktheu popullsinë e fshatit në argat. Cënoi biznesin.

Këto e harrimi nga shteti i kësaj pjese të popullsisë e i prodhimit kombëtar që siguron ajo e vunë në mendime profesorin.

- Do ta pësojë keqas vendi yt. Fshati do të boshatiset nga njerëzit. Do të krijohen shumë probleme sociale, bile të pandreqshme.

- Kanë filluar, por shteti, një zgjatim i bojatisur i atij të përmbysur, punon keq, mjaft keq. E sheh fshatin si bezdi e bujqësinë pengesë në drejtimin e saj të keq. Koncept i prapambetur.

- Dhe baza jonë vjen në të kundërt të asaj që ndodh këtu? Shqiptarët po braktisin fshatin, ndërsa ne po ngrejmë bërthamën e një ferme të madhe për prodhimin modern. Mision historik i yni ky? Gjithsesi duhet kapur koha, - mbylli shqetësimin e tij profesori.

* * *

Pas punës në Shqipëri, Greqi, Spanjë, Portugali e Francë iu riktheva punës në 'Kastel Blu' me eksperimentin 3, punë që do të ndiqej së bashku me Ofelinë e fiziologjen Iris. Një treshe që me kohë po përgatiteshim për ndërhyrjen e thellë në qelizën bimore. Bëhej punë me kujdes e kontroll të rreptë, me siguri të madhe. Ishte përcaktuar disiplina shkencore sa kohë materiali bimor përpunohej në laborator, kur kalonte nga laboratorin në serë e pas një viti në bazë, nën ndikimin e lirë të faktorëve natyrorë. Kontrolluesit elektronikë në ambientin e mbrojtur njoftonin për çdo

tregues brenda saj. Më vonë do të kontrollohej edhe dinamika e rritjes.

Qarkullonin mijëra pikëpyetje, dyshime e pandehma për këtë ndërhyrje, për rezultatet e saj: Sa do të jetë rritja e qasja ndaj kushteve të jashtëzakonshme bimore? Po në bazë a do të ndjehet niveli i rrezatimit, a do ta ruajnë këtë vlerë fidanat pasardhëse?

Jetonim si në ethe, në korridoret e rrezikut, të fitores e me hamendësimin e dështimit. Shpresojmë se kemi zgjedhur një rrugë suksesi.

- A kemi të drejtë të shpresojmë në ndryshimin e natyrës bimore? - pyeti profesori që me kujdes ndiqte këtë eksperiment të rrallë. Ishte i përzierë në shqetësimet tona. Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Ai ishte mbështetësi shpirtëror i këtij ndryshimi.

- Pse pyet? - ndërhyri Iris.

- Shumë bimë e kafshë për nevojat njerëzore janë ndryshuar apo përmirsuar disi në funksionalitetin e tyre. Kjo a mund të ndodhë edhe tek qeliza e ullirit. Si thua ti Rubi?

- Po. Sot njeriu ka fituar shumë dije. Pse të mos e bëjë më të mirën që di?

- Diku nga vjeshta do t'i verifikojmë ndryshimet e para.

- Siç tha doktoresha Iris, do të kontrollohet energjia rritëse e pastaj në fushë fazat e tjera të zhvillimit deri tek frutifikimi i parë simbolik.

- E kuptoni çdo të thotë kjo ndërhyrje në fshehtësitë e mekanizmit bimor? - pyeti profesori.

- Po. Lindjen e inxhinierisë së qelizës bimore, - foli doktoresha Iris.

- Ne po e fillojmë me ullirin, të tjerët diku tjetër. Natyra na ka ofruar një pasuri të pafund. Si duhet përdorur? - lëshoi pyetjen përmbyllëse me ne profesori.



RIKTHIM ME OFELINË NË SHQIPËRI

- Ja dhe faza e parë e këtij studimi mbaroi. Po tani? - pyeti profesori.

- Pse pyet, - ndërhyri Ofelia.

- Pyes, se puna juaj si grup ka qenë kohë e ngarkuar pak si tepër. Pa orar, me trazime e të papritura, bile me situata edhe të pakëndshme. Unë i di të gjitha e...

- Vërtetë kështu ka qenë, por këtij regjimi i jemi nënshtruar me vullnetin tonë. Disiplina e punës që bëmë e që do të bëjmë. Suksesi do edhe sakrifica.

- Dakord jam dhe unë e bisedova me kontin që si grup të bëni një pushim disi të gjatë. Në vjeshtë ju presin detyra të tjera, më të vështira, - foli profesori.

- I kemi hyrë kësaj pune profesor, vështirësitë e lodhja nuk na pengojnë, - foli Ofelia.

- Si e mendon doktoresha Iris vazhdimin, - pyeti prap profesori.

- Të realizojmë atë që kemi menduar që në nisje. Me durim e vullnet.

Pas këtyre përgjigjeve që mori, profesori na shikoi në sy të treve. Qeshi e i mbushur me besim foli: - Më gëzon ajo që thoni ju e vazhdoi:

- Ne si katedër, bordi e konti jemi të kënaqur me punën e kryer. Ju e dini se nga 10 korriku deri më 20 gusht jeni të

lirë, do të pushoni. U kërkojmë të shkarkoheni edhe emocionalisht e sezonin e vjeshtës të jeni të freskët. E dini se ç'punë ju pret në vazhdim?

- Unë e Ofelia do të shkojmë në Shqipëri. Do të kalojmë pushimet atje. Nga aty do të fillojmë edhe fazën e dytë të studimit. Irisi këtu në serë. Pastaj të tre do të bashkohemi në bazë. Do të presim e përpunojmë të dhënat që do të vijnë nga bazat e tjera e t'i përpunojmë.

Kur fola kështu pashë në sy profesorin që dëgjonte me kërshëri.

- Mbase do t'i ndërrojmë edhe emrin bazës mëmë. Po si? - vazhdova unë.

- Mendojeni, pse jo, - u shpreh profesori e...pushime të këndshme! -uroi ai.

Më 10 korrik, pa humbur kohë, u nisëm. Kur zbritëm në Durrës, vazhdonte të ishte rrëmujë e madhe. Dola në rrugët e qytetit e pa u ndalur askund eca në autostradë. Disi më mirë. Pas meje në ndenjësë Ofelia e Enco shikonin jashtë xhamave të makinës. Në Vorë dolëm nga autostrada. Ecëm në rrugën e paasfaltuar, gjithë gropa e pluhur. Tronditeshim, por shoqëruesit e mi heshtnin.

- Ja edhe shpia ime, - fola së fundi.

Enco e Ofelia orientuan sytë në kodër ku muri rrethues mbyllte disi pamjen. Ndalua para portës. E hapa. Hymë brenda rrethimit. Zbritëm afër shkallëve të shpisë.

- Sa bukur, - foli Ofelia e vazhdoi:

- E gjithë ky rregullim është bërë me ndërhyrjen tënde?

- Po, vërtetë.

Ndërkaq nga pjesa tjetër e shpisë erdhi nëna. U përqafova me të dhe i paraqita shoqëruesit e mi:

- Kjo është Ofelia, shoqja ime e punës, ky është Enco, djali i saj.



Nëna u tregua shumë e afërt, ndonëse nuk e dinte gjuhën e tyre dhe foli:

- Urdhëroni! Mirë se erdhët!

Në dhomën e ndenjës zëmë vend. Si e zonja e shpisë na nxori biskota me koka kola e rrinte në këmbë duke qeshur.

- Eja ulu. Mos rri në këmbë, - i foli.

U ul afër meje e shikimin e kishte tek Enco, tek ftyra, sytë, balli, flokët, vetullat, goja, mjekrra e hutohej. Edhe kur hynte në bisedë, nëna vazhdonte të shihte djalin. Seç i kujtonte. Po çfarë?

- Do të rrimë këtu deri në fund të gushtit. Do të pushojmë në bregdet e do të bëjmë disa punë atje te baza jonë, te Marku.

- Me Markun ke bërë shumë mirë. Ka një tufë me kalamaj, por është edhe njeri i mirë. Mbjaj mend që në vitet kur u prish ndërmarrja, ky nuk mori asgjë, kur të tjerët shkatërruan e rrëmbyen çfarë mundën.

- Do të fillojmë që nesër. Do të vish edhe ti?

- Jo kam punë.

- Leri punët. Të kam thënë merr punëtorë. Nesër vjen këtu edhe Maksu me Ueldën e vajzën. Do të rrinë 20 ditë me ne. Jam rikthyer për të pushuar e gëzuar me ju. E shikon, kam marrë dhe shoqen më të mirë me të cilën punoj atje.

- Dakord! Nesër po pres Maksin. Pasnesër ikim së bashku.

- Tani na bëj drekën. Kemi uri. E dua nga duart tuaja. Si dikur.

- Çfarë doni?

- Sallatë perimesh nga të kopështit, djathë e ...

- Kam edhe një tavë me patate e mish pule të pjekur në furrë.

- Oh sa mirë!

- Shkoni sipër e sistemohuni sa të bëjë nëna tavolinën gati.

Siç tha nëna, bëmë. Në njërën nga dhomat sipër ku kishte një shtrat të madh e një të vogël vendosëm rrobat në dollap. Edhe Ofelia u vesh si për pushime e zbritëm pas pak poshtë të lehtësuar. Na priste tavolina e ngarkuar, ku nuk mungonte as frutiera me dardha e kumbulla.

Kur mbaruam ushqimin e po shijonim frutat, i them nënës: - Të lumtë dora! A e di se si tha Ofelia për sallatën?

- Çfarë?

- E mrekullueshme! Më kujtoi perimet gjysëm të egra, por shumë të shijëshme të kopshteve të Siçilisë.

Pas dreke pashë rreth shpisë me Ofelinë e Encon. Nëna na shoqëronte e qeshte. Të nesërmen u nisëm drejt bregdetit. Takimin e parë tek baza, tek detyra. Ndalova makinën para derës. Marku ma bëri me dorë të futesha brenda, por unë prita të kontrollonte dokumentat.

- Jo Mark, bëj detyrën.

- Që në kthesë e njoha makinën tënde dhe u gëzova që po të shoh.

I përktheva Ofelisë historinë e Markut dhe fjalët që më tha. Ajo qeshi e tundi kryet. Ndalua para zyrave e dolëm. Fidanat e mbjellë gjelbëronin. Kishin shpërthyer degë të reja. Gjithçka bukur si në 'Kastel Blu'

- Ua, sa bukur! - foli Ofelia.

- E kur mendohet se gjithë kjo punë u bë në një kohë të shkurtër, ndjehesh vërtetë mirë.

- Si ishte më parë ky vend?

- Një djerrinë si ata të tjerat që sheh përreth.

Ndërkaq mes nesh erdhi Leonardi. Paraqita Ofelinë.

- Si shkon puna Nardi? Lodhesh?

- Siç e sheh. Lidhja e fidanave me tokën vazhdon pa probleme. Po i rrimë gati çdo fidani për çdo nevojë që paraqet.

- Pse e keni rrethuar si kështjellë? - më pyeti Ofelia.



- Që të mbrojmë fidanat nga kafshët që kullosin përçark.
Është ende një vend i egër.

- I keni marrë rregullisht pagesat mujore ti e punonjësit?
- pyeta Nardin.

- Po. Tek banka me kartë.

- Jeni të kënaqur?

- Shumë. Isha jashtë loje. Kualifikimi im nuk i hynte askujt në punë.

- Kështu do të vijë e mira edhe këtu, si përhapja e biblës. E di si ndodhi kjo? - Erazmi e përktheu librin e famshëm në greqisht, Calvini në frengjisht, Tyndale e Coverdale në anglisht e Lutheri në gjermanisht. Kjo u dha njerëzve mundësi, jo vetëm për të lexuar shkrimet e shenjta, por edhe u afroi instrumentet e mendimit për t'i paraprirë qytetërimin.

- E qartë ideja jote, - foli Leonardi e vazhdoi: Ulliri është bimë qytetëruese. Ajo flet, por nuk ka gojë të shprehet.

- Dhe ne nuk kemi veshë ta dëgjojmë, - ironizova.

- Saktë. Sa kohë do rrini këtu?

- Unë me Ofelinë, nënën e vëllanë, do të pushojmë në bregdet deri nga 20 gushti. Kemi vite të shpërndarë. Mjaft më. Do të mblidhemi. Pastaj do ta rifillojmë punën këtu me të dhënat e rritjes për çdo fidan sipas formularëve që ju kam dërguar. Si herë e parë do t'i bëjmë matjet bashkë. Deri në ditët e para të shtatorit do të jemi këtu, pastaj në 'Kastel Blu'.

Me kaq mbaruam në bazë, u ndamë me miqtë tanë e fluturuam drejt bregdetit që na priste. Zgjodha një vend që e kisha për zemër nga rinia e hershme, ngrita çadrën, vendosa shezlongët, u zhveshëm e u shtrimë. Dielli luante me valët e rërën. U bëmë edhe ne pjesë e tyre.

- Sot e disa ditë do t'u ruhem i rrezeve të diellit, - foli.

- Vend i bukur, ujë i pastër, por i shfrytëzuar pak, - foli Ofelia kur po dilnim nga deti.

- Pjesa më e bukur ka qenë zonë ushtarake.

- Pse?

- Shteti shfrytëzonte faktin që buza e ujit është zonë kufitare e vendoste kontrollin e tij mbi të. Shtet i vogël e frikë e madhe. Po sot?

Ofelia qeshi, Enco luante me top.

- Kohërat kanë ndryshuar e bashkë me të dhe mendësia njerëzore, - foli ajo.

- Je vizituar tek mjeku gjinekolog, Ofeli?

- Po dhe kam hapur kartelën e ndjekjes klinike.

- Kur mendohet të lindësh?

- Diku nga mesi i nëntorit.

- Me ç'gjenalitete do ta regjistrosësh fëmijën?

Ajo qeshi, më shikoi në sy, më kapi për dore e në ecje mbi rërë u përgjigj:

- Emri Franko, atësia Rubin, mbiemri G. E kemi fëmi të përbashkët, - foli qetë e pa u trazuar vazhdoi:

- Dakord je ti?

- Po. Po pse ky kryqëzim emrash në pagëzim?

- Po emri shkon tek i paharrueshmi Franko, vazhdimi të takon ty apo është i gjithi i yti.

Heshta, dhe hodha sytë nga deti. Enco luante me valët. Era luante me kaçurrelat e tij.

Të nesërmen në plazh erdhi edhe nëna, Maksi me të shoqen e vajzën, Juelën. U bëmë një grup i këndshëm. Nëna gëzohej shumë. Edhe ne të tjerët. Ofelisë po i shkëlqente fytyra. Enco e Juela luanin bashkë. Megjithëse nuk ia kuptonin gjuhën njëri-tjetrit, merreshin vesh. Bënin kështjella në rërë. Ëndërra fëmijësh.

Pas dhjetë ditësh kishim marrë rreze e kënaqësinë e larjes në det. Erdhi si argëtim ftesa e Maksit për të kaluar



një ditë pak larg prej këtu, në kepin e Rodonit. Të nesërmen u gjendëm aty. Në fakt kisha qënë aty para disa vitësh, por nuk e kisha vlerësuar si destinacion turistik e fetar. Im vëlla dinte më shumë e, kur arritëm aty, ai u shpreh:

- Është një mrekulli natyrore dhe historike. Këtu është një kështjellë e vjetër që e ka riparuar Skenderbeu si dhe një kishë që u bë e famëshme kur mori emrin e shejtit të Padovës. Vizita në kishë na gëzoi. Ishte rregulluar pjesërisht me ndërhyrjen e françeskanit të fundit pader Zef Pllumit e sot ishte vënë në shërbim të pelegrinëve ngado. Një prift italian shërbente. Ai na sqaroi:

- Kjo kishë është ngritur në shekullin e XIII-të në stilin romano-gotik. Në fillim i ishte kushtuar Shën Anastazias, më vonë Shën Marisë e Skënderbeu ia kushtoi Shën Andonit. Jo larg prej këtu në kepin e Muzhlit është një kështjellë e vjetër që ka shërbyer si rezidencë mes luftërave për komandantin e ushtrisë së pamposhtur shqiptare.

Kur dolëm nga kisha, u nisëm drejt kështjellës. Udhëhiqte Maksi, pas tij Uelda e Ofelia me fëmijë për dore. Unë me nënën mbyllnim kolonën. Ajo gjeti rastin e m'u drejtua:

- Ofelia është me barrë?

- Po, - i përgjigjem unë.

- Dhe ti fle me të si të ishte gruaja jote?

- Po.

- Kjo do të thotë se është zgjedhur nga ti?

Heshta. A do të kuptonte nëna zgjedhjen time, - mendova.

- Nuk është tamam gruaja ime, - fola.

- Po çfarë është atëherë?

Heshta duke parë përpara ku Enco e Juella bënin zhurmë.

- Po djali, e kam fjalën për Encon, i kujt është? - vazhdoi nëna.

- I imi dhe i asaj.

- Dhe u riktheve këtu me të në pritje të një fëmije të dytë?

- Po. Bashkëjetoj me të.

- Pa kurorë?

- Me këtë grua prej disa kohe jam lidhur shumë. - Sa për kurorën në altar as që kemi menduar.

- Pse? - pyeti nëna disi pa qejf.

- Nuk na ka shkuar mendja. Nuk kemi pasur kohë të mendojmë për këtë akt formal. Kemi bërë punë më të rëndësishme.

- Po kohë për të lindur fëmijë keni gjetur?

- Po. Jemi miq të mirë, më do shumë, i gëzohemi lidhjes tonë, e dua dhe unë. Bashkë drejtojmë një projekt të madh, pjesë e të cilit është edhe baza që ngrita këtu. Edhe pushimet i kalojmë bashkë, atje e këtu.

- Nuk po të kuptoj, o bir!

- As unë nuk e kuptova Ofelinë në fillim, por, si pa kuptuar, po jetojmë së bashku. Me Encon e në pritje të një fëmije tjetër.

Nëna heshti. E kapa për dore, e përqafova e vazhduam në rrugën e ngushtë duke shpërndarë habinë e saj. Do të më kuptojë edhe mua e mira nënë.

Para nesh shtrihej në det Bishti i Muzhlit e në gji të tij kështjella e vjetër ku Mamica, motra e princit të lavdishëm pas humbjes burrit topias, kaloi në vetmi vitet e fundit të jetës së saj.





CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Gaspri, Ndue